



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1328/prot.
146

Tiranë, më 30.12 2024

RAPORT

PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT
“**MBI PRAKTIKËN DHE SHKAQET E ZËVENDËSIMIT TË PROKURORËVE
PËR PERIUDHËN 01.01.2023-31.12.2023**”

TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në zbatim të vendimit nr.23, datë 15.5.2024 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023” të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Tiranë, DHJETOR 2024

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit tematik "Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: "Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023-31.12.2023", pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, dhe Vlorë.

Data e përgatitjes:

30.12.2024

Përgatitur nga:


Julian Zonja


Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Artur Metani

Miratoi Ndryshoi Ktheu

Datë ____ . 12. 2024



1. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat “dh”, “ë” dhe “k”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2024 planin e inspektimeve për vitin 2024.

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 5, datë 31.01.2024 “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2024”, është zhvilluar inspektimi tematik me objekt “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023-31.12.2023”.

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr. 23, datë 15.05.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u caktuan inspektorët, z. Julian Zonja dhe znj. Alma Tafani¹.

Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 147/d, pika 2, e cila parashikon se: “2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”, në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neni 204, pika 1, germa “dh”, e cila parashikon se: “Në zbatim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron kompetencat e mëposhtme dh): “... miraton planin vjetor të inspektimeve institucionale e tematike”; në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 6, e cila parashikon se: “6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve.

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së prokurorisë lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

¹ Znj. Alma Tafani është liruar nga detyra me urdhrin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 68, datë 04.06.2024 “Për lirim nga detyra”.

- Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar..

Gjithashtu janë administruar edhe:

- Raporti vjetor për vitin 2023 i Prokurorisë së Përgjithshme.
- Raporti vjetor i veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023.

Rekomandime nga inspektimi pararendës i së njëjtës natyrë dhe zbatimi i tyre

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka realizuar më herët inspektimin për praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01-31.12.2022. Këtij inspektimi iu nënshtruan Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.

Në kushtet kur qëllimi i inspektimit ishte procedura e ndjekur për zëvendësimin e prokurorëve dhe shkaqet e zëvendësimit të tyre, bazuar në arsyeshmërinë e deklarimeve për heqje dorë dhe të vendimeve të drejtuesve të prokurorisë, në përfundim janë evidentuar gjetjet, si dhe rekomandimet përkatëse. Adresimi i rekomandimeve ka qenë, si ndaj prokurorive, sipas gjetjeve, ashtu dhe ndaj Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe ndaj vetë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga numri total i rekomandimeve që konsistonte në gjashtë prej tyre, rekomandimet për Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokuroritë e inspektuara ishin për dijeni, ndërsa ka pasur dhe rekomandime specifike për Prokurorinë Tiranë dhe Vlorë. Pas përfundimit të inspektimit prokurorive të inspektuara u është kërkuar^[2] informacion nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Në përgjigje të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë dërguar informacion Prokuroritë Tiranë^[3], Shkodër^[4], Vlorë^[5] dhe Elbasan^[6]. Por, duhet theksuar se raporti i inspektimit tematik për vitin 2022 është miratuar me vendimin nr. 607/4, datë 01.04.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ku në raportin e inspektimit është përcaktuar si afat për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve periudha 02.05.2024-02.09.2024, prandaj për vitin 2023 për këto prokurori nuk mund të bëhet vlerësim për zbatimin e rekomandimeve. Megjithatë njohja me rekomandimet e dërguara është vlerësuar nga prokuroritë e inspektuara

² Shkresa nr. 2440/1 prot., datë 17.09.2024.

³ Shkresa nr. 20486/1 prot., datë 23.09.2024, me lëndë “vënie në dijeni”, të protokolluar me tonën nr. 2440/2 prot., datë 24.09.2024.

⁴ Shkresa nr. 7678/1 prot., datë 30.09.2024, të protokolluar me tonën me nr. 2440/4 prot., datë 03.10.2024, me lëndë “dërgojmë informacion mbi ndjekjen e rekomandimeve të inspektimit”.

⁵ Shkresa nr. 8924/3 prot., datë 30.10.2024, me lëndë “dërgim informacioni mbi zbatimin e rekomandimeve”, të protokolluar me tonën nr. 2440/7 prot., datë 04.11.2024.

⁶ Shkresa nr. 9554/1 prot., datë 30.09.2024, të protokolluar me tonën me nr. 2440/5 prot., datë 03.10.2024, me lëndë “dërgohet informacioni i kërkuar”.

në përgjigjet e tyre në funksion të inspektimeve vijuese.

Gjatë vitit 2023 që lidhet edhe me rekomandimet e përgjithshme dhe atë specifik rezulton se në datën 01.01.2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka hapur regjistrin fizik dhe elektronik ku identifikohen dhe pasqyrohen të gjitha praktikatat e rasteve të zëvendësimit të prokurorit apo kërkesat për heqje dorë nga procedimi penal. Në të gjitha rastet ruhet praktika/dokumentacioni i paraqitur, përsirë dhe fletën e shortit elektronik apo atë manual.

Me vendimin nr. 23, datë 15.05.2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur:

1. "Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: *"Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023-31.12.2023"*.

2. Inspektimi tematik do të zhvillohet pranë:

- a) Prokurorisë së Përgjithshme;
- b) Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c) Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;
- d) Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

3. Inspektimi tematik do të zhvillohet gjatë periudhës kohore 15.05.2024-31.12.2024, si dhe do të realizohet dhe përfundojë sipas këtyre fazave:

- a) përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, brenda datës 30.05.2024;
- b) përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur, brenda datës 31.07.2024;
- c) hartimi i raportit përfundimtar, brenda datës 31.12.2024;
- ç) ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit brenda gjashtë muajve nga data e miratimit të raportit përfundimtar të inspektimit.

4. Inspektimi tematik të kryhet nëpërmjet administrimit pranë prokurorive të lartpërmendura, të të dhënave, informacionit apo dokumentacionit shkresor në lidhje me:

- a) procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorëve për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, që përfshin të dhënat që nga momenti i deklaramit të prokurorit për heqje dorë ose kërkesës së palëve/subjekteve të tjera për zëvendësim, kalimin e tyre tek drejtuesi për shqyrtim, marrjen e vendimit përkatës nga drejtuesi dhe komunikimin e tij.
- b) çdo praktikë për vendimet e marra "kryesisht" nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorit (zëvendësim pa pëlqim).
- c) procedurën e shortit të ndjekur në rastin e zëvendësimit të prokurorit për caktimin e prokurorit tjetër.
- ç) rastet e ankimeve ndaj vendimit të drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë; si edhe,



d) çdo gjë tjetër që vlerësohet e nevojshme gjatë veprimtarisë së inspektimit, në përputhje me nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

5. Për kryerjen e këtij inspektimi, u ngarkuan inspektorët për të punuar në grupe, sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Znj. Alma Tafani, asistuar nga znj. Aulona Levani për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

b) Z. Julian Zonja asistuar nga z. Renato Tushaj për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

6. Me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, u caktua si kryetar grupi z. Julian Zonja, përgjegjës për bashkërendimin e punës, vendosjen e kontakteve me drejtuesit e prokurorive, kërkimin e informacionit, ndjekjen e ecurisë së punës, administrimin e korrespondencës në një data bazë për aksesim nga i gjithë grupi i inspektimit, unifikimin e praktikës së punës për strukturën e projekt raportit të inspektimit, koordinimin e punës për hartimin e raportit përfundimtar, informimin periodikisht të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe paraqitjen e draft-raportit përfundimtar të inspektimit me gjetjet përkatëse për miratim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

7. Kryetari i grupit, në bashkëpunim me inspektorët përgjegjës, hartoi dhe dorëzoi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, planin për vijimin e punës, brenda datës 15.05.2024.

8. Kryetari i grupit të inspektimit ka raportuar në përfundim të çdo faze inspektimi, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe në çdo rast që kërkohej prej tij.

9. Projektvendimi dhe raporti i inspektimit hartohet nga inspektorët dhe i dërgohet për shqyrtim brenda datës 31.12.2024 Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas përcaktimeve të nenit 214, pika 6 të ligjit nr. 115/ 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

- Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e prokurorive subjekt të këtij inspektimi, për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, me fokus marrjen e të dhënave në tre drejtime kryesore:

- (i) Dokumentacionin lidhur me shkaqet e çdo deklarimi të prokurorëve për heqje dorë, përfshirë ato me kërkesë të palëve/subjekteve të tjera të procedimit penal dhe vendimet e drejtuesit me arsyetimin përkatës për pranimin ose jo të tyre.

- (ii) Dokumentacionin lidhur me çdo praktikë për vendimet e marra nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorit pa pëlqimin e tij.
- (iii) Dokumentacionin lidhur me çdo praktikë për procedurën e shortit dhe caktimin e prokurorit tjetër.

Qëllimi i këtij inspektimi tematik ishte vlerësimi i praktikave në Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, lidhur me shkaqet për të cilat deklarohet "Heqja dorë" e prokurorit dhe zëvendësimi ose jo i tij gjatë hetimeve paraprake ose gjatë gjyqimit, veprimtaria e drejtuesve të prokurorive në lidhje me vendimmarrjen e tyre për zëvendësimin e prokurorit, si dhe zbatimin e shortit për caktimin e prokurorit të ri dhe nëse zbatohet edhe njoftimi i zëvendësimit ose jo, prokurorit të interesuar/palës ose subjekteve të tjera.

Legjislacioni shqiptar ka përcaktuar qartë detyrimet e magistratëve në realizimin e detyrave të tyre funksionale. Kështu në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien dhe sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

Në këtë inspektim u shqyrtua fillimisht dokumentacioni i rasteve të zëvendësimit të dërguara nga çdo prokurori, për të dalluar në pamje të parë aktet që përmban dhe ato që mungojnë në një praktikë zëvendësimi, anën formale të aktit që përdoret nga prokurori për të deklaruar heqjen dorë ose nga një palë/subjekt i procedimit penal dhe nga drejtuesi në vendimmarrjet e tij, shkakun që pretendohet me bazën ligjore, si dhe shkurtimisht bazueshmërinë e arsytimit të tyre. Në vazhdim me analizimin e praktikave u evidentuan në mënyrë të përmbledhur respektimi i procedurës për heqjen dorë të prokurorit dhe zëvendësimin e tij në çdo prokurori, shkaqet konkrete për të cilat është pranuar ose nuk është pranuar zëvendësimi i prokurorit, si dhe problematikat e përgjithshme të tyre.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurorisë së Përgjithshme, mundësoi njohjen për vitin 2023 të praktikave që ndiqen për zëvendësimin e prokurorëve, arsyet e zëvendësimit më të rëndësishme dhe çështje të interpretimit të dispozitave ligjore dhe të balancës midis pavarësisë së prokurorit të çështjes dhe diskrecionit apo autoritetit të drejtuesit të prokurorisë.

Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023 rezultoi se:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1328/6 prot., datë 17.05.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në lidhje me praktikat e zëvendësimit të prokurorëve të kësaj prokurorie.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me shkresën nr. 2732/1 prot., datë 03.09.2024 janë dërguar praktikat e zëvendësimit të prokurorëve nga hetimet e kallëzimeve/procedimeve penale. Në këto praktika kërkesat e prokurorëve (përveç 1 kërkesë) dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohen me numër dhe datë regjistrimi.

1. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimet e procedimit penal bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun *“kërkesa e përsëritur e personit nën hetim për zëvendësimin e prokurorit me pretendimin se prej tij nuk janë kryer veprimet hetimore të kërkuara nga ana e personit nën hetim, nuk është pyetur në cilësinë e personit nën hetim dhe nga ana e prokurorit është paragjykuar hetimi, si dhe ngarkesën në punë, duke i pamundësuar kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e hetimeve brenda një afati sa më të arsyeshëm”*. Kërkesa e prokurorit të çështjes për heqjen dorë nuk na është vendosur në dispozicion nga ana e Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ndërsa të dhënat janë marrë nga vendimi i drejtuesit të prokurorisë, i cili ka vendosur pranimin e kërkesës bazuar në nenet 17, 26/2 të K. Pr. Penale dhe në këtë rast procedimi i është caktuar drejtuesit të prokurorisë pa short, me arsyetimin se në kushtet e ngarkesës së prokurorëve të prokurorisë Berat me një ngarkesë mesatare rreth 300 çështje në hetim për prokuror, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë brenda një afati sa më të shpejtë dhe për të mos u bërë shkak për zvarritjen e hetimeve, procedimi t'i kalohet për hetim drejtuesit të prokurorisë.
2. Prokurori ka kërkuar të heqë dorë nga vlerësimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17, germa ë) të K. Pr. Penale, me shkakun *“kallëzuesi ka shkruar akuza të padrejta në drejtim të prokurorit, si dhe prokurori i ka hetuar dhe më parë pretendimet e kallëzuesit dhe ka marrë vendim mosfillimi”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës bazuar në nenet 17, 26/2 të K. Pr. Penale, me arsyetimin se pretendimet e prokurorit për heqje dorë nuk përbëjnë shkak të rëndësishëm njëanshmërie siç kërkon neni 17, germa “ë” i K. Pr. Penale.
3. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun e *“Paanshmërisë dhe pavarësisë së hetimit”*, si dhe njëkohësisht dhe heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykim i procedimit penal më shkakun se *“kallëzuesja pretendon se prokurori pasi ka mbaruar seanca*

⁷¹ regjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1328/44 prot., datë 06.09.2024.

gjqësore i ka thënë “do të fus në burg” dhe dyshon për korrupsion, grup të strukturuar kriminal. Kallëzuesja është marrë e pandehur dhe dërgimi i kërkesës për gjykim ka sjellë si pasojë faktin që e pandehura të bëjë kallëzim në prokurori”. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 17, 26/2 të K. Pr. Penale, ka vendosur miratimin e kërkesës, duke caktuar një prokuror tjetër pa short për hetimin e kallëzimit penal dhe për përfaqësimin në gjykim të procedimit penal.

4. Rastet e tjera për heqjen dorë të prokurorëve në këtë prokurori kanë të bëjnë me shkakun e kalimit të kallëzimit penal në seksionin kompetent, konkretisht në 4 praktika prokurorit të ngarkuar me çështjet për të mitur, me autorë ose viktimë të mitur dhe në 1 praktikë prokurorit të ngarkuar me hetimin e grup veprave penale kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimit të pasurisë”, sipas udhëzimit të përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm. Me vendim të drejtuesit të prokurorisë bazuar në nenet 17, 26/2 të K. Pr. Penale janë pranuar kërkesat dhe është bërë zëvendësimi, duke iu caktuar çështja prokurorit të ngarkuar me çështjet për të mitur dhe prokurorin e ngarkuar për hetimin e grup veprave penale të pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimit të pasurisë. Për këtë të fundit nuk është vendosur në dispozicion vendimi i Drejtuesit të Prokurorisë.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1328/7 prot., datë 17.05.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në lidhje me zëvendësimet e prokurorëve në këtë prokurori.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 05.06.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1328/23 prot., datë 07.06.2024 dhe me shkresën nr. 1952/1 prot., datë 31.07.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1328/42 prot., datë 02.08.2024, në përgjigje të kërkesës për praktika dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve ka dërguar këto akte:

1. Në zbatim të Urdhrit nr. 22, datë 29.05.2023, të ish-drejtuesit të prokurorisë “Për përjashtimin nga shorti dhe balancimin e ngarkesës së prokurorëve”, është urdhëruar kalimi me zëvendësim i 153 (njëqindpesëdhjetë e tre) çështjeve penale nga ish-drejtuesi i prokurorisë te dy prokurorë të tjerë. Sipas procesverbalit të shortit manual janë shpërndarë 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) procedime penale në fazë hetimi paraprak, sipas aneksit nr. 1, datë 29.05.2023, ku 77 (shtatëdhjetë e shtatë) procedime penale i kanë kaluar për ndjekje njërit prokuror dhe 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) procedime penale i kanë kaluar për ndjekje prokurorit tjetër. (Aneksi nr. 1, datë 29.05.2023 nuk përputhet me të dhënat e Urdhrit nr. 22/2023).

2. Sipas Urdhrit nr. 38, datë 26.07.2023, të ish-drejtuesit të prokurorisë “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të dosjeve, dokumentacionit, provave dhe bazës materiale” është mbajtur procesverbali “Për Dorëzimin e dosjeve, dokumentacionit, provave dhe bazës materiale” të magjistratit të cilit me vendimin nr. 282, datë 10.07.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i ka mbaruar statusi.
3. Me urdhrin nr. 42, datë 11.09.2023, të ish-drejtuesit të prokurorisë “Për balancimin e ngarkesës së prokurorëve”, është urdhëruar kalimi me zëvendësim i 39 (tridhjetë e nëntë) çështjeve penale nga ish-prokurori të cilit i ka mbaruar statusi tek dy prokurorë të tjerë. Sipas procesverbalit të shortit manual nga këto 39 (tridhjetë e nëntë) çështje penale, 18 (tetëmbëdhjetë) çështje penale u zgjodhën nga një prokuror dhe 21 (njëzet e një) çështjet e tjera nga prokurori tjetër.
4. Me urdhrin nr. 47, datë 19.09.2023, të ish-drejtuesit të prokurorisë “Për balancimin e ngarkesës së prokurorëve”, është urdhëruar kalimi me zëvendësim i 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) çështjeve penale nga një prokuror tek një prokuror tjetër. Në zbatim të Urdhrit nr. 47/1, datë 19.09.2023, të ish-drejtuesit të prokurorisë për “Ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të dosjeve, dokumentacionit, provave dhe bazës materiale” në datën 19.09.2023 është mbajtur procesverbali përkatës dhe në datën 01.11.2023 komisioni i ngritur ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dosjeve tek prokurori tjetër pasqyruar në Aneksin nr. 1.
5. Sipas Urdhrit nr. 51, datë 03.10.2023, të ish-drejtuesit të prokurorisë për “Ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të dosjeve, dokumentacionit, provave dhe bazës materiale” të prokurorit, i cili me vendimin nr. 236, datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është caktuar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në datën 04.10.2023 është mbajtur procesverbali mbi “Dorëzimin e dosjeve, dokumentacionit, provave dhe bazës materiale”. Më datë 05.10.2023 është mbajtur procesverbali “Për hedhjen në short manual” të 61 (gjashtëdhjetë e një) çështjeve penale të dorëzuara nga ky prokuror, të cilat janë ndarë midis katër prokurorëve në këtë prokurori në raportet, 23 (njëzet e tre) çështje penale një prokuror, 20 (njëzet) çështje penale një prokuror, 17 (shtatëmbëdhjetë) çështje një prokuror dhe 1 çështje u zgjodh nga prokurori tjetër.
6. Sipas procesverbalit datë 14.11.2023 “Për hedhjen në short manual” për çështjet penale të kthyer nga gjykata, të dërguara për gjykim, si dhe kërkesa të ndryshme penale, janë shpërndarë midis tre prokurorëve secili nga 3 (tre) çështje penale.

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës



Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1328/8 prot., datë 17.05.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në lidhje me zëvendësimin e prokurorëve. Kjo prokurori ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2009/1 prot., datë 06.06.2024, regjistruar pranë ILD me nr. 1328/29 prot., datë 12.06.2024, duke dërguar praktikat përkatëse të zëvendësimit të prokurorëve. Në këto praktika kërkesat e prokurorëve dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohen me numër dhe datë regjistrimi.

1. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 17/1, germa ë) të K. Pr. Penale me shkakun *“prokurori dhe noterja që ka hartuar disa akte noteriale, të cilat janë të administruara në procedimin penal mbi bazën e të cilave janë regjistruar pronat për të cilat palët janë në konflikt janë kushërinj”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e heqjes dorë, bazuar në nenet 17/ç, 26-27, 79 dhe 92 të K. Pr. Penale dhe zëvendësimin me prokurorin e caktuar me short manual, me arsyetimin se shkaqet që parashtron prokurori e konkretisht marrëdhëniet gjinore me një nga personat e përfshirë në konflikt, përbën arsye njëanësie (neni 17/ë i K. Pr. Penale) të cilat do të ndikonin në zgjidhjen me objektivitet të çështjes.
2. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal, bazuar në shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie parashikuar nga neni 17/1 germa “ë” të K. Pr. Penale, me shkakun *“në lidhje me shtetasin e kallëzuar në këtë procedim penal, prokurori është hetuar në kushtet e konfliktit të interesit gjatë hetimit administrativ “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*”. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e heqjes dorë, bazuar në nenin 17/ç, 26 të K. Pr. Penale dhe zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e caktuar me short manual, me arsyetimin se shkaqet që parashtron prokurorja në kërkesën për heqje dorë, përbëjnë arsye njëanësie (neni 17/a i K. Pr. Penale), të cilat do të ndikonin në zgjidhjen me objektivitet të çështjes.
3. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal për shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, bazuar në nenin 17, germat “ç” dhe “ë” të K. Pr. Penale, me shkakun *“në procedimet penale të mëparshme të hetuara nga prokurori personi nën hetim aktual ka qenë kallëzues dhe prej tij është kërkuar në mënyrë të përsëritur zëvendësimi i tij si prokuror, duke u aluduar nga ana e këtij shtetasi për njëanshmëri në kryerjen e hetimeve. Gjithashtu gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar rezulton se personi nën hetim është ndër personat denoncues ndaj prokurorit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e heqjes dorë bazuar në nenet 17/ç, 26, 79 dhe 92 të K. Pr. Penale dhe zëvendësimin me prokurorin e caktuar me short manual, me arsyetimin se në rastin konkret, shkaqet që parashtron prokurori në kërkesën për heqje dorë, përbëjnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie me personin nën hetim (neni 17/a i K. Pr. Penale), të cilat do të ndikonin në zgjidhjen me objektivitet të çështjes.

4. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal në fazë gjykimi, bazuar në nenet 17/ç/ë dhe 26 të K. Pr. Penale, me shkakun *“Në emisionin investigativ “STOP”, në një nga televizionet publike, është trajtuar me tone dyshuese dhe paragjyquese çështja në ngarkim të të pandehurit. Keqinterpretimi dhe mënyra humoristike e trajtimit të çështjes, si edhe dashakeqësia e evidentuar në mënyrën e përmendjes së emrit të prokurorit në mënyrë publike, kanë ndikuar në vlerësimin e palëve për pavarësinë dhe paanësinë. Në lidhje me situatën e krijuar pas këtij emisioni televiziv, ndërmjet palëve me prokurorin e çështjes ka lindur një mosmarrëveshje. Mënyra se si konceptohet dhe interpretohet nga publiku i gjerë, roli i prokurorit pas analizimit të çështjes në një emision investigativ, pashmangshmërisht passjell një krisje të besimit dhe ekuilibrit ndërmjet interesave të përgjithshme dhe të drejtave të individëve të përfshirë në këtë ngjarje. Pra gjithashtu ekzistojnë shkaqe të dukshme për t’u konsideruar e njëanshme dhe e ndikuar nga publikimi i të dhënave në emisionin investigativ, për të siguruar vijimin e një gjykimi të drejtë e të paanshëm për secilën nga palët e përfshira në konflikt”*. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 17/ë, 27/1, të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurores me arsyetimin se nuk jemi në kushtet e nenit 17/1, germa “ç” dhe “ë” apo të një paragrafi tjetër të kësaj dispozite. Argumentet për heqjen dorë të paraqitura nga prokurori nuk përbëjnë shkak për pranimin e dorëheqjes, për sa kohë që ato mbështeten vetëm në pakënaqësitë e palëve në proces.
5. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga procedimi penal, bazuar në nenet 17/e dhe 26 të K. Pr. Penale me shkakun *“ka njohje familjare me kallëzuesin dhe vajzën e tij, e cila sikurse arsyetohet në kallëzim ka qenë prezente në bisedimet e kryera me palët e kallëzuara prej tij”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin me prokurorin e caktuar me short elektronik, me arsyetimin se shkaqet që parashtron prokurori në kërkesën për heqje dorë, përbëjnë arsye njëanësie (neni 17/dh i K. Pr. Penale), të cilat do të ndikonin në zgjidhjen me objektivitet të çështjes.
6. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga procedimi penal bazuar në nenet 16, 17/e dhe 26 të K. Pr. Penale me shkakun *“me avokatin mbrojtës të të pandehurës prokurori është në lidhje gjinie të afërt”*. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e caktuar me short manual, me arsyetimin se lind e domosdoshme zëvendësimi me një prokuror tjetër të caktuar me short manual.
7. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, me shkakun *“mbrojtësi i personit nën hetim pretendon se prokurori është në konflikt për ushtrimin e funksionit pasi ekzistojnë shkaqet e parashikuara nga nenet 16 dhe 26 të K. Pr. Penale me njërin nga viktimat, ndërsa nga prokurori deklarohet se me viktimën nuk ka asnjë lidhje sipas parashikimeve të nenit 16 të K. Pr. Penale, por heq dorë meqenëse edhe në seancë gjyqësore u pretendua e njëjta gjë, për të mos paragjykuar zgjidhjen ligjore të çështjes nga asnjëra palë”*. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 17/ë dhe 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë dhe zëvendësimin

me prokurorin e caktuar me short manual, me arsyetimin se prokurori deklaroi se me viktimën ka njohje familjare, për të mos paragjykuar zgjidhjen ligjore të çështjes nga asnjëra palë dhe shkaqet që parashtron prokurori do të ndikonin në zgjidhjen me objektivitet të çështjes.

8. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal, bazuar në nenin 26/1 dhe nenin 17/ë të K. Pr. Penale, me shkakun "*me personin që i atribuohet vepra penale ka njohje 10 vjeçare, duke punuar në të njëjtën prokurori më parë dhe ka krijuar miqësi të ngushtë*". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë dhe zëvendësimin me prokurorin e caktuar me short manual, me arsyetimin se këto arsye mund përbëjnë shkak njëanshmërie, të cilat mund të ndikojnë në trajtimin e materialit kallëzues.
9. Prokurori ka paraqitur informacion për "*dhënie pëlqimi për zëvendësim dhe heqje dorë*" nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenet 17 dhe 27 të K. Pr. Penale me shkakun "*prokurori ka njohje me kallëzuesen sepse është klient në dyqanin e saj dhe njëkohësisht kallëzuesja ka paraqitur kërkesë për zëvendësimin e prokurorit*". Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 17/ë, 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e deklaratës për heqje dorë dhe zëvendësimin me prokurorin e caktuar me short manual, me arsyetimin se këto arsye mund të përbëjnë shkak njëanshmërie, të cilat mund të ndikojnë në trajtimin e materialit kallëzues.
10. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë në lidhje me përfaqësimin në gjykim të procedimit penal bazuar në nenin 17/1, germa "ë" të K. Pr. Penale, me shkakun "*ka njohje familjare me kallëzuesin pasi me vajzën e tij ka mbaruar fakultetin dhe ruajnë marrëdhënie shoqërore dhe familjare*". Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 17/ç, 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin me prokurorin e caktuar me short, me arsyetim se njohja që prokurori ka me vajzën e kallëzuesit, përbëjnë arsye njëanshësie (neni 17/ë i K. Pr. Penale), të cilat do të ndikonin në zgjidhjen me objektivitet të çështjes.
11. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga procedimi penal në gjykim bazuar në nenet 16, 17/e/dh dhe 26 të K. Pr. Penale me shkakun "*bashkëshorti i prokurorit ka gjykuar një çështje civile ku personi i akuzuar ka qenë paditës dhe në aktet e fashikullit të gjykimit penal është administruar si provë vendimi gjyqësor civil i bashkëshortit*". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga përfaqësimi në gjykim i procedimit penal, me arsyetimin se del i nevojshëm zëvendësimi me një prokuror tjetër. Në vendim nuk del nëse prokurori tjetër është caktuar me short apo pa short.
12. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 17/1, të K. Pr. Penale me shkakun "*kallëzuesi ka depozituar dokumente të përpiluara nga noterja, e cila është bashkëshortja e prokurorit*". Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë dhe zëvendësimin me prokurorin e caktuar me short manual.

13. Në tetë (8) praktika zëvendësimi nga prokurori është paraqitur informacion ose kërkesë për kalimin e kallëzimit penal/procedimit penal në seksionin kompetent, konkretisht në 7 praktika për *seksionin për të miturit*, me autorë ose viktimë të mitur. Informacionet për seksionin e të miturve janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë në bazë të neneve 17/ç dhe 26 të K. Pr. Penale, duke caktuar prokurorin tjetër me short manual, por procesverbal shorti nuk është paraqitur. Gjithashtu nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë paraqitur edhe 31 vendime të tjera zëvendësimi të prokurorëve nga hetimi i kallëzimeve ose procedimeve penale të marra në bazë të nenit 27/1 të K. Pr. Penale caktuar në bazë të shortit manual prokurorëve të seksionit të të miturve për shkak të prezencës së të miturve në konflikt me ligjin. Në një (1) praktikë kërkesa e prokurorit për kalimin e materialit tek *seksioni për shpërdorimin e detyrës, trafikeve dhe narkotikëve*, pasi për shkak gatishmërie ka kryer veprimet e para të ngutshme hetimore, është pranuar nga drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale, duke e zëvendësuar me prokurorin e caktuar në grafikun e gatishmërisë së muajit prill 2023, me arsyetimin se bazuar në nenet 17/1, germa “c” dhe 27/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga kryerja e hetimeve duke dhënë pëlqimin për zëvendësimin e tij me një prokuror tjetër.

13.1 Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në bazë të Urdhrit për shortimin e materialeve dhe procesverbaleve të shortit manual janë paraqitur edhe vendimet e zëvendësimit të prokurorit të marrë në bazë të nenit 27/1 të K. Pr. Penale për:

- çështjet penale në hetim dhe në gjykim, për një prokuror të shkarkuar me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (gjithsej 125 çështje).
- çështjet penale në fazë verifikimi, në hetim dhe në gjykim, për dy prokurorë të pezulluar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (gjithsej 137 + 251 çështje).
- çështjet penale në fazë verifikimi, në hetim dhe në gjykim të tre prokurorëve të transferuar me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në prokurori tjetër (gjithsej 23 + 80 + 200 çështje).
- çështjet penale në fazë verifikimi, në hetim dhe në gjykim të një prokurori për paaftësi të përkohshme fizike në punë, pasi ka paraqitur raport mjekësor (gjithsej 134 çështje).

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës janë paraqitur edhe 12 kërkesa të palëve të ndryshme, kallëzues, persona nën hetim, për zëvendësimin e prokurorit, të cilat janë të protokolluara nga sekretaria.

14. Kallëzuesi ka kërkuar përjashtimin e prokurorit me pretendimin “*kalimin e çështjes tek një prokuror me dorë të pastër, pasi prej katër vitesh prokurori mban dosjen peng duke pasur ndërhyrje nga pala tjetër*”. Në kërkesë ka siglim të drejtuesit të prokurorisë për informacion nga prokurori, por nuk kemi ndonjë akt të tillë në praktikë. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit, bazuar në nenet 17, 26, 27/1

të K. Pr. Penale, me arsyetimin se pretendimet e paraqitura prej ankuesit nuk janë të bazuara në fakte dhe gjithashtu lidhen me kompetencat e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale me pavarësi dhe paanësi. Për këtë vendim të njoftohet kërkuesi me anë të Oficerit të Policisë Gjyqësore që ndjek hetimin.

15. Kallëzuesi ka kërkuar përjashtimin e prokurorit bazuar në nenin 16 të K. Pr. Penale me pretendimin *“prokurori i ka thënë se kompetencën do ta shqyrtojë tek Prokuroria e Përgjithshme gjë që nuk e ka bërë, duke i thënë se çështjen do ta çojë në gjyq, por e çoi për pushim, si dhe ka paraqitur kallëzime ndaj prokurorit. Çështja ka 8 muaj që është kthyer nga Gjykata e Apelit Durrës dhe ai nuk është thirrur dhe nuk është vënë në dijeni për veprimet që mund të jenë kryer dhe prandaj nuk ka besim tek ky prokuror për zbardhjen e çështjes”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenet 17, 26, 27/ë/1 të K. Pr. Penale, me arsyetimin se mungojnë shkaqet ligjore për përjashtimin e prokurorit, pasi të gjitha vendimmarrjet e prokurorit verifikohen para gjykatës, e cila është organi kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre, si dhe faktin nëse nga ana e prokurorit është respektuar procedura penale dhe ligji, lidhur me kryerjen e hetimeve, për vendimmarrjen, administrimin e provave, paanshmëria e tij, etj. Gjithashtu rezultoi se kjo kërkesë është e pambështetur në ligj dhe pretendimet e ngritura nga kërkuesi nuk parashikohen në nenin 27 të K. Pr. Penale. Me shkresën nr. 2114/1prot., datë 12.01.2024, vendimi i drejtuesit i është njoftuar shtetasit.
16. Kallëzuesi ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga procedimi penal bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale me pretendimin *“ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën, për të cilat ligji lejon zëvendësimin pa pëlqimin e prokurorit, sepse nuk kishte asnjë informacion për kallëzimin e tij dhe ndërkohë që ishte në pritje të përgjigjes së kërkesës së tij për zëvendësimin e prokurorit, i është dërguar vendimi i mosfillimit i marrë më parë. Edhe pas kthimit të akteve nga gjykata, prokurori nuk ka hequr dorë pasi me vendimin e mosfillimit e ka paragjykuar çështjen. Prokurori ka hetuar dhe një procedim tjetër ku kallëzuesi ka qenë palë dhe ka kryer një hetim të njëanshëm, si dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje për kërkesat e tij për prova”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit, bazuar në nenet 16, 17, 27/1 të K. Pr. Penale, me arsyetimin se mungojnë shkaqet ligjore për përjashtimin e prokurorit pasi fakti që prokurorja ka shprehur njëherë mendim nuk futet në shkaqet që parashikon neni 27 pika 1, i cili i referohet germave “a”, “b”, “ç”, “d”, “dh”, të nenit 17 të K. Pr. Penale. Pretendimet e paraqitura prej ankuesit nuk janë të bazuara në ligj, dhe gjithashtu lidhen me kompetencat e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale me pavarësi dhe paanësi. Me shkresën 1973/1prot., datë 11.12.2023, është njoftuar shtetasi me vendimin e drejtuesit të prokurorisë.
17. Personi nën hetim ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit bazuar në nenin 17/1 germa “ë” dhe 27 të K. Pr. Penale, me pretendimin *“bashkëshorti i prokurorit është me detyrë gazetar dhe pedagog pranë Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, në Universitetin e Tiranës dhe në kushtet që ky procedim penal ka nisur për shkak të një video të transmetuar nga emisioni*

investigativ të një prej mediave "TOP Channel", ekziston shkak i rëndësishëm njëanshmërie, e cila mund të ndikojë në hetimin e këtij procedimi penal". Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me një prokuror tjetër, me arsyetimin se fakti se bashkëshorti i prokurorit është pedagog në Departamentin e Gazetarisë, mund të krijojë mundësi për të pasur lidhje me gazetarët e këtij emisioni dhe mund të krijojë arsye për njëanshmëri në hetimin e kësaj çështjeje penale. Nuk rezulton nëse prokurori tjetër është caktuar ose jo me short.

18. Kallëzuesi ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit bazuar në nenet 17 dhe 27 të K. Pr. Penale, me pretendimin "*prokurori i çështjes ka shfaqur mendim lidhur me çështjen mbi faktet dhe rrethanat objekt procedimi në vendimin e mosfillimit lidhur me kallëzimin e bërë nga ana e tij, pasi çështja është kthyer për hetime nga gjykata e rrethit gjyqësor Durrës. Prokurori ka kryer veprime me shkelje të rënda dhe mënyrë të vepruari me pasojë për palët në proces dhe trajtim preferencial të palëve". Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 16, 17 dhe 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit, me arsyetimin se nuk jemi para përmbushjes së kushteve të parashikuara në nenin 16 të K. Pr. Penale. Pra, shkak i paraqitur nga kërkuesi se prokurori ka shfaqur mendim në vendimin e mosfillimit i parashikuar nga neni 17/1, shkronja "c" i K. Pr. Penale nuk përfshihet në rastet e zëvendësimit të prokurorit. Me shkresën nr. 643/1 prot., datë 04.05.2023, është njoftuar shtetasi me vendimin dhe për dijeni prokurorit të çështjes.*
19. Kallëzuesi ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit në fazën e gjykimit, bazuar në nenin 17/ë të K. Pr. Penale, me pretendimin "*zvarritje të procesit në gjykimin në seancë paraprake për shkak të shtyrjes së seancave për mungesë të prokurorit duke cenuar zhvillimin e gjykimit sipas një afati të arsyeshëm dhe të drejtat e kërkuesit si viktimë e veprës penale për një proces të rregullt ligjor. Prokurori në situatën e mësipërme gjendet në kushtet e njëanshmërisë, si dhe arsye serioze në ushtrimin detyrës (që shkon në kufijtë e shpërdorimit të detyrës) sipas nenit 27 të K. Pr. Penale". Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 16, 17, dhe 27/ë/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit, me arsyetimin se pretendimet e paraqitura prej ankuesit nuk janë të bazuara në ligj dhe gjithashtu lidhen me kompetencat e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale me pavarësi dhe paanësi, çka nënkupton edhe renditjen e kohës së punës pasi disa seanca janë caktuar pa praninë e tij dhe në disa raste të tjera ka pasur veprime të ngutshme hetimore si pjesëmarrja në masa sigurimi, etj. Me shkresën nr. 272/1 prot., datë 28.02.2023, është njoftuar kallëzuesi me vendimin.*
20. Kallëzuesi ka kërkuar përjashtim të prokurorit, nga hetimi i çështjes, por kërkesa dhe vendimi nuk na është vendosur në dispozicion. Me shkresën nr. 1658/1 prot., datë 01.11.2023, është njoftuar shtetasi me vendimin e mospranimit të kërkesës.
21. Kallëzuesi ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale, me pretendimin "*I njëjti prokuror ka hetuar një tjetër kallëzim penal dhe ka vendosur pushimin*

e tij dhe nuk ka kryer hetimet e urdhëruara nga gjykata, duke zvarritur hetimin e kallëzimeve të kërkuarit. Prokurorit i ka bërë kallëzim penal për zvarritje të kallëzimeve të tij dhe për këtë shkak janë në konflikt interesi”. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 16, 17, dhe 27/ë/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit nga hetimi i procedimit penal, me arsyetimin se fakti që ka hetuar më parë një procedim tjetër penal nuk përbën shkak për përjashtimin e prokurorit referuar dispozitave procedurale penale, si dhe lidhur me pretendimet e tjera, të gjitha vendimmarrjet e prokurorit verifikohen para gjykatës, e cila është organi kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre. Me shkresat nr. 432/1 prot., nr. 476/1 prot., nr. 519/1 prot., datë 03.04.2023, është njoftuar shtetasi me vendimin.

22. Personi nën hetim ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga procedimi penal me pretendimin “Shkelje flagrante të ligjit, prokurori ka regjistruar procedim penal në shkelje të ligjit në ngarkim të tij, i cili për këtë shkak nuk pajisjet dot me vërtetim që nuk ka ndjekje penale”. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 16, 17, dhe 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit, me arsyetimin se pretendimet e ngritura nga kërkuari nuk parashikohen në nenin 27 të K. Pr. Penale. Pretendimet e paraqitura prej kërkuarit nuk janë të bazuara në ligj dhe gjithashtu lidhen me kompetencat e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale me pavarësi dhe paanësi. Gjithashtu për të gjitha vendimmarrjet dhe kërkesat e prokurorit është gjykata organi kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se kjo çështje është ende në hetim. Me shkresën nr. 593/1 prot., datë 04.05.2023, është njoftuar shtetasi me vendimin dhe për dijeni prokurori i çështjes.
23. Kallëzuesi ka kërkuar (kërkesa mungon por të dhënat janë nxjerrë nga vendimi i drejtuesit) zëvendësimin e prokurorit nga procedimi penal me pretendimin “prokurori ka publikuar akte sekrete të cilat cenojnë hetimin, se ja ka vënë në dispozicion një shtetasi pa qenë palë dhe subjekt në çështjen në fjalë”. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 25/1, germa “a”, 27/1, si dhe 105/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit, me arsyetimin se në zbatim të neneve 17 e 27 të K. Pr. Penale nuk konstatohen shkaqe për zëvendësimin e prokurorit, ku personi ka qenë i kallëzuar dhe në zbatim të nenit 105/1 të K. Pr. Penale është person që ka interes për ecurinë e procedimit dhe si i tillë duhej të njihet dhe merrte kopje të akteve të këtij procedimi penal. Në këtë procedim nuk konstatohet që të kishte akte që ligji i ka përcaktuar si “sekret”, por vetëm akte procedurale, të cilat në përfundim të hetimit organi procedues ka detyrimin që t’ia vërë në dispozicion çdo personi të interesuar. Me shkresën nr. 801/1-K prot., datë 25.05.2023 është njoftuar kallëzuesi me vendimin.
24. Kallëzuesi ka kërkuar (kërkesa mungon dhe të dhënat janë nxjerrë nga vendimi i drejtuesit) zëvendësimin e prokurorit nga hetimet e procedimit penal me pretendimin “nga ana e prokurorit nuk janë kryer veprimet hetimore në kohë dhe në afat pasi kallëzuesi ka bërë disa herë kërkesa për kryerje të veprimeve, por prokurori nuk i ka kryer veprimet duke mos pyetur për ligj dhe për të drejtat e viktimës”. Drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 16, 17 dhe 27/ë/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit,

me arsyetimin se të gjitha vendimmarrjet e prokurorit verifikohen para gjykatës, si dhe faktin nëse nga ana e prokurorit është respektuar procedura për vendimmarrjen, administrimin e provave, paanshmëria e tij, afatin e marrjes së provave dhe ecurisë së çështjes etj. Me shkresën nr. 986/1 prot., datë 20.06.2023 kallëzuesi është njoftuar me vendimin.


25. Kallëzuesi ka kërkuar (kërkesa mungon dhe të dhënat janë nxjerrë nga vendimi i drejtuesit), përjashtimin e prokurorit me pretendimin "*prokurori nuk ka hapur çështje dhe ka krijuar urrejtje ndaj tij. Çështja ka katër muaj që është kthyer nga gjykata dhe ai nuk ka asnjë njoftim*". Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 16, 17, dhe 27/ë/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se fakti që ka vonesë në hetim nuk përbën shkak për përjashtimin e prokurorit referuar dispozitave procedurale penale, si dhe lidhur me pretendimet e tjera, të gjitha vendimmarrjet e prokurorit verifikohen para gjykatës, e cila është organi kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre. Me shkresën nr. 1925/1 prot., datë 16.11.2023, është njoftuar shtetasi me vendimin e mospranimit të kërkesës.

4. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1328/9 prot., datë 17.05.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në lidhje me praktikat e zëvendësimit të prokurorëve në këtë prokurori.


Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me shkresën nr. 5290/1 prot., datë 29.05.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1328/19 prot., datë 30.05.2024, ka dërguar praktikat që kanë të bëjnë me procedurat e zëvendësimit të prokurorëve për vitin 2023. Në këto praktika deklarimet e prokurorit për heqje dorë dhe vendimmarrja e drejtuesit identifikohen me regjistrimin e tyre në regjistrin e korrespondencës së brendshme procedurale.

1. Në praktikën me nr. 65, datë 20.01.2023, prokurori ka kërkuar heqje dorë nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun "*Ngarkesa në punë; Shkaqe shëndetësore personale; Volumit të dosjes konkrete*". Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin për shqyrtimin e kërkesës me shkrim, bazuar në nenet 17/ë, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pas hedhjes së shortit manual me vendimin për zëvendësimin e prokurorit bazuar në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e caktuar nga shorti, me arsyetimin se kur ekzistojnë shkaqe ligjore dhe prokurori nuk mund të vazhdojë veprimet në lidhje me këtë procedim penal, atëherë është e domosdoshme zëvendësimi i këtij prokurori për arsye ligjore.
2. Në praktikën nr. 102, datë 25.01.2023 nga prokurori është kërkuar heqja dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenet 17/ë, 26-27 të K. Pr. Penale me shkakun "*familjarët e*



njërit prej të dyshuarve si autor i veprës penale, janë në lidhje krushqie me rrethin familjar të prokurorit". Drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin për shqyrtimin e kërkesës, bazuar në nenet 17/ë, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjit nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit me arsyetimin se pranimi i kërkesës për zëvendësimin e prokurorit duhet të bëhet vetëm për arsye se në dhënien e drejtësisë është e rëndësishme jo vetëm dhënia e saj në bazë të ligjit dhe për shkaqe të tjera të njëanshme, ku dhe për palët në proces dhe për publikun të krijohet një perceptim sa më i plotë se kjo drejtësi do të jepet. Pasi është hedhur shorti manual me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale drejtuesi ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e caktuar nga shorti.

3. Në praktikën me nr. 615, datë 27.03.2023, nga prokurori është kërkuar heqja dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun *"prokurori ka kërkuar dënim më parë për një nga personat nën hetim dhe krijohen shkaqe të tjera njëanshmërie dhe perceptimi të gabuar pavarësisht mënyrës së zgjidhjes së çështjes në tërësi"*. Bashkëlidhur kërkesës prokurori ka paraqitur edhe vendimin e dënimit. Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin për shqyrtimin e kërkesës me shkrim, bazuar në nenet 26-27, 110/2 të K. Pr. Penale dhe ligjit nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës sipas arsyetimit se nga verifikimi i kryer nga zyra e regjistrimit rezulton se parashtrimi i prokurorit për dënimin e mëparshëm të personit nën hetim është i sakte. Kërkesa e prokurorit është e bazuar në ligj, për shkak të nevojës për zgjidhje të drejtë, të paparagjykuar dhe të paanshme të çështjes. Pasi është hedhur shorti manual me vendimin për zëvendësimin e prokurorit bazuar në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale është vendosur zëvendësimi i prokurorit me prokurorin e caktuar nga shorti. Praktikës i janë bashkëlidhur edhe zëvendësimet e mëparshme të prokurorëve në këtë procedim penal.
4. Në praktikën me nr. 661, datë 31.03.2023, prokurori ka paraqitur informacion *"Mbi procedimin penal dhe dhënie mendimi për zëvendësim mbi bazën e kërkesës së personit nën hetim"*, duke parashtruar se *"personi nën hetim ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga hetimi dhe ndjekja e këtij procedimi penal me pretendimin se ka shpërdoruar detyrën dhe ka zvarritje të hetimit. Në këto kushte, për të respektuar procesin e rregullt ligjor, pasi drejtësia jo vetëm duhet të jetë e paanshme, por edhe të duket e tillë, duhet të zëvendësohet me një prokuror tjetër"*. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 17, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se duke qene se personi nën hetim ka bërë kërkesë për zëvendësimin e prokurorit nga hetimi i këtij procedimi penal dhe ky i fundit ka kërkuar zëvendësimin e tij me një prokuror tjetër, kërkesa e prokurorit duhet të pranohet dhe të vendoset zëvendësimi i tij. Pasi është hedhur shorti manual me vendimin për zëvendësimin e prokurorit bazuar në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale është vendosur zëvendësimi i prokurorit me prokurorin e caktuar nga shorti. Praktikës i janë bashkëlidhur edhe zëvendësimet e mëparshme të prokurorëve në këtë procedim penal.



5. Në praktikën me nr. 4787, datë 16.05.2023, nga prokurori është kërkuar zëvendësimi nga çështjet penale për shkakun "*Probleme shëndetësore*" për të cilin janë paraqitur raporte mjekësore. Për këtë prokurori ka paraqitur raport mjekësor me nr. 163, datë 15.05.2023, për pushim nga data 15.05.2023-22.05.2023; raport mjekësor nr. 1694, datë 22.05.2023 për pushim nga data 22.05.2023-29.05.2023; raport mjekësor për paaftësi në punë nr. 2129, datë 30.05.2023 për pushim nga data 29.05.2023-28.07.2023; raport mjekësor nr. 415, datë 31.07.2023 për pushim nga data 28.07.2023-27.08.2023; raport mjekësor nr. 585, datë 28.08.2023 për pushim nga data 27.08.2023-26.09.2023; raport nr. 664, datë 25.09.2023 për pushim nga data 26.09.2023-26.10.2023. Drejtuesi i Prokurorisë pas shqyrtimit të kërkesës me shkrim, ka nxjerrë urdhrat si më poshtë:

- a) Nr. 33, datë 16.05.2023 për "*Përjashtim nga shorti të prokurorit*" deri në një urdhër të dytë.
- b) Nr. 32, datë 16.05.2023 për "*Hapjen e zyrës dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit që lidhet me detyrën e prokurorit*", me qëllim gjetjen dhe marrjen në dorëzim të materialeve hetimore (kallëzimeve penale) dhe çështjeve penale në hetim ose gjykim apo hetimeve pasurore, si dhe të çdo dokumentacioni (akti) procedural ose administrativ tjetër që lidhet me detyrën e saj.
- c) Nr. 37, datë 29.05.2023 "*Për trajtimin e materialeve të prokurorit*" me të cilin janë rishpërndarë nëpërmjet shortimit të gjitha çështjet penale që më parë i janë shortuar apo caktuar prokurorit. Në short, me qëllim ruajtjen e barazisë në ndarjen e ngarkesës, përfshihen të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie, përfshirë edhe drejtuesin e prokurorisë.
- d) Nr. 42, datë 13.06.2023 "*Për trajtimin e materialeve*", me të cilin janë rishpërndarë, nëpërmjet shortimit, të gjitha çështjet penale që më parë i janë shortuar apo caktuar prokurorit që ka bërë kërkesën për shkak të problemeve shëndetësore dhe prokurorit të transferuar në Prokurorinë Tiranë.

6. Në praktikën me nr. 6931, datë 06.07.2023, nga drejtuesi i prokurorisë është kërkuar heqja dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun "*për shkak të shërbimit të gatishmërisë ky procedim penal i ka kaluar për ndjekje drejtuesit të prokurorisë si prokuror i gatshëm, në kushte urgjence në kryerjen e veprimeve hetimore. Në rrethana të dala rishtazi, bazuar në nenet 17/1/e, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale për një hetim objektiv dhe transparent si dhe një zgjidhje të paparagjykueshme të çështjes penale, deklarohet heqja dorë nga vijimi i hetimeve, duke ardhur në dijeni të faktit se babai i të arrestuarit ka pasur njohje me babanë e prokurorit dhe ky i fundit është telefonuar nga babai i të arrestuarit, duke i bërë prezent faktin që i arrestuari ishte djali i tij*". Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në nenet 17, 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, me arsyetimin se bazuar në nenin 17, pg. I, pika "ë" të K. Pr. Penale, në rastin konkret ekzistojnë shkaqe të rëndësishme, të cilat mund të krijojnë dyshime për njëanshmëri dhe njëkohësisht problematike në përfaqësimin e kësaj çështjeje, duke krijuar tek palët e përfshira në proces ideja se nuk garantohet parimi i përfaqësimit të paanshëm. Vendimi është përcjellë me shkresën nr. 1219/1 prot., datë

07.07.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Nga sekretaria është bërë njoftimi me e-mail për hedhjen e shortit në 10.07.2023 dhe me vendimin për zëvendësimin e prokurorit çështja i ka kaluar prokurorit të zgjedhur me short.

7. Në praktikën me nr. 1861, datë 20.07.2023, prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal me shkakun *“Pala kërkuese nuk ka besim dhe ka kërkuar përjashtim publikisht në emisionin investigativ “STOP”*. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 17/ë, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit dhe pas shortit manual me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, çështja i ka kaluar prokurorit të zgjedhur me short.
8. Në praktikën me nr. 2965, datë 11.12.2023 është kërkuar heqja dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun se *“për shmangien e konfliktit të interesit dhe për të evituar çdo lloj paragjykimi të mundshëm në lidhje me disponimin përfundimtar të hetimeve të kësaj çështjeje, pasi nga prokurori është marrë vendim për refuzim të dhuratës”*. Me vendimin *“Për refuzimin e dhuratës”* është vendosur refuzimi i sendit dhuratë (parfum), nga personi nën hetim dhe pasi është marrë informacion zyres së regjistrimit mbi gjendjen e procedimit penal, me urdhër të drejtuesit është regjistruar kryesisht procedimi penal për veprën penale të korrupsionit aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 17, 26, 27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, si dhe urdhrin nr. 25, datë 25.07.2023 ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit me një prokuror tjetër, me arsyetimin se në lidhje me procedimin penal të mësipërm, prokurori ka marrë një vendim për refuzimin e dhuratës. Pranimi i kërkesës për zëvendësimin e prokurorit duhet të bëhet vetëm për arsye se në dhënien e drejtësisë është e rëndësishme jo vetëm dhënia e saj në bazë të ligjit, por edhe që për palët në proces dhe për publikun të krijohet një perceptim sa më i plotë se kjo drejtësi do të jepet. Pas hedhjes së shortit manual për procedimin penal me vendimin për zëvendësimin e prokurorit është vendosur zëvendësimi me prokurorin e caktuar me short.
9. Në praktikën me nr. 4032, datë 27.12.2023 prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i procedimit penal me shkakun *“Ngarkesa në punë; Ndodhet në procesin kalimtar të rivlerësimit në shkallën e dytë në KPA dhe dosja është voluminoze”*. Drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 17/ë, 26, 27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit dhe pas shortit manual me vendimin për zëvendësimin e prokurorit çështja i është caktuar prokurorit të zgjedhur me short. Pjesë e praktikës është dhe vendimi i datës 27.12.2023 i drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit të mëparshëm të shkarkuar nga KPK dhe në bazë të shortit manual është caktuar prokurori aktual.
10. Në praktikën me nr. 747 Regj, datë 05.05.2023, prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 27, pika 1, të K. Pr. Penale, me shkakun *“një nga*



personat e dyshuar ka qenë drejtor i institucionit ku i punësuar ishte djali i njërit prej prokurorëve të grupit hetimor për hetimin e kësaj çështjeje”. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 17, 26, 27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pas hedhjes së shortit manual me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, drejtuesi i prokurorisë ka vendosur zëvendësimin me prokurorin e zgjedhur me short.

11. Në praktikën me nr. 2401/1, datë 17.10.2023, prokurori ka paraqitur informacion në lidhje me kërkesën e kallëzuesit (kërkesa mungon) për zëvendësimin e prokurorit nga procedimin penal duke parashtuar se *“referuar neneve 16, 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa e paraqitur nga kallëzuesi nuk përbën shkak ligjor për heqjen dorë nga çështja penale dhe në këto kushte kërkesa të mos pranohet”*. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 15-17, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit me arsyetimin se kallëzuesi ka kërkuar përjashtimin e prokurorit nga ndjekja e hetimeve për procedimin penal duke parashtuar shkaqe të ndryshme, të cilat përmbledhtazi lidhen me pretendimet e kërkuarit për zvarritje të hetimeve, mosgarantim i të drejtave procedurale, shkelje e të drejtave të njeriut për shkaqe diskriminuese sepse kërkuar i përket komunitetit rom, mosmarrje në konsideratë të kërkesave të tij për kryerje të veprimeve hetimore etj. Rezulton se kërkuar i nuk ka bashkëlidhur kërkesës asnjë provë që të provojë pretendimet e tij. Një vendimmarrje dhe/ose veprimtari procedurale e prokurorit që bie ndesh me interesat e palëve në proces nuk mund të determinojë zëvendësimin e prokurorit nga vijimi i hetimeve. Një person që pretendon se prokurori është tendencioz, i njëanshëm apo ka krijuar mosmarrëveshje me palët në proces, duhet ta provojë një situatë të tillë me prova konkrete që tregojnë këtë pozicion të prokurorit. Pretendimet në lidhje me dilijencën në hetime dhe kryerjen e veprimeve të caktuara hetimore nga ana e prokurorit të çështjes, mund të parashtrohen nga kërkuar i duke kërkuar kontrollin e veprimtarisë së prokurorit. Pretendimi për zvarritje në hetime nga prokurori apo moskryerje të veprimeve hetimore, nuk është pretendim që gjen reflektim në ligj për të determinuar zëvendësimin e prokurorit, por është çështje që i përket kontradiktoritetit të shqyrtimit gjyqësor. Nuk rezultoi që kërkuar i të parashtrojë ndonjë provë ku të bazohet pretendimi për sjellje diskriminuese nga prokurori. Me shkresën nr. 10356/1 prot., datë 17.10.2023 kallëzuesi i është njoftuar vendimi i drejtuesit të prokurorisë.


12. Në praktikën me nr. 2815, datë 23.11.2023, shtetasja I. B., ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit me pretendimin se *“prokurori i çështjes, e ka thirrur në zyrë dhe i ka komunikuar që nëpërmjet mbrojtësit t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit dhe duke kërkuar që të caktohet masa arrest në shtëpi. Në seancë, prokuroria ka kërkuar rrëzimin e kësaj kërkesë. Në kushtet kur prokurori ka kryer veprime të njëanshme, duke orientuar palët në proces dhe duke qenë në kushtet e shpërdorimit të detyrës, për shkak se jemi para ushtrimit të ndjekjes penale të paligjshme, për një hetim sa më të besueshëm, kërkojmë zëvendësimin e prokurorit”*. Në lidhje me këtë kërkesë prokurori ka paraqitur informacion mbi procedimin penal dhe qëndrim mbi kërkesën e paraqitur nga shtetasja I. B., duke parashtuar se *“Kërkuarja ka kërkuar takim për të shprehur shqetësimet në lidhje me*



kërcënime të ndryshme që i kanë ardhur për shkak të marrëdhënieve me kallëzuesin si pasojë e çështjes në hetim dhe ka parashtruar kërkesën që të zbutet masa e sigurimit për bashkëshortin e saj. Në këto kushte është bërë me dije se referuar dispozitave procedurale kërkesën për zëvendësim të masës së sigurimit ta paraqesë përpara gjykatës. Është bërë me dije se nga prokurori është kërkuar masa e sigurimit "Arrest në burg" dhe çështja është ende në hetim". Referuar pretendimeve të kërkuases parashtrohet se nga prokurori nuk janë shprehur mendime apo qëndrime në lidhje me çështjen, nuk janë kryer veprime të njëanshme dhe procedimi penal është ende në hetim dhe nuk është disponuar me vendim pushimi. Në këto kushte, nuk gjendet përpara rasteve të parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale, të tilla që passjellin kërkimin për heqjen dorë apo përjashtimin nga hetimi i çështjes.

Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 17, 26, 27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, nenin 25, pika 4 dhe nenin 27 të K. Dr. P. M., si dhe Urdhër nr. 25, datë 25.07.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurores me arsyetimin se dhënia e informacionit mbi organin ku duhet të paraqitet një shtetas për të parashtruar një kërkesë, nuk është dhënie mendimi apo veprim që tregon njëanshmëri prej prokurorit, por është në përmbushje të detyrimeve ligjore për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Kjo është një situatë analoge me prokurorin apo gjyqtarin që në përmbushje të detyrimeve ligjore përcakton në pjesën e dispozitivit të vendimit që nxjerr, ndër të tjera, edhe organin ku mund të parashtrohet ankim ndaj këtij vendimi. Vendimi i drejtuesit i është njoftuar shtetasës I. B., me shkresën nr. 11871/1 prot., datë 23.11.2023.


13. Në gjashtë (6) praktika nga prokurori është kërkuar zëvendësimi për shkak të kalimit të kallëzimeve/procedimeve penale tek seksioni kompetent për të miturit, referuar urdhrin për ndarjen e seksioneve dhe dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Kërkesat ose informacionet në këto raste janë pranuar nga drejtuesi me vendimin për shqyrtimin e kërkesës me shkrim, bazuar në nenet 17, 26, 27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, nenin 25, pika 4 dhe nenin 27 të K. Dr. P. M., si dhe Urdhrit nr. 25, datë 25.07.2023, me arsyetimin se në zbatim të detyrimeve ligjore dhe me qëllim ruajtjen e standardit më të lartë të të miturit, në referim të përcaktimeve të bëra në Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur, duke qenë se ky kod parashikon ndjekjen e hetimeve për të miturit nga prokurorë të specializuar. Pas këtij vendimi është hedhur shorti manual nëpërmjet të cilit është caktuar prokurori tjetër. Me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 27, pika 1, është vendosur zëvendësimi i prokurorit me prokurorin e caktuar me shortin manual me arsyetimin se kur ekzistojnë shkaqe ligjore dhe prokurori nuk mund të vazhdojë veprimet në lidhje me këtë procedim penal, atëherë është e domosdoshme zëvendësimi i këtij prokurori për arsye ligjore.
14. Në dy (2) praktika është kërkuar zëvendësimi i prokurorit për shkak të kalimit të procedimit në Seksionin e Posaçëm Kundër Pastrimit të Parave, Krimeve Financiare, Financimin e Terrorizmit dhe Hetimit të Pasurisë, e para me shkakun se për të njëjtin person janë duke u kryer veprimet hetimore nga prokurori tjetër dhe drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 17/ë, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe me



vendimin për zëvendësimin e prokurorit çështja i ka kaluar direkt (pa short) prokurorit tjetër. Në praktikën tjetër për heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 15-17, 26-27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur mospranimin e kërkesës për heqjen dorë të prokurorit, me arsyetimin se heqja dorë e prokurorit për të ndjekur materialin është i pabazuar në ligj, pasi nuk gjen asnjë reflektim në nenet 15-16-17 dhe 26-27 të K. Pr. Penale. Ndarja e brendshme organizative e prokurorisë kryhet me qëllim ndarjen e punës dhe ngarkesës në mënyrë sa më proporcionale, por nuk është asnjë rrethanë shkak, që e bën një prokuror jo kompetent për të mos hetuar një material penal. Për këtë shkak edhe ligji nuk ka vendosur në asnjë moment, ndarjen dhe organizimin e brendshme të prokurorisë si argument për të justifikuar heqjen dorë, përjashtimin, refuzimin apo zëvendësimin e një prokurori nga materiali që i ngarkohet për hetim. Ndarja e brendshme organizative e një zyre prokurorie nuk pashjell moskompetencën lëndore dhe për pasojë nuk përbën shkak ligjor për zëvendësimin e një prokurori. Nëse një prokuror mendon se çështja që ka në ndjekje duhet hetuar, për shkak specializimi, në përputhje me organizimin e brendshëm të prokurorisë, mund të paraqesë një kërkesë me shkrim ku të parashtrojë kompleksitetin e çështjes dhe nevojën për ngritjen e grupit hetimor, në përbërje të së cilit të jetë edhe një prokuror i specializuar në fushën përkatëse. Nga ana e drejtuesit të prokurorisë janë pranuar vetëm kërkesat apo refuzimet e materialeve penale në të cilat kanë qenë të përfshirë si subjekte procedurale persona të mitur. Për më tepër që në kushtet aktuale të organikës së prokurorëve të kësaj prokurorie, të mungesës së madhe në këtë organikë dhe të rishpërndarjes së dosjeve të katër prokurorëve që rishitazi kanë dorëzuar dosjet për shkaqe ligjore, me qëllim ruajtjen e proporcionalitetit në ngarkesë, të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie përfshirë edhe prokurorin kërkues, kanë marrë ngarkesë hetimore dhe në gjykim për vepra penale që jo domosdoshmërisht përfshihen në grupin e veprave penale të seksionit ku ata bëjnë pjesë.

15. Nëntë (9) praktika i përkasin kërkesave për heqje dorë ose dhënie pëlqimi dhe zëvendësim të prokurorëve nga hetimet e procedimeve penale dhe përfaqësimin për gjykim/pushim të çështjeve me shkakun *“kthimin në punë të prokurores për shkak të mungesës për një periudhë për shkaqe shëndetësore, e cila nuk ka ngarkesë hetimore”*. Drejtuesi i prokurorisë në një vendim, bazuar në nenet 17, 26, 27 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e kërkesave për zëvendësimin e prokurorëve për procedimet penale dhe kërkesat gjykim/pushim. Procedimet penale dhe kërkesat gjykim/pushim i kanë kaluar prokurores së rikthyer me procesverbal dorëzimi konkretisht: nr. 137, datë 30.01.2024; nr. 227, datë 08.01.2024; nr. 341, datë 10.01.2024; nr. 340, datë 10.01.2024; nr. 445, datë 12.01.2024; nr. 535, datë 16.01.2024; nr. 1085, datë 30.01.2024.

16. Një (1) praktikë ka të bëjë me hedhjen në short manual të procedimeve penale në fazë hetimi për të cilat nga drejtuesi i prokurorisë me Urdhrin nr. 23, datë 27.03.2023 është vendosur trajtimi nga prokurorë të seksionit të përgjithshëm të dosjeve të dorëzuara nga prokurori, i cili me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 44, datë 23.02.2023 është komanduar si këshilltar ligjor në KLP, nga data 15.03.2023 deri më datë 14.03.2028. Në këtë short është



përfshirë dhe drejtuesi i prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për shkak të ngarkesës së madhe që ka ky seksion. Me vendimin për zëvendësimin e prokurorit ky prokuror është zëvendësuar nga procedimet penale në fazë hetimi, me prokurorin e caktuar me short.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1328/10 prot., datë 17.05.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në lidhje me zëvendësimet e prokurorëve në këtë prokurori.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë është përgjigjur me shkresën nr. 2924/1 prot., datë 04.06.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1328/24 prot., datë 10.06.2024.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë është paraqitur një (1) kërkesë për heqje dorë e prokurorit në fazë gjykimi e cila nuk na është vendosur në dispozicion, bazuar në nenet 16, 17 , pika 1, germa “c” të K. Pr. Penale, me shkakun *“Papajtueshmëri për shkak lidhje gjinie ose familjare, për shkak të lidhjeve familjare dhe gjinore të paraardhësve të prokurorit dhe të pandehurit.* Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenin 26/2 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë të prokurorit nga gjykimi i procedimit penal dhe zëvendësimin e tij me prokurorin e caktuar me short, me arsyetimin se nga verifikimet e kryera rezulton se kërkesa e prokurorit është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

6. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillimisht me shkresën nr. 1328/12 prot., datë 17.05.2024, si dhe shkresën nr. 1328/38 prot., datë 25.07.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në lidhje me zëvendësimet e prokurorëve. Nga kjo prokurori me shkresën nr. 5290/1 prot., datë 29.05.2024, regjistruar pranë ILD me nr. 1328/19 prot., datë 30.05.2024, janë paraqitur kërkesat për heqje dorë nga hetimi i procedimeve penale, të paraqitura nga prokurorët dhe vendimet e drejtuesit të prokurorisë, të cilat nuk identifikohen me numër/datë regjistrimi. Në këto praktika nuk na është vendosur në dispozicion shorti për caktimin e prokurorit zëvendësues.

1. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun *“paanshmëri në hetime për shkak të pretendimeve të palëve në hetim si dhe ngarkesa në punë”*, pasi me anë

të memos së datës 01.02.2023 kallëzuesi ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 17, 27/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, si dhe hedhjen në short të procedimit penal për caktimin e prokurorit që do të ngarkohet me hetimin e saj, me arsyetimin se prokurori i çështjes prej momentit të regjistrimit të çështjes penale nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprim hetimor, ka dhënë pëlqimin për zëvendësim dhe njëkohësisht edhe vetë kallëzuesi ka kërkuar përjashtimin e tij nga hetimi i kësaj çështjeje penale.

2. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga kallëzimi penal bazuar në nenet 16, 17/d, germa “ë” të K. Pr. Penale, me shkakun *“prokurori ka njohje me viktimën dhe personin nën hetim dhe njëkohësisht edhe fqinj i tyre, si dhe ka lidhje familjare me familjarët e viktimës së veprës penale”*. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 17 dhe 27/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, si dhe hedhjen në short të procedimit penal, me arsyetimin për të garantuar paanshmërinë e hetimit të kësaj dosjeje penale jo vetëm objektivisht, por edhe në kuptim të perceptimit të këtij objektiviteti nga palët.
3. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimin i procedimit penal me shkakun *“Kalim procedimi tek Seksioni për të miturit”*. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 24 dhe 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe për hetimin e procedimit ngarkohet prokurori i seksionit për të mitur”.

7. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1328/2 prot., datë 17.05.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në lidhje me praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve në këtë prokurori. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. 5000/1 prot., datë 10.06.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1328/30 prot., datë 13.06.2024, si dhe me shkresën nr. 7750/1 prot., datë 01.08.2024, regjistruar pranë ILD me nr. 1328/43 prot., datë 05.08.2024, ka dërguar rastet e zëvendësimit të prokurorëve. Në këto praktika deklarimet e prokurorëve dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohen me numër dhe datë regjistrimi.

1. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë (nuk gjendet deklarimi i heqjes dorë) nga hetimet e procedimit penal me shkakun *“palët disa herë kanë kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga çështja që ka pasur në hetim si dhe kanë paraqitur kallëzim penal ndaj tij për shkak se me kallëzuesen për shkak të materialeve të mëparshme që ka pasur në hetim apo verifikim ka hequr dorë nga hetimi/verifikimi i kallëzimeve të këtyre shtetasve, për shkak se ata në vazhdimësi kanë kërkuar zëvendësimin e tij në kallëzimet e tyre duke e lidhur këtë fakt me shkaqe njëanshmërie në trajtimin e kallëzimeve të tyre. Po kështu kallëzuesit kanë depozituar edhe kallëzim penal ndaj prokurorit në lidhje me vendimmarrje të mëparshme që ai ka pasur*

ku palë kallëzuese kanë qenë shtetasit e mësipërm". Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 17/ë 24, 26-27, 277 e vijues të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e deklaratës së prokurorit për heqjen dorë dhe ta zëvendësojë me një prokuror tjetër, i cili do të caktohet pas zhvillimit të procedurave të shortit, me arsyetimin se arsyet e paraqitura nga prokurori janë të ligjshme dhe në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale. Nëpërmjet procesverbalit të shortit manual rezultoi se është caktuar prokurori i ri.

2. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë (nuk gjendet kërkesa e prokurorit) nga hetimi i procedimit penal me shkakun "*prokurori ka qenë avokat i një prej viktimave në kohën para se të merrte detyrën në një procedim penal tjetër*", ku bashkëlidhur ka paraqitur dhe vendimin nr. 12, datë 08.01.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 16, 17/b 24, 26-27, 277 dhe 110 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, ka vendosur pranimin e deklaratës për heqje dorë të prokurorit dhe zëvendësimin e tij, nëpërmjet hedhjes në short të procedimit penal, por nuk na është vendosur në dispozicion shorti për caktimin e prokurorit zëvendësues.
3. Drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 16-17, 24, 26/2, 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga hetimi i shtatë (7) procedimeve penale, me arsyetimin se për shkak të ngarkesës së madhe, fakti se prokurori është drejtues seksioni dhe për faktin se seksionit për të miturit dhe ekzekutimeve i është shtuar një prokuror tjetër, këto procedime penale të kalojnë për hetim duke iu caktuar drejtpërdrejt këtij prokurori.
4. Gjithashtu në praktikën e të njëjtit prokuror drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 16-17, 24, 26/2, 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga hetimi i tre (3) procedimeve penale, pasi pas pezullimit nga detyra të prokurores së ngarkuar me hetimin nga KPK, si dhe për faktin se seksionit për të miturit dhe ekzekutimeve i është shtuar një prokuror tjetër, këto procedime penale të kalojnë për hetim, duke iu caktuar drejtpërdrejt këtij prokurori.
5. Prokurori ka bërë kërkesë për heqje dorë nga hetimet e procedimit penal në fazë gjykimi me shkakun "*ekzistojnë shkaqe serioze njëanshmërie, bazuar në nenet 17 dhe 26 të K. Pr. Penale, pasi me të pandehurin ka lidhje të afërta gjinie dhe konkretisht është djali i xhaxhait*". Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 17/ë, 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur miratimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit me hedhjen në short të procedimit penal, me arsyetimin se lidhje të afërta gjinie me të pandehurin dhe konkretisht djali i xhaxhait të prokurorit, përbën shkak serioz njëanshmërie, që do të cenonte dhe paragjykonte zgjidhjen e çështjes, por nuk na është vendosur në dispozicion shorti për caktimin e prokurorit zëvendësues.
6. Prokurori ka paraqitur memo për kalimin e procedimit penal tek prokurori i caktuar me ligj, duke kërkuar zëvendësimin nga hetimi i procedimit me shkakun "*pas kryerjes si prokuror i*



gatshëm të veprimeve të ngutshme përsa i përket vleftësimit të ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit ndaj personit të ndaluar, procedimi penal duhet t'i kalojë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme prokurorit që është caktuar fillimisht sipas "Formularit mbi dokumentimin e shortit elektronik dhe shpërndarjes së çështjeve". Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin pa short të procedimit penal prokurorit, të cilit i është shortuar fillimisht kallëzimi penal.

7. Prokurori ka paraqitur memo në lidhje me zëvendësimin nga kallëzimi penal me shkakun "në kryerjen e veprimeve paraprake të sekuestrimit të provave materiale të konstatuara në vendngjarje, oficeri i policisë gjyqësore është konsultuar me prokurorin që ka qenë i gatshëm ditën e ngjarjes. Rrjedhimisht bazuar në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, është ky prokuror që ka bërë dhe vleftësimin e sekuestrimit të provave materiale apo veprimeve të tjera me natyrë urgjente. Për të hetuar këtë procedim kompetent mbetet prokurori i cili ka qenë i gatshëm ditën e ngjarjes, pasi është dhe prokurori që ka drejtuar hetimet në momentet fillestare". Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 16, 17/ë 24, 26-27, 277 dhe 110 të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 97/2016, Urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014 "Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve" ka vendosur pranimin e deklaratës për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, kalimin direkt të procedimit penal tek prokurori, i cili ka kryer veprimet paraprake hetimore ditën e ngjarjes.
8. Në njëzet e nëntë (29) praktika zëvendësimi i prokurorit është kryer për shkak të kalimit të kallëzimeve/procedimeve penale në seksionet kompetente, (katërmbëdhjetë) 14 raste seksionit për të mitur (bazuar në urdhrin nr. 15, datë 08.09.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë, Urdhrin nr. 12, datë 29.09.2023 të drejtuesit të prokurorisë "Për riorganizimin në seksione, përcaktimin e veprave penale që do të trajtohen nga secili seksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë), tre (3) raste seksionit të posaçëm kundër pastrimit të parave, etj., (bazuar në Urdhrin nr. 1, datë 29.01.2021, Urdhrin nr. 15, datë 08.09.2022 të drejtuesit të prokurorisë), dymbëdhjetë (12) raste seksionit të përgjithshëm (bazuar në Urdhrin nr. 15, datë 08.09.2022, Urdhrin nr. 12, datë 29.09.2023 të drejtuesit të prokurorisë). Memot e prokurorëve për këto raste janë bazuar në urdhrat për ndarjen në seksione dhe pranuar nga drejtuesi i prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit me short bazuar në nenet 24, 27/1, të K. Pr. Penale, nenet 43 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 "Për Organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë". Në këto praktika nuk ka dokument për caktimin e prokurorit zëvendësues me short, në 13 praktika mungon dhe vendimi i drejtuesit, ku vetëm në 7 nga këto është vendosur shorti elektronik nga sistemi Cams sipas të cilit është caktuar me short prokurori tjetër, ndërsa në 1 prej këtyre prokurori është caktuar me short manual. Në një praktikë prokurori është caktuar pa short, duke caktuar prokurorin i cili në bazë të grafikut të gatishmërisë për muajin prill 2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka qenë i gatshëm në datën kur ka ndodhur fakti penal.
9. Në zbatim të Urdhrit nr. 11, datë 19.09.2023 të drejtuesit të prokurorisë është hedhur në short manual procedimi penal i kthyer nga gjykata për vazhdimin e hetimeve, pasi prokurori i

çështjes është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe dosja duhet të rishortohet në seksionin për hetimin e krimit ekonomik pastrimit të parave financimit të terrorizmit dhe hetimit pasuror, seksion në të cilin janë 3 (tre) prokurorë. Duke qenë se dy nga prokurorët janë zëvendësuar më parë nga hetimi i këtij procedimi, kurse prokurorja tjetër është motra e gjyqtarit i cili ka kthyer aktet për vazhdimin e hetimeve, kanë pengesë ligjore për hetimin e këtij procedimi. Kjo dosje do të shortohet tek prokurorët e seksionit të veprave të tjera. Në këtë rast nuk është vendosur në dispozicion procedura e mëtejshme për zëvendësimin e prokurorit.


8. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në përgjigje të shkresës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1328/11 prot., datë 07.05.2024 ka dërguar të dhënat për inspektimin tematik me shkresën nr. 7872/1, datë 31.05.2024, protokolluar në ILD me nr. 1328/1, datë 04.06.2024. Kjo prokurori për vitin 2023 ka dërguar praktikat e zëvendësimit, ku deklarimet për heqje dorë dhe vendimet e drejtuesit identifikohen nga numri dhe data e regjistrimit.

1. Në praktikën me nr. 2327, datë 23.11.2023, prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun *“Pamundësi për të hetuar dosje të vjetra dhe komplekse për shkak ngarkese”*, pasi prokurori është bërë pjesë e grupit hetimor. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 17 dhe 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit nga hetimi i çështjes penale, si pjesë e grupit hetimor, me arsyetimin se pretendimet dhe argumentet e prokurorit për heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale dhe pjesëmarrja në grup hetimor nuk lidhen me kriteret ligjore të nenit 26 lidhur me nenet 17, 15 e 16 të Kodit të Procedurës Penale. Sikurse arsyetohet në Urdhrit nr. 53, datë 22.11.2023 të drejtuesit të prokurorisë *“Për krijimin e grupit hetimor”*, grupi hetimor është krijuar për shkak të kompleksitetit të çështjes, afati i gjatë i hetimit që ka kaluar nga momenti i regjistrimit të procedimit penal etj., me qëllim kryerjen e hetimeve të plota, objektive dhe të gjithanshme, vlerësimin e provave dhe vendosjen mbi mënyrën e përfundimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe ligjor. Caktimi i prokurorëve të grupit hetimor është bërë edhe nisur nga kriteri objektiv që lidhet me faktin që këta prokurorë kanë qenë më parë prokurorë të çështjes penale apo çështjeve të tjera të bashkuara me çështjen penale në fjalë dhe kanë njohje më të mira mbi objektin apo rrethana të caktuara të hetimeve. Pas njoftimit të vendimit për rrëzimin e kërkesës për heqje dorë, prokurori i ka paraqitur drejtuesit të prokurorisë *“Kërkesë për informacion dhe për shfuqizimin e ndryshimin e Urdhrit nr. 53, datë 22.11.2023 për krijimin e grupit hetimor”*.
2. Në praktikën me nr. 03, datë 06.12.2023, prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal në fazë gjykimi, bazuar në nenet 26 dhe 17 të K. Pr. Penale me shkakun *“prokurori ka njohje me vajzën e personit nën hetim, prej disa kohësh, duke pasur dhe kontakte të*

vazhdueshme". Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 26 e 17, pika 1, germa "ë" të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit nga ndjekja e përfaqësimit të çështjes penale, me arsyetimin se bazuar në parimet e ligjit procedural penal dhe gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut, anësia duhet të shmanget qoftë në thelb ashtu edhe në dukje, pra, si në përmbajtje ashtu edhe në formë. Në rastin konkret, njohja personale me vajzën e të pandehurit është një rrethanë/shkak i rëndësishëm që do të vinte në dyshim paanësinë e prokurorit në çështjen konkrete objekt gjykimi ndaj të pandehurit, duke dëmtuar parimet e një procesi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor. Sipas procesverbalit për hedhjen në short të çështjeve penale/praktikës së ekzekutimit, çështja i është caktuar një prokurori tjetër.

3. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenet 17 dhe 26/1 të K. Pr. Penale me shkakun *"prokurori ka hetuar më parë subjektet e kallëzimit dhe ka pasur kontradikta gjatë procesit dhe nëse prokurori do të ushtronte vendimmarrjen edhe për këtë çështje do të paragjykohej nga ana e palës dhe zgjidhja e çështjes do të ishte e cenueshme ligjrisht"*. Bashkëlidhur është dorëzuar edhe kopje e vendimit gjyqësor penal i Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i cili vërteton përfaqësimin në Gjykatë nga prokurori i çështjes penale në ngarkim të të pandehurve që ka edhe në procedimin aktual, të deklaruar fajtor nga kjo gjykatë. Drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 17 e 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit, me arsyetimin se janë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 26 e 17, pika 1, germa "ë" të Kodit të Procedurës Penale. Për shkak të kontradiktave në çështjen që ka ndjekur me parë kundër personit nën hetim dhe tre familjarëve të tij, do vihej në dyshim paanësia e tij në çështjen konkrete objekt hetimi, duke dëmtuar parimet e një procesi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor. Sipas procesverbalit për hedhjen në short të çështjeve penale/praktikës së ekzekutimit është caktuar një prokuror tjetër.
4. Në praktikën me nr. 813/1, datë 04.07.2023 prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i procedimit penal bazuar në nenin 17, pika 1, germa "ë" të K. Pr. Penale me shkakun se *"prokurori është konfliktuar me të pandehurën pas njoftimit të akuzës dhe përfundimit të hetimeve, e cila e ka konsideruar si të njëanshëm. Po kështu gjatë seancës paraprahe e pandehura ka qenë agresive ndaj prokurorit, duke kërkuar me insistim, përjashtimin e tij nga përfaqësimi i kësaj çështjeje në gjykim. Në seancën e gjykimit në themel nga gjyqtarja e seancës, është relatuar se, e pandehura ka bërë ndaj prokurorit kallëzim në SPAK"*. Për këtë prokurori ka paraqitur dhe një informacion për çështjen penale. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 17, pika 1, germa "ë" të 26 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit nga përfaqësimi në gjykim i çështjes penale, duke arsyetuar se bashkëlidhur deklaratës për heqje nuk është paraqitur asnjë dokument që njofton kallëzimin penal të të pandehurve apo regjistrimin e ndonjë kallëzimi/procedimi lidhur me sa pretendohet në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë apo në Prokurori të Juridiksionit të Përgjithshëm. Tashmë është në kompetencë të gjykatës të vlerësojë veprimet e prokurorit dhe bazueshmërinë në ligj dhe prova të akuzës së ngritur



prej tij. Në këto rrethana, nuk rezultojnë të dhëna që prokurori ka shkaqe të rëndësishme njëanshmërie që e bëjnë të nevojshme zëvendësimin e tij nga përfaqësimi i çështjes në gjykim. Fakti që nga ana e të pandehurve ngrihen pretendime ndaj prokurorëve apo avancohet në kallëzime penale ndaj tyre, nuk përbën në vetvete shkak për heqje dorë apo përjashtimin e tyre, pasi në këtë mënyrë, ato munden që fiktivisht të paraqesin kërkesa të tilla për të “përzgjedhur” prokurorët. Në këtë mënyrë do vihej në dyshim parimi i prokurorit të caktuar me ligj.

5. Në katër (4) praktika nga prokurori është kërkuar heqja dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun e kalimit të procedimit penal tek seksioni kompetent, konkretisht tre (3) raste seksionit të përgjithshëm. Në dy prej tyre drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 26 lidhur me nenet 16 e 17 dhe nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se në bazë të udhëzimit nr. 03, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, i ndryshuar, kreu V, pika 1, ndër të tjera parashikohet se, nëse ushtrimi i ndjekjes penale bëhet kryesisht nga prokurori, çështja i caktohet atij prokurori pa u hedhur në short. Në praktikën tjetër drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dhe kallëzimi penal të rihidhet në short midis prokurorëve që nuk janë pjesë e seksionit të posaçëm”. Me anë të shortit elektronik është caktuar prokurori tjetër. Në praktikën për kalimin e procedimit penal seksionit të posaçëm kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore (bazuar në urdhrin nr. 08, datë 26.07.2023 të drejtuesit të prokurorisë), është pranuar kërkesa, me arsyetimin se çështja penale është shortuar gabimisht për prokurorët që ndjekin veprat e tjera penale në Prokurorinë Fier, sepse vepra penale për të cilën ndiqet kjo çështje penale është në kompetencë lëndore të seksionit të posaçëm dhe procedimi i është caktuar me short manual një prokurori tjetër.

9. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

Në përgjigje të shkresës nr. 1328/13 prot., datë 17.05.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të dhënat në kuadër të inspektimit tematik, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka dërguar rastet e zëvendësimit të prokurorëve me shkresën nr. 3638/1, datë 12.06.2024, protokolluar në ILD me nr. 1328/31, datë 14.06.2024. Në këto praktika deklaramet e prokurorëve dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohen me numër dhe datë regjistrimi.

1. Prokurori ka referuar rastin në bazë indiciesh dhe me vendim të drejtuesit të prokurorisë për kalimin e kallëzimit penal është vendosur caktimi i kallëzimit penal një prokurori tjetër, me arsyetimin për të mos pasur konflikt interesi të prokurores dhe duke qenë se një nga prokurorët është i përjashtuar nga shorti elektronik/manual. Gjithsesi është mbajtur dhe procesverbal me anë të të cilit kallëzimi i kalohet direkt prokurorit tjetër.

2. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal në fazë gjykimi bazuar në nenin 26, të K. Pr. Penale, me shkakun *“i pandehuri ka paraqitur disa herë ankesa në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat janë verifikuar duke mos pranuar ankesat dhe është marrë vendimi për mbylljen e hetimit administrativ. Po ashtu në seanca gjyqësore i pandehuri ka paraqitur disa herë pakënaqësi lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke pretenduar për njëanshmëri gjatë hetimit”*. Drejtuesi i Prokurorisë, bazuar në nenet 16, 17, 24, 26, 27, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe zëvendësimin e tij, me arsyetimin se në shkaqet e parashtruara nga prokurori çmohet se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie. Procedimi i është caktuar një prokurori tjetër me short manual.

3. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun *“kallëzuesen në këtë procedim penal e ka si person nën hetim në një procedim tjetër penal dhe në këtë të fundit ajo ka pretendime ndaj prokurorit se hetimi, veprimet procedurale hetimore, si dhe caktimi i masës së sigurimit ndaj saj janë kryer në shkelje të detyrës dhe me qëllime dashakeqëse. Lidhur me këto pretendime kjo shtetase është ankuar vazhdimisht duke bërë edhe ankesa në media, si dhe deklarata publike dhe po ashtu rezulton se ka paraqitur edhe kallëzime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës etj.”*. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 16, 17, 24, 26, 27 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit me arsyetimin se në rastin konkret rezulton se kallëzuesja ka paraqitur një kallëzim penal ndaj prokurorit e për pasojë çmohet se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie. Sipas procesverbalit të shortit manual procedimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.

4. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun *“personi nën hetim ka pretendime se hetimi, veprimet procedurale hetimore, si dhe caktimi i masës së sigurimit ndaj saj janë kryer në shkelje të detyrës dhe me qëllime dashakeqëse ndaj saj. Kjo shtetase është ankuar vazhdimisht duke bërë edhe ankesa në media, si dhe deklarata publike dhe po ashtu rezulton se ka paraqitur edhe kallëzime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës etj.”*. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 16, 17, 24, 26, 27 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se personi nën hetim ka paraqitur një kallëzim penal ndaj prokurorit e për pasojë çmohet se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie. Procedimi penal i është caktuar prokurorit tjetër me short manual.


5. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë (kërkesë e cila mungon) nga kallëzimi penal, por nga vendimi i drejtuesit të prokurorisë rezulton se heqja dorë është kërkuar me shkak se *“prokurori ka vendosur më parë mosfillimit e procedimit penal për të njëjtin kallëzues, i cili pas këtij vendimi mosfillimi ka bërë kallëzim ndaj prokurorit”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë, bazuar në parashtrimet e prokurorit dhe sipas procesverbalit të shortit manual çështja i është caktuar një prokurori tjetër.

6. Prokurori ka kërkuar zëvendësimin nga hetimet e procedimit penal në zbatim të nenit 26 të K. Pr. Penale, me shkakun *“në këtë çështje është në kushtet e konfliktit të interesit me personin e dëmtuar dhe autorin e dyshuar të veprës penale, konkretisht duke qenë në një lidhje faktike me personin, i cili të dëmtuarin e ka lidhje gjaku të shkallës së tretë dhe kanë ruajtur marrëdhënie familjare të ngushta me njëri-tjetrin. Po ashtu ka njohje me djalin e të dëmtuarit”*. Drejtuesi i Prokurorisë, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe sipas procesverbalit të shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
7. Në pesë (5) praktika prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun e kalimit të kallëzimit penal tek seksioni kompetent, tre (3) raste seksionit të përgjithshëm dhe dy (2) raste seksionit të posaçëm, në bazë të Urdhrit nr. 11, datë 03.05.2023 *“Për ndarjen e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës”*. Nga drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenin 26 të K. Pr. Penale është vendosur pranimi i këtyre kërkesave dhe me short manual të hedhur midis prokurorëve të seksionit kallëzimet penale i janë caktuar prokurorit tjetër. Në një praktikë ku është kërkuar heqja dorë dhe kalimi i procedimit te seksioni i posaçëm drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë duke ia caktuar kallëzimin penal drejtpërdrejt prokurorit të seksionit të posaçëm.

10. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

Në përgjigje të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1328/2, datë 17.05.2024, lidhur me *“Praktikën e ndjekur dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve”*, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me shkresën nr. 8271/1, datë 20.06.2024, protokolluar në ILD me nr. 1328/32, datë 24.06.2024, ka dërguar praktikat e zëvendësimit të prokurorëve për vitin 2023. Në këto praktika deklarimet e prokurorëve dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohen me numër dhe datë regjistrimi.

1. Prokurori ka paraqitur informacion për heqjen dorë nga kallëzimi penal me shkakun se *“kallëzuesja ka bërë disa herë kallëzime ndaj prokurorit dhe ka shfaqur në mënyrë të vazhdueshme pretendime lidhur me rastet e trajtuara më parë nga prokurori duke parashtruar kërkesa për zëvendësim dhe ankesa në institucione të ndryshme”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur miratimin e kërkesës për heqjen dorë për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në arsyet e prokurorit dhe sipas procesverbali të shortit manual kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
2. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal, bazuar në nenin 26 të K. Pr. Penale, me shkakun *“nisur nga kompleksiteti i çështjes, natyrën e akuzave penale, pasojave të ardhura, por edhe nga pretendimet e babait të viktimës së veprës penale ndaj punës hetimore të prokurorit për mos zbulimin e autorëve, pasi sipas tij ngjarja ka lidhje me një ngjarje tjetër ku pjesë e grupit hetimor është dhe prokurori”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin




e kërkesës për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, bazuar në arsyetimin e prokurorit, duke u caktuar prokurori tjetër me short manual.

3. Në praktikën me nr. 14833 prot., datë 14.11.2023 është paraqitur kërkesa e viktimës së veprës penale për heqjen dorë ose përjashtimin e prokurorit nga hetimi i çështjes, me pretendimin *“njëanësi nga prokurori i çështjes, për arsye se prokurori ka njohje me bashkëshorten e të akuzuarit. Gjithashtu prokurori ka njohje dhe me disa nga dëshmitarët okularë të cilët kanë qenë prezent në momentin e ndodhjes së ngjarjes. Ndër të tjera prokurori ka pasur diskutime/mendime me punonjës të gjykatës në lidhje me rastin objekt hetimi”*. Në lidhje me këtë kërkesë prokurori i çështjes ka paraqitur informacion, ku ka kërkuar të mos pranohet pretendimi i ankuesit, pasi nuk përbën shkak për përjashtim nga procedimi penal, duke parashtruar se *“nuk është në kushtet ligjore për heqjen dorë apo zëvendësimin e tij, duke pranuar se ka njohje me bashkëshorten e të dyshuarit, si punonjëse, por nuk ka pasur asnjë marrëdhënie hierarkie apo punëdhënës i saj. Të njëjtën njohje ka dhe me kërkuesin të dëmtuarin në këtë procedim penal, si punonjës pranë Gjykatës së Shkallës Parë”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit dhe vendimi i është njoftuar ankuesit me shkresën nr. 14833/1 prot., datë __.11.2023.
4. Në praktikën me nr. 14640 prot., datë 18.12.2023 rezulton kërkesa e të njëjtit viktimë të veprës penale për zëvendësimin e prokurorit, me pretendimin *“nuk janë kryer hetime paraprake të shpejta e të thelluara 2 muaj pas ngjarjes; nuk janë pranuar kërkesat e viktimës për zgjerimin e hetimeve me marrje të provave; nuk është informuar për gjendjen e procedimit, apo për masat e sigurimit të marra ndaj autorit të dyshuar, prokurori në kohë të ndryshme dhe në momente të ndryshme ka qëndruar edhe në dreka/darka, kafe me bashkëshorten e personit që ka nën hetim, sipas fotografive të paraqitura nga viktimia”*. Nga ana tjetër edhe prokurori i çështjes ka paraqitur informacion në lidhje me këtë kërkesë, ku ka kërkuar të pranohet pretendimi i ankuesit me arsyetimin *“se referuar nenit 17, germa “ç” të K. Pr. Penale nuk e gjen veten në asnjë situatë konflikti interesi, apo shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, por për të shmangur çdo lloj interpretimi dhe paragjykimi të mëvonshëm në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje penale, referuar shfaqjes së hapur të humbjes së besimit të kërkuesit në zgjidhjen e çështjes”*. Drejtuesi i Prokurorisë në këtë rast ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit bazuar në arsyetimin për të hequr çdo mëdyshje lidhur me objektivitetin në qëndrimin e prokurorit në hetimin e çështjes penale. Sipas procesverbalit të shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.

11. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë

Në përgjigje të shkresës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 1328/15 prot., datë 17.05.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë ka informuar me shkresën nr. 1530/1, datë 20.07.2024, protokolluar në ILD me nr. 1328/41 prot., datë 01.08.2024, duke



dërguar dokumentacionin në lidhje me praktikën për zëvendësimin e prokurorit gjatë vitit 2023. Në këto praktika deklarimet e prokurorëve për heqje dorë me përjashtim të një rasti dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohen me numër dhe datë regjistrimi.

1. Në praktikën me nr. 988/3, datë 22.08.2023 prokurori ka bërë deklaratë për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 16/1 i K. Pr. Penale dhe nenin 17, pika 1, germa “e” të K. Pr. Penale me shkakun *“njëri nga deklaruesit në procedimin penal është djali i xhaxhait të prokurorit”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës me arsyetimin se rezulton se midis prokurorit dhe njërit nga personat e intervistuar në cilësinë e personit që kanë dijani për rrethanat e hetimit dhe që potencialisht do të gëzojë edhe cilësinë e dëshmitarit në procesin gjyqësor ekziston një lidhje gjinie e afërt, çka e vendos prokurorin në pozita papajtueshmërie në ushtrimin e detyrës në kuptim të nenit 16 të K. Pr. Penale e për rrjedhojë kanë lindur arsye serioze që lidhen me ushtrimin e detyrës, të cilat mund të kenë në dukje lidhje me shkaqe të tjera njëanshmërie për të zëvendësuar prokurorin e çështjes. Prokurori zëvendësues është caktuar me short elektronik të paraqitur nga sistemi Cams.
2. Prokurori ka paraqitur deklaratë për heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17, pika 1, germa “ë” të K. Pr. Penale, me shkakun *“kallëzuesi ka cilësinë e të pandehurit në një tjetër procedim penal në gjykim nga prokurori në të cilin ai ka paraqitur kallëzim penal ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit me pretendimin se nuk është nënshkruar prej tij. Gjithashtu këtë pretendim e ka paraqitur edhe në seancë gjyqësore”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaratës për heqjen dorë të prokurorit dhe zëvendësimin me një nga prokurorët e tjerë, e cili është caktuar nëpërmjet shortit elektronik të paraqitur nga sistemi Cams.
3. Nga drejtuesi i prokurorisë është referuar në kthim përgjigje edhe për dy raste të tjera zëvendësimi të prokurorit, në lidhje me kallëzimin penal për të cilin nuk është dërguar praktika e zëvendësimit, pasi sipas sqarimit është disponuar me vendimi pushimi në Janar 2024 dhe nuk mund të bashkëlidhen materialet për shkak të pamundësisë së sekretarisë për ta vënë në dispozicion. Gjithashtu, nuk është dërguar praktika e zëvendësimit në lidhje me kallëzimin tjetër, për të cilin drejtuesi ka sqaruar se nga prokurori i caktuar nuk u pranua vendosja në dispozicion e akteve të kërkuara.
4. Në tre (3) praktika zëvendësimi i prokurorit është bërë në bazë të informacionit për kalimin e materialit kallëzues tek prokurori kompetent, një (1) rast për seksionin e posaçëm (bazuar në urdhrin nr. 53, datë 06.09.2023 *“Për caktimin e prokurorit përgjegjës për ndjekjen e çështjeve kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore”*) dhe dy (2) raste për prokurorin që mbulon çështjet me të mitur. Këto informacione të prokurorëve janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë duke vendosur pranimin e deklaratës së prokurorit dhe zëvendësimin me prokurorin e ngarkuar për trajtimin e çështjeve të hetimit pasuror ose çështjeve me të mitur.

5. Drejtuesi i prokurorisë me vendimin për zëvendësimin e prokurorit ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga drejtimi i hetimeve të procedimin penal dhe përzgjedhjen e prokurorit tjetër nëpërmjet procedurës së shortit manual. Nga vendimi i drejtuesit të prokurorisë rezulton se ai fillimisht ka nxjerrë udhëzimin jo detyrues nr. 5, datë 16.06.2023, nëpërmjet së cilës udhëzon që prokurori të paraqesë kërkesë për heqjen dorë nga hetimet, duke qenë se ndodhet në kushtet e nenit 17, pika 1, germa “ë” të K. Pr. Penale, ndaj të cilit prokurori ka paraqitur kundërshtime, të cilat nuk janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë, duke i ripërsëritur qëndrimin për heqjen dorë. Në datën 04.07.2023 drejtuesi i prokurorisë Sarandë, nëpërmjet vendimit “Për zëvendësimin e prokurorit”, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga drejtimi i hetimeve për procedimin penal, duke argumentuar se prokurori i çështjes ndodhet në rrethanat e parashikuara nga nenet 17, pikat “e” dhe “ë” dhe 26, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale.

Referuar vendimit të drejtuesit të prokurorisë *për zëvendësimin e prokurorit*, konstatohet se është bazuar në nenin 16, në nenin 17, pika 1, gjerat “e” dhe “ë”, nenin 26, pika 1 dhe në nenin 27, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale. Drejtuesi i prokurorisë ka vlerësuar se në kuptim të nenit 27, pika 1 të K. Pr. Penale, **ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit** që prokurori i çështjes të zëvendësohet me një prokuror tjetër, pasi në këtë rast ekzistojnë shkaqet për të proceduar me zëvendësimin e prokurorit në referim të shkakut ligjor si ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme të njëanshmërisë dhe ndodhjes në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga neni 16 i K. Pr. Penale, pasi fakti që në procedim penal është pyetur si deklarues dhe kushëriri i prokurorit e vendos atë në një pozitë njëanshmërie në kuptim të nenit 17/1, germa “e” të K. Pr. Penale, por gjithashtu edhe në pozita papajtueshmërie në ushtrimin e detyrës në kuptim të nenit 16 të K. Pr. Penale.

Me Urdhrin nr. 42, datë 05.07.2023 të drejtuesit të prokurorisë “*Për zhvillimin e procedurave për hedhjen e shortit*”, ku pas dorëzimit të dosjes së procedimit penal në zbatim të vendimit për zëvendësimin e prokurorit datë 04.07.2023 është urdhëruar të hidhet në short manual ky procedim penal midis 4 prokurorëve që ushtrojnë detyrën në Prokurorinë Sarandë. Në datën 6.7.2023 sipas “*Procesverbal për zhvillimin e procedurave për hedhjen e shortit manual*” në zyrën e drejtuesit të prokurorisë është hedhur në short manual procedimi penal midis tre prokurorëve, duke ju caktuar njërit prej tyre.

Ndaj vendimit të drejtuesit të prokurorisë “*Për zëvendësimin e prokurorit*” ka dërguar ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë prokurori, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Ankuesi ka kundërshtuar vendimin e zëvendësimit duke pretenduar se nuk ndodhet përpara rasteve dhe kushteve të parashikuara nga ligji procedural penal. Sipas vendimit të drejtuesit të prokurorisë, prokurori ndodhet në rrethanat e parashikuara nga neni 17, pika 1, gjerat “e” dhe “ë”, si dhe neni 26 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk mund ti referohemi rasteve të përcaktuara në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale, që do të legjitimonin drejtuesin e prokurorisë që të zëvendësoj prokurorin e çështjes, pasi në çdo rast

tjetër, kërkohet pëlqimi i prokurorit, që në këtë rast nuk është dhënë. Në referim të nenin 16 të K. Pr. Penale, dispozita nuk ka parashikuar qartësisht se kush do të konsiderohet pjesëmarrës në gjykim/hetim duke krijuar hapësirë për interpretim.

Drejtuesi i prokurorisë ka kërkuar rrëzimin e ankimit si të pambështetur në ligj, duke u mbështetur kryesisht në argumentin se ndërmjet prokurorit të çështjes dhe personit që ka dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale ekziston një lidhje gjinie e afërt, referuar ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, që passjell papajtueshmërinë e prokurorit për këtë procedim penal.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 291, datë 19.07.2023 ka vendosur rrëzimin e ankesës së prokurorit kundër vendimit datë 04.07.2023 të drejtuesit të prokurorisë “Për zëvendësimin e prokurorit”, si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke arritur në përfundimin se vendimi datë 04.07.2023 i drejtuesit të prokurorisë “Për zëvendësimin e prokurorit” është pjesërisht i ligjshëm.

12. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër


Në përgjigje të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1328/16 prot., datë 17.5.2024, në kuadër të inspektimit tematik, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4449/1, datë 01.07.2024, protokolluar në ILD me nr. 1328/35 prot., datë 01.07.2024. Në përmbushje të sa më sipër nga kjo prokurori janë dërguar për vitin 2023 praktika e zëvendësimit të prokurorëve. Në këto praktika deklarimet e prokurorit për heqje dorë dhe vendimmarrja e drejtuesit identifikohen me regjistrimin e tyre në regjistrin e korrespondencës së brendshme procedurale.

1. Në praktikën me nr. 154, datë 09.01.2023, prokurori ka paraqitur informacion për zëvendësimin nga hetimi i procedimit pasuror me shkakun “*në interes të hetimit referimi pasuror duhet të hetohet nga prokurori që ka në hetim procedimin penal për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, pasi materialet hetimore janë të lidhura dhe në varësi të njëra-tjetrës*”. Drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 15-17, 24-27 dhe 93 të K. Pr. Penale, si dhe 43 pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin, i cili ka në hetim procedimin penal të lidhur me procedimin pasuror, me arsyetimin se për të njëjtët subjekte janë në hetim procedimi penal dhe hetimi pasuror, ku këto procedime duhet të hetohen nga seksioni i posaçëm dhe të hetohen nga i njëjti prokuror që po heton veprën penale kryesore, duke qenë se hetimet janë të lidhura dhe provat e njëres çështje ndikojnë në mënyrën e përfundimit të çështjes tjetër.

2. Në praktikën me nr. 40, datë 22.05.2023 prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga trajtimi i kallëzimit penal me shkakun *“për personin e kallëzuar në këtë procedim penal ka trajtuar disa çështje penale (kallëzime, procedime) në të cilat ky shtetas ka qenë kryesisht i kallëzuar, në kuadër të të cilave ndaj prokurorit janë bërë disa herë kallëzime në SPAK”*. Drejtuesi i Prokurorisë, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se në lidhje me këtë procedim prokurori ka paraqitur edhe më parë kërkesë për heqje dorë dhe duke vlerësuar faktin që ka hetuar kallëzime të mëparshme të kallëzuesit dhe gjithashtu ka një komunikim dhe raport problematik me kallëzuesin, për këto shkaqe e ka të pamundur vijimin e hetimeve. Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
3. Në praktikën me nr. 47, datë 29.05.2023, është paraqitur informacion i prokurorit lidhur me heqjen dorë nga kallëzimi penal me shkakun *“hetimi pasuror të bëhet nga i njëjti prokuror që e ka nisur procedimin për veprën penale kryesore si dhe duke vlerësuar se çdo marrje dijani mbi vepra penale në kuadër të tij, duhet të trajtohet nga i njëjti prokuror”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se për shkak se kallëzimi penal është i lidhur me procedimin penal në hetim nga një prokuror tjetër, duhet ti kaloje për hetim këtij prokurori, i cili duhet të vlerësoje aktet dhe provat për të dy çështjet dhe mundësinë e hetimit si një çështje apo ndarjes së saj në dy çështje të veçanta pas analizimit dhe administrimit të akteve sipas parashikimeve të dispozitave procedurale penale.
4. Në praktikën me nr. 59, datë 07.06.2023 është paraqitur deklaratë e prokurorit për heqje dore në lidhje me materialin kallëzues bazuar në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale me shkakun *“lidhje krushqie me kallëzuesin/i dëmtuari nga vepra penale është babai i kunatës së prokurores”*. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit sipas arsyetimit për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes. Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
5. Në praktikën me nr. 73, datë 11.07.2023, nga prokurori është kërkuar heqje dorë nga trajtimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale me shkakun *“prokurori ka trajtuar disa herë çështje penale të të njëjtit kallëzues dhe për këtë arsye ai ka bërë edhe kallëzime penale ndaj tij duke kundërshtuar vendimmarrjet.”* Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se prokurori ka hetuar kallëzime dhe procedime penale të mëparshme të kallëzuesit dhe gjithashtu ka një komunikim dhe raport problematik me kallëzuesin, i cili ka bërë kallëzime penale ndaj tij, si dhe për këto shkaqe e ka të pamundur vijimin e hetimeve për shkak të paragjykimit dhe mundësisë së konfliktit të interesit. Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.



6. Në praktikën me nr. 72, datë 11.07.2023 është paraqitur deklaratë e prokurorit për *heqje dorë* nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale me shkakun “*të dëmtuarit nga vepra penale janë familjarë të kunatës së prokurorit*”. Drejtuesi i prokurorisë, bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes dhe sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
7. Në praktikën me nr.81, datë 18.07.2023, nga prokurori është kërkuar heqja dorë nga hetimet e procedimit penal me shkakun “*njohje me kallëzuesin pasi ka punuar me këtë shtetas dhe bazuar në kërkesën e tij për heqje dorë*”. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, ku arsyetohet se trashëgimtari i viktimës, ka kërkuar zëvendësimin prokurorit për shkak të zvarritjes së procedimit, për shkak të mosmarrëveshjeve personale mes kërkuesit dhe prokurorit dhe me qëllim për të shmangur çdo lloj vonese, apo pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes. Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
8. Në praktikën me nr. 123, datë 13.09.2023 është kërkuar heqje dorë nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenet 16 dhe 17/1, germa “e” të K. Pr. Penale me shkakun “*prokurori ka lidhje krushqie me dy nga të dyshuarit, ku vajza e hallës së prokurorit është e martuar me nipin e tyre*”. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale. ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes. Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
9. Në praktikën me nr. 126, datë 22.09.2023 nga prokurori është bërë informacioni për zëvendësimin nga hetimet e procedimit penal me shkakun se “*personat e kallëzuar dhe prokurori janë kushërinj (pavarësisht se nuk janë në rrethin e personave që parashikon neni 16 i K. Pr. Penale) për të shmangur çdo konflikt interesi qoftë edhe ne dukje*”. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
10. Në praktikën me nr. 166, datë 22.09.2023 prokurori ka kërkuar heqje dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale me shkakun “*duke qenë se ka hetuar dhe dërguar për gjykim dhe djalin e personit nën hetim ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie dhe për të shmangur çdo lloj paragjykimi në trajtimin e procedimit penal*”. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se bazuar në pretendimet e personave nën hetim, për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi



dhe dyshimi për njëanshmëri, subjektivizëm apo paragjykim të çështjes. Me procesverbalin për hedhjen e shortit manual procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.

11. Në shtatë (7) praktika në bazë të informacionit të prokurori është bërë zëvendësimi i tij me shkakun e kalimit të kallëzimit penal/procedimit tek seksioni kompetent, tre (3) raste për seksionin e të miturve dhe katër (4) raste për seksionin e posaçëm. Në këto raste drejtuesi i prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit bazuar në ligjin Nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, që parashikon detyrimisht që në këto raste hetimet të kryhen nga seksionet e posaçme për të miturit dhe urdhrit për ndarjen në seksione. Prokurorët në seksionet përkatëse për ndjekjen e çështjeve janë caktuar me short manual.
12. Në tre (3) praktika është kërkuar heqja dorë nga hetimet e kallëzimit penal me shkakun se *“Bashkëshortja e prokurorit është drejtuese në institucionin që ka bërë kallëzimin penal”*. Këto raste janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë bazuar në parashikimet e neneve 16, 17, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale, ku ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes. Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual caktimi i kallëzimit penal i është bërë një prokurori tjetër, me përjashtim të një rasti që nuk na është dokumentuar procedura e caktimit të prokurorit tjetër me short ose jo.
13. **Procedura për zëvendësimin e prokurorit të zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.**

Në zbatim të Urdhrit nr. 36, datë 19.12.2023 *“Për hedhjen në short të çështjeve penale të dorëzuara nga prokurorë të pezulluar”* të drejtuesit të prokurorisë janë hedhur në short manual kallëzimet penale, procedimeve penale në hetim dhe çështjeve në gjykim të prokurorit, i cili është emëruar anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke filluar detyrën nga data 19.12.2023.

Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual është hedhur shorti manual për caktimin e çështjeve në fazë hetimi midis prokurorëve të Seksionit të Parë, Seksionit të Dytë dhe Seksionit të Tretë, si dhe 5 çështjeve penale në fazë gjykimi tek prokurorët e Seksionit të 2-të, me përjashtim të një prokurori të këtij seksioni, i cili është përjashtuar nga shorti elektronik me urdhër të drejtuesit të prokurorisë nr. 32, datë 12.12.2023, për shkak të mbingarkesës me dosje në verifikim dhe hetim, si dhe në gjykim. Gjithashtu, me anë të shortit manual janë caktuar edhe 30 çështjeve të tjera penale në fazë gjykimi tek prokurorët e seksionit të Parë, ku edhe këtu njëri prej prokurorëve është përjashtuar nga shorti manual dhe elektronik me urdhër të drejtuesit të prokurorisë nr. 32, datë 12.12.2023.

Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 15-17 dhe 24-27 të K. Pr. Penale, si dhe 43, pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”* ka vendosur zëvendësimin e prokurorit për çështjet në gjykim dhe

në hetim dhe caktimin e prokurorit zëvendësues sipas shortit manual, duke arsyetuar se ai është në pamundësi objektive që të vijojë ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq. Vendimet e zëvendësimit janë për çdo procedim në gjykim të shortuar me vete, 5 vendime zëvendësimi dhe për çdo procedim në hetim të shortuar me vete, 36 vendime zëvendësimi.

14. Procedura për zëvendësimin e prokurorit pas vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në zbatim të Urdhrit nr. 31, datë 11.12.2023 “Për hedhjen në short të çështjeve penale të dorëzuara nga prokurorë të pezulluar” janë hedhur në short manual kallëzimet penale, procedimet penale në hetim dhe çështjet në gjykim, të prokurorit i cili është pezulluar nga detyra, si rrjedhojë e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Sipas procesverbalit për hedhjen e shortit manual janë caktuar 63 dosje në fazë gjykimi, të prokurorit të larguar, si dhe janë caktuar me short manual në seksionin e dytë, dy kallëzime penale. Nga ky short është përjashtuar njëri nga prokurorët me urdhër të drejtuesit të prokurorisë nr. 32, datë 12.12.2023 “Për përjashtimin e prokurorit nga shorti elektronik”. Gjithashtu me anë të shortit manual është bërë caktimi i 93 çështjeve penale në fazë hetimi midis prokurorëve të Seksionit të Parë, Seksionit të Dytë dhe Seksionit të Tretë.

Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenet 15-17 dhe 24-27 të K. Pr. Penale, si dhe 43, pika “d”, 44 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” ka vendosur zëvendësimin e prokurorit të larguar nga dosjet në hetim, gjykim, kallëzimeve në verifikim dhe caktimin e prokurorit sipas shortit manual, për çdo procedim të shortuar me vete, 63 vendime zëvendësimi dhe 2 vendime zëvendësimi për kallëzimet penale në fazë verifikimi, duke arsyetuar se si pasojë e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, prokurori është pezulluar nga detyra. Për këtë arsye, është në pamundësi objektive që të vijojë ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për këtë procedim penal.


13. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Në përgjigje të shkresës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1328/2, datë 17.05.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 12006/1, datë 02.07.2024 protokolluar në ILD me nr. 1328/34, datë 02.07.2024, duke dërguar praktikat e mëposhtme të zëvendësimit të prokurorëve, të cilat janë nxjerrë nga regjistri i zëvendësimeve të hapur në këtë prokurori në vitin 2023.


1. Në dy (2) praktika prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga kallëzimi penal në bazë të nenit 17, pika ë) të K. Pr. Penale me shkakun “Prokurori është palë si viktimë akuzuese në një proces

që gjykohet nga i njëjti gjyqtar ndaj të cilit është bërë dhe kallëzimi përkatës (konflikt interesi) dhe në rrethana të tilla çdo lloj vendimmarrje do të ishte e paragjykuar për shkak të konfliktit në dukje të interesit". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit dhe me short elektronik sipas sistemit Cams kallëzimet penale i janë caktuar një prokurori tjetër.

2. Nga prokurori është kërkuar heqja dorë nga hetimi i procedimit penal në bazë të nenit 17, germa "ë" të K. Pr. Penale, me shkakun "ka marrëdhënie shoqërore me vëllain e personit nën hetim, si dhe bashkëshorti ka marrëdhënie shoqërore me një të afërm të personit nën hetim". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit, por nuk kemi në dispozicion caktimin me short ose jo të prokurorit tjetër.
3. Nga prokurori është kërkuar heqja dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17, germa "ë" të K. Pr. Penale, me shkakun "aktualisht është subjekt rivlerësimi dhe nga KPK është pyetur për konfliktin e interesit me kallëzuesin e në këto kushte heq dorë me qëllim shmangien e paragjykimin". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, por nuk kemi në dispozicion caktimin me short ose jo të prokurorit tjetër.
4. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun "të afërm të prokurorit kanë kryer funksionin e nënkryetarit, por edhe funksione të tjera në kohë të ndryshme pranë komunitetit mysliman që është pala kallëzuese". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit dhe më anë të shortit elektronik pasqyruar në Cams kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
5. Prokurori ka kërkuar zëvendësim në lidhje me procedimin penal në fazë gjykimi me shkakun "procedimi është hetuar dhe dërguar në gjykim nga një prokuror tjetër dhe meqenëse dosja është voluminoze prokurori që e ka hetuar e njeh dosjen". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se kërkesa e prokurorit nuk gjen mbështetje në nenin 17 të K. Pr. Penale.
6. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun "prokurori ka bërë kallëzim penal në SPAK ndaj personit të kallëzuar". Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë dhe ky procedim penal t'i kalojë për hetime të mëtejshme prokurorit të caktuar pa short.
7. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal, bazuar në nenin 17/1, germa c) të K. Pr. Penale me shkakun "Njohje familjare me palën e kallëzuar". Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit, me arsyetimin mbështetur në nenin 17/1, germa "c" të K. Pr. Penale, për një hetim të paanshëm dhe objektiv. Me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.



8. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga verifikimi i kallëzimit penal, bazuar në nenin 17/1 germa “ç” K. Pr. Penale me shkakun *“ka proceduar më parë bashkëshorten e kallëzuesit duke e marrë të pandehur dhe pas marrjes së pafajësisë ajo ka bërë kallëzim ndaj prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë të prokurorit dhe ky kallëzim penal me short elektronik i është caktuar prokurorit tjetër.
9. Në dy (2) praktika prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal, bazuar në nenet 17, pikat “ç” dhe “ë” dhe 26/1/2 të K. Pr. Penale me shkakun *“Prokurori është kallëzuar më parë nga kallëzuesi për një vendimmarrje të tij”*. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 26/2 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e tij, me arsyetimin se nga verifikimet e kryera kërkesa e prokurorit është e drejtë dhe e bazuar në ligj. Me anë të shortit manual kallëzimet penale i janë caktuar një prokurori tjetër.
10. Prokurori ka paraqitur deklaram për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun *“Duke qenë se ky material ka lidhje me protestën e subjektit politik Partia Demokratike përpara kuvendit, fakt që është i përfshirë edhe në debatin politik aktual dhe duke qenë se bashkëshortja është deputete e subjektit politik Partia Socialiste, për të mos paragjykuar nga palët pozicionin si prokuror”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me short elektronik procedimit penal i është caktuar një prokurori tjetër.
11. Prokurori ka paraqitur deklaram për heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal, bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun *“Duke qenë se kallëzimi lidhet me kërkesëpadinë e Avokaturës së Shtetit në zbatim të një VKM të qeverisë, fakt që mund të përfshihet edhe në debatin politik aktual apo edhe duke qenë se bashkëshortja është deputete, për të mos paragjykuar nga palët pozicionin si prokuror”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
12. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë e zëvendësimin e tij nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 16, pika 1 i K. Pr. Penale lidhur edhe me nenin 17/1, pika “dh” të K. Pr. Penale me shkakun *“prokurori është kushëri i afërt me prokurorin që ka hetuar dosjen e ardhur për kompetencë”* dhe për shkak të kësaj lidhje, si dhe objektivitetit e paanshmërisë e për të shmangur çdo lloj paragjykimi jep pëlqimin për zëvendësim. Drejtuesi i Prokurorisë mbështetur në nenin 17/1 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe caktim për short, por nuk kemi në dispozicion caktimin me short ose jo të prokurorit tjetër.
13. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal, bazuar në nenin 17, pikat “ç” dhe “e” të K. Pr. Penale me shkakun *“prokurori është kallëzuar më parë nga babai i të kallëzuarit”*, duke arsyetuar për të shmangur çdo paragjykim në lidhje me paanshmërinë dhe



objektivitetin për ndjekje të mëtejshme penale të këtij procedimi. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë me arsyetimin se nga verifikimet e kryera rezulton se kërkesa e prokurorit është e drejtë dhe e bazuar dhe me anë të shortit manual kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.


14. Prokurori ka paraqitur informacion për zëvendësimin nga hetimi i procedimit penal me shkakun "*procedimi penal është hetuar dhe dërguar në gjykim nga një prokuror tjetër e duke qenë se prokurori i çështjes është aktualisht në punë, nisur nga ngarkesa e reduktuar e tij, kjo çështje të vijojë të përfaqësohet nga prokurori që ka kryer hetimin paraprak*". Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës së heqjes dorë, pasi kërkesa e prokurorit nuk gjen mbështetje në nenin 17/ç të K. Pr. penale.
15. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga kallëzimi penal bazuar në nenin 17/1, germa "c" të K. Pr. Penale me shkakun "*prokurori është kushëri i dytë me njërin prej të kallëzuarve*", me arsyetimin se pjesëmarrja si prokuror në hetimin e kësaj çështje dhe vendimmarrja nesër cenon zgjidhjen e drejtë dhe të paanshme të saj, me qëllim shmangien e çdo paragjykimi për njëanshmëri. Drejtuesi i prokurorisë mbështetur në nenin 17/1 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë, me arsyetimin se për shkak të kësaj lidhje familjare, cenohet hetimi me objektivitet dhe paanësi dhe për të shmangur çdo lloj paragjykimi. Me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
16. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga kallëzimi penal në bazë të neneve 16 dhe 17 të K. Pr. Penale me shkakun "*njohtje personale dhe familjare me palën kallëzuese*", me arsyetimin se hetimi i këtij kallëzimi mund të cenonte paanësinë dhe të krijojë paragjykime tek palët. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
17. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17/ë të K. Pr. Penale me shkakun "*ka në hetim kallëzuesin në një procedim tjetër ku ai është i kallëzuar*", me arsyetimin për të shmangur çdo lloj paragjykimi në lidhje me paanshmërinë dhe objektivitetin e këtij procedimi. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e tij, duke u caktuar me short manual një prokurori tjetër.
18. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë dhe zëvendësimin e tij nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 17/ë të K. Pr. Penale me shkakun "*me personat e dyshuar të cilët janë punonjës policie, ka marrëdhënie shoqërore prej disa vitesh, pasi qenia zv/drejtues prokurorie dhe drejtues seksioni për disa vite ka krijuar shoqëri që vazhdon prej disa vitesh*". Drejtuesi i prokurorisë me urdhër datë 08.03.2023 ka krijuar grupin hetimor për hetimin e procedimit penal dhe për këtë arsye ka vendosur refuzimin e deklaramit të heqjes dorë.
19. Prokurori ka paraqitur informacion për heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun "*kallëzimi penal është bërë nga subjekti partia socialiste dhe duke qenë bashkëshortja është deputete e këtij subjekti politik për të mos paragjykuar palët pozicionin si prokuror*".

Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me anë të shortit elektronik kallëzimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.

20. Prokurori ka kërkuar zëvendësim nga hetimet e procedimit penal me shkakun *“pamundësi objektive për të ndjekur procedimin për arsye shëndetësore dhe familjare pasi është me veprime proaktive”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë të prokurorit dhe me short elektronik procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
21. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun *“në vitin 2019 nga prokurori është vendosur mosfillimi procedimit penal të kallëzimit të këtij shtetasi. Për më tepër kjo dosje nuk i përket seksionit për të miturit dhe për të evituar çdo lloj interpretimi të gabuar të qëndrimit të organit të akuzës si jo të pavarur dhe të njëanshëm”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e deklarimit të heqjes dorë, me arsyetimin se për të qenë para kushteve të papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në procedim sipas nenit 15 duhet që procedimi ku është marrë pjesë dhe procedimi në zhvillim e sipër të jetë i njëjti. Shkaqet e ngritura nga prokurori si arsye njëanshmërie për të rënë në efektin e nenit 17 vlerësohen si jo të rëndësishme.
22. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17/c të K. Pr. Penale me shkakun se *“ka njohje me të kallëzuarin për shkak të disa procedimeve të mëparshme ku ai ose familjarë të tij kanë qenë në rolin e të pandehurit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me anë të shortit elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
23. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun *“procedimi penal është ndarë në lidhje me veprimet e punonjësve të policisë për veprime arbitrare, bazuar në rekomandimin e avokatit të popullit ku rekomandohet ndarja e procedimit penal në dy procedime të veçanta që të hetohen nga dy prokurore të ndryshëm”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë të prokurorit dhe caktim shorti, pa na u identifikuar caktimi i prokurorit tjetër me short.
24. Në këtë praktikë drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë të prokurorit nga hetimet e procedimit penal, (kërkesë e cila mungon, si dhe kërkesa e të pandehurës dhe po ashtu dhe caktimi ose jo me short i prokurorit tjetër) me arsyetimin se *“me vendimin e datës 20.3.2023 është vendosur nga drejtuesi refuzimi i kërkesës për zëvendësimin e prokurorit. Në datën 3.4.2023 e pandehura ka depozituar një kërkesë tjetër për zëvendësimin e prokurorit duke pretenduar se ajo mediatikisht është prononcuar për çështjen e incineratorëve dhe se ka hedhur akuza në drejtim të shtetasit M. M., ka depozituar ankesë në ILD ndaj prokurorit, ndonëse prokurori nuk vlerëson se ndodhet në kushtet e nenit 17, por nisur nga fakti se e pandehura ka humbur besimin në paanshmërinë e saj kërkon heqjen dorë”*.


25. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal me shkakun se *“kallëzuesi në këtë procedim penal ka bërë dhe një kallëzim tjetër për shtetasin M. M., krushqi i afërt i prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë dhe me short elektronik procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
26. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga vlerësimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun *“prokurori ka shprehur mendim për faktet e pretenduara nga kallëzuesi për ekspertim të rremë në procedimin penal në kuadër të të cilit është kryer ky ekspertim”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e tij me prokurorin e caktuar me short. Më anë të shortit manual kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
27. Prokurori ka paraqitur informacion për zëvendësimin në lidhje me gjykimin e procedimit penal me shkakun se *“personi i kallëzuar është palë kundërshtare në një proces civil me të emën e prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë dhe me short elektronik procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
28. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun se *“aktualisht fillon fushata për zgjedhjet vendore dhe bashkëshortja e prokurorit është deputete e zgjedhur nga partia socialiste në qarkun e Tiranës dhe kallëzimi nga subjekti politik është ndaj bashkisë Tiranë duke u ndodhur para papajtueshmërisë së parashikuar nga neni 17 i K.Pr. Penale”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.
29. Prokurori ka paraqitur informacion dhe mendim për dosjen gjyqësore, protokolluar me nr. 2278-E, datë 24.04.2023 në protokollin e kërkesë/ankesave, me objekt zëvendësimin në lidhje me gjykimin e procedimit penal me shkakun *“ngarkesa me dosje hetimore dhe në gjykim dhe dosja në fjalë t'i rijepet prokurorit që e ka pasur.”* Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e heqjes dorë, pasi kërkesa e prokurorit nuk gjen mbështetje në nenin 17, germa “ç” të K. Pr. Penale. Pas këtij vendimi nga kryesekretaria e prokurorisë në datën 24.4.2023 është mbajtur procesverbal pasi prokurori nuk ka pranuar të marri dosjen edhe pas mospranimit të kërkesës së tij.
30. Prokurori ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17/1, germa “c” të K. Pr. Penale me shkakun *“duke mos qenë dakord me vendimin e prokurorit të përgjithshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, prokurori në vendimin për shpallje moskompetencë është shprehur në një farë mënyre edhe për mënyrën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes gjë që nuk është pranuar”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës të heqjes dorë, pasi kërkesa e prokurorit nuk gjen mbështetje në nenin 17/1, germa “c” të K. Pr. Penale.

31. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun *“ka marrëdhënie të ngushta shoqërore me kallëzuesin, të cilin e njëj që student dhe vijnë marrëdhënie të tilla”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë dhe rishortimin e kallëzimit penal. Me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.
32. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 17/1, germa “c” të K. Pr. Penale me shkakun *“me njërin prej të kallëzuarve prokurori është kushëri i dytë pasi është nipi i mamasë së prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me short elektronik procedimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.
33. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, me shkakun *“viktima e veprës penale është nga fisi i prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës së heqjes dorë dhe me anë të shortit elektronik procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
34. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17, pikat “ç” dhe “ë” të K. Pr. Penale me shkakun se *“kallëzuesi ka paraqitur dy kallëzime penale në SPAK ndaj prokurorit”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e tij, ku me anë të shortit manual kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
35. Prokurori ka paraqitur informacion për zëvendësimin e tij nga hetimi i procedimit penal me shkakun se *“procedimi i kthyer nga gjykata është hetuar më parë nga seksioni i shpërdorimit të detyrës dhe duhet ti kalojë këtij seksioni”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës së heqjes dorë, me arsyetimin se ndarja e seksioneve bëhet për momentin e ndarjes së materialeve, në momentin që dosja i ka kaluar prokurorit nuk përbën më shkak për zëvendësim.
36. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun *“prokurori ka hetuar dhe më parë kallëzime/procedime ku kallëzuesi ka qenë palë me shtetas të afërm të tij dhe është dënuar, dhe kallëzuesi ka ngritur pretendime për njëanshmërinë e prokurorit duke qenë se e ka hetuar disa herë atë”*. Bashkëlidhur nga prokurori është paraqitur kërkesa për gjykim dhe vendimet e mosfillimit. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mospranimin e kërkesës, pasi nuk gjen mbështetje në nenin 17/1 germa “c” të K. Pr. Penale dhe në asnjë rast nuk janë konstatuar veprime të njëanshme nga ana e prokurorit.
37. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17/1, germa c) të K. Pr. Penale, me shkakun *“me shtetasin e kallëzuar është lidhje e afërt farefisnore, ku është kërkuar dhe më parë dorëheqja dhe është pranuar”*. Drejtuesi i prokurorisë ka



vendosur pranimin e kërkesës së heqjes dorë dhe me short elektronik procedimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.

38. Prokurori ka paraqitur informacion në lidhje me dhënien e pëlqimit për zëvendësimin e prokurorit në lidhje me hetimin e kallëzimit penal bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun *“për rastin në fjalë ka marrë vendim mosfillimi të kundërshtuar nga kallëzuesit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës së heqjes dorë, pasi nuk gjen mbështetje në nenin 17/1 grema c) të K. Pr. Penale.
39. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun se *“kallëzimi lidhet me fushatën elektorale dhe procesin zgjedhor dhe duke qene se i kallëzuari është nga subjekti politik Partia Socialiste deputete e të cilës është dhe bashkëshortja e prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.
40. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale me shkakun se *“kallëzuesi ka bërë kallëzim penal ndaj prokurorit në një prokurori tjetër”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës së heqjes dorë.
41. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes me shkakun se *“pala në proces, gazetari E. F ka bërë shkrime në median online kundër prokurorit se ka shfaqur mendime në lidhje me çështjen objekt gjykimi, duke paragjykuar çështjen dhe duke u bërë palë e njëanshme”*, bashkëlidhur shkrimi në media. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe rishortim, por nuk kemi në dispozicion caktimin me short ose jo të prokurorit tjetër.
42. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga kallëzimi penal me shkakun se *“pas kthimit nga gjykata të vendimit të mosfillimit, prokurori është njohur me kërkesën e kallëzuesit për zëvendësimin e tij, duke deklaruar se nuk ka asnjë shkak ligjor për të dhënë dorëheqje ne kuptim të nenit 16 dhe 17 të K. Pr. Penale, por duke mirëkuptuar situatën e kërkesve jep pëlqimin për zëvendësim, për ti dhënë një zgjidhje të besueshme kallëzimit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës se heqje dorë të prokurorit, me arsyetimin se kërkesa nuk gjen mbështetje në K. Pr. Penale, se dhe vetë prokurori pranon që nuk ka shkak ligjor për të deklaruar dorëheqjen.
43. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17/ë të K. Pr. Penale me shkakun se *“Prokurori banon në të njëjtin pallat me të kallëzuarin, në të njëjtën hyrje dhe me të cilin ka raporte fqinjësie, shoqërore, familjare”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë të prokurorit dhe me anë të shortit elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.




44. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga trajtimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale me shkakun se *“prokurori ka njohje personale dhe familjare prej me shumë se 10 vitesh me kallëzuesin”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
45. Prokurori ka paraqitur informacion me objekt zëvendësimin e tij nga gjykimi i procedimit penal me shkakun *“gjykimin e çështjes së ardhur për kompetencë në Gjykatën Tiranë duhet ta vazhdojë prokurori që është transferuar nga prokuroria pranë gjykatës që ka sjellë dosjen, nisur dhe nga ngarkesa e lartë”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës të heqjes dorë të prokurores.
46. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e heqjes dorë nga procedimi penal të kërkesës së prokurorit (kërkesë e cila mungon, si dhe nëse caktimi i prokurorit tjetër është bërë me short apo jo), i cili ka paraqitur si shkak *“personi nën hetim është vëllai i noteres së dërguar në gjyq nga prokurori dhe ndaj tij janë bërë kallëzime nga këto palë, ku në procedimet e mëparshme me këto palë ai ka hequr dorë dhe kërkesat për dorëheqje janë pranuar”*.
47. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 15, 17/1 germa “c” dhe “e” të K. Pr. Penale, me shkakun se *“prokurori me të kallëzuarin kanë njohje dhe afrimitet prej vitesh pasi e ka pasur në klasë në gjimnaz dhe kanë banuar në të njëjtën lagje”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës së heqjes dorë të prokurorit dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
48. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale me shkakun se *“bashkëshorti i prokurorit ka lidhur kontratë shitblerje aksionesh tek noterja e kallëzuar për të cilën i janë kërkuar shpjegime gjatë procesit të rivlerësimit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë të prokurorit dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
49. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga ndjekja e procedimit penal me shkakun se *“çështja penale është hetuar nga një prokuror tjetër, i cili ka konkluduar me kërkesë për pushim çështje. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur kthimin e akteve dhe duke qenë se prokurori i mëparshëm është kthyer në detyrë dhe ka ngarkesë më të lehtë çështja penale ti kalojë për ndjekje”*. Nuk ka vendim të drejtuesit i prokurorisë për këtë kërkesë, por vetëm një siglim mbi kërkesë që të vijojnë hetimet nga prokurori i caktuar.
50. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga verifikimi i kallëzimit penal, bazuar në nenin 17/1 germa “ë” të K. Pr. Penale me shkakun *“me prokurorin e kallëzuar ka qenë koleg pune në të njëjtën prokurori në pozicionin e drejtuesit dhe zv/drejtuesit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka

vendosur mospranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit, pasi kërkesa e prokurorit nuk gjen mbështetje në përcaktimet ligjore të K. Pr. Penale.

51. Prokurori ka paraqitur informacionin për zëvendësimin nga hetimi i procedimit penal me shkakun “*në bazë të Urdhrit nr. 47, datë 30.4.2023 “Për riorganizimin e seksioneve” sugjeroj që procedimi të rihidhet në short pranë seksionit të shpërdorimit të detyrës*”. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës të heqjes dorë të prokurorit, me arsyetimin se me shkarkimin nga detyra të prokurorit, çështjet në gjykim do të hidhen në short tek prokurorët e seksionit për narkotikët dhe krimet e rënda, duke qene se këto çështje janë rishortuar dhe shpërndarë tek prokurorët e këtij seksioni nuk do të rishortohen sërish.
52. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal, bazuar në nenin 17, grema c) të K. Pr. Penale me shkakun “*pasi është vendosur mosfillimi dhe çështja është kthyer nga gjykata për regjistrim, kallëzuesit kanë kërkuar zëvendësimin e prokurorit. Nisur nga insinuatat e padrejta në adresë të prokurorit nga ana e kallëzuesve në media të ndryshme, që janë në kufirin e fyerjeve dhe për më tepër kjo çështje është shqyrtuar nga KPK dhe është cituar dhe në rekomandimin e vëzhguesit ndërkombëtar për apelimin e vendimit të KPK*”. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë mbështetur në parashtrimet e prokurorit, pasi kërkesa gjen mbështetje në nenin 17, germa e) të K. Pr. Penale. Me anë të shortit elektronik procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
53. Prokurori ka paraqitur deklaramit për heqjen dorë të prokurorit nga hetimi i çështjes penale pas kërkesës se kallëzuesit me objekt heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit nga kallëzimi penal, me shkakun “*nga prokurori është vendosur mosfillimi i kallëzimit penal dhe pas prishjes së vendimit nga gjykata është regjistruar procedimi penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Sa i takon kërkesës së kallëzuesit për heqjen dorë nga hetimit i procedimit penal, nuk është kryer asnjë veprim në kundërshtim me vendimin e gjykatës. Megjithatë për tu mos u konsideruar paragjykes nga ana e kërkuarit, duke u nisur nga fakti që ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, heq dorë nga hetimi i procedimit penal*”. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës, me arsyetimin se kërkuari pretendon se ekzistojnë shkaqe njëanshmërie të prokurorit pasi nga ana e tij nuk janë ndërmarrë veprime lidhur me pyetjen e të kallëzuarve apo personave që kanë qenë në dijeni të rrethanave të ngjarjes. Njëanshmëria e prokurorit konfirmohet edhe në rastin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë.
54. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 17, germa e) të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit (deklaramit i cili mungon) dhe kallëzimi penal të hidhet sërish në short elektronik, me arsyetimin se prokurorja është viktimë akuzuese në një proces penal, ku si përfaqësuese të saj ka caktuar të kallëzuarën në kallëzimin penal nga i cili kërkon heqjen dorë. Me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.

55. Drejtuesi i Prokurorisë bazuar në nenin 17, germa "c" të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e kërkesës së heqjes dorë të prokurorit nga ndjekja e mëtejshme e kallëzimit penal (kërkesë e cila mungon) dhe kalimin e kallëzimit për ndjekje të mëtejshme tek prokurori tjetër, pasi prokurori ka hetuar me përpara kallëzime të tjera të personave kallëzues dhe të kallëzuarit, të cilët kanë paraqitur ankesa ndaj tij në lidhje me vendimmarrjet për përfundimin e hetimeve.
56. Prokurori ka paraqitur informacion për heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun se *"ka lidhje bashkëshortore me deputete të një subjekti politik"*. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë të prokurorit, me arsyetimin se kallëzuesi është administrator i portalit ***, i cili në mënyrë të përsëritur ka shkruar artikuj të ndryshëm kundër prokurorit, duke e lidhur gjithmonë me faktin se prokurori është bashkëshorti i deputetes. Me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
57. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga ushtrimi i ndjekjes penale në lidhje me hetimin e procedimit penal bazuar në nenin 17/e të K. Pr. Penale me shkakun se *"ka njohje të afërta me të kallëzuarin, për shkak se kanë qenë studente në fakultetin e drejtësisë në të njëjtën periudhë kohore dhe kanë frekuentuar të njëjtat klasa. Gjithashtu duke pasur rreth shoqëror të përbashkët, ky përbën shkak të rëndësishëm njëanshmërie"*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe me short elektronik procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
58. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimin i kallëzimit penal bazuar në nenin 17/1 germa c) të K. Pr. Penale, me shkakun *"duke qenë se prej tij janë hetuar dy kallëzime të mëparshme midis këtyre palëve dhe është vendosur mosfillimi dhe në kallëzimin e fundit përmendet dhe fëmija i mitur"*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës së heqjes dorë të prokurorit dhe me anë të shortit elektronik kallëzimi penal i është caktuar prokurorit tjetër.
59. Prokurori ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykim i procedimit penal me shkakun se *"dosja është në fazën fillestare të gjykimit dhe ti kalojë prokurorit që e ka dërguar për gjykim (edhe për shkak ngarkese), nisur nga fakti që prokurori është rikthyer pranë prokurorisë Tiranë e gjithashtu ngarkesën e madhe, si dhe volumit të madh të akteve të këtij procedimi"*. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin që ka pasur dosjen i cili do e ndjekë në fazën e gjykimit.
60. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga verifikimi i kallëzimit bazuar në nenin 17, germa "e" të K. Pr. Penale me shkakun *"për të shmangur çdo perceptim të kallëzuesit për njëanshmëri në verifikimin e kallëzimit ndaj prokurorit të prokurorisë ku ka ushtruar dhe vete detyrën më parë dhe jap pëlqimin për tu zëvendësuar me një prokuror tjetër"*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë me arsyetimin se mbështetur në parashtrimet e mësipërme kërkesa e prokurorit gjen mbështetje në përcaktimet e nenit 17,



germa “c” të K. Pr. Penale. Me anë të shortit elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.


61. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenet 15/1, 17/1 germa “c”, “ç” dhe “e” të K. Pr. Penale me shkakun se *“ka pasur përplasje personale me të pandehurit në një procedim penal tjetër të dërguar për gjykim prej tij dhe të dënuar nga gjykata. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe me anë të shortit elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.*
62. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë hetimi i procedimit penal bazuar në nenin 17/c të K. Pr. Penale me shkakun *“sipas ankuesit të gjitha kallëzimet e tij hetohen nga i njëjti prokuror dhe kallëzuesi paraqet ankesa në ILD, KLP, KPK , si dhe ka bërë kallëzim penal ndaj prokurorit”*. Me vendimin e datës 19.10.2022 nga drejtuesi nuk është pranuar kërkesa e parë për heqje dorë e prokurorit. Me dy kërkesa të tjera kallëzuesi ka kërkuar përjashtimin e prokurorit. Kallëzimet e mëparshme të kallëzuesit i janë caktuar prokurorit në mënyrë rastësore nëpërmjet shortit elektronik dhe për vendimmarrje të mëparshme ndaj tyre, kallëzuesi nuk është ankuar. Nga ana e tij edhe kallëzuesi ka paraqitur kërkesë nr. 5067, datë 22.9.2023, ku kërkon zëvendësimin e prokurorit në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale me pretendimin se *“prokurori nuk është paraqitur në seancën ku është marrë vendimi për kthimin e akteve prokurorisë dhe nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë kanë kaluar 12 muaj, duke vendosur pozicionin e prokurorit në njëanshmëri”*. Bashkëlidhur kërkuesi ka edhe vendimin gjyqësor për kthimin e akteve. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë të prokurorit dhe hedhjen në short elektronik të procedimit penal, por nuk kemi në dispozicion caktimin me short ose jo të prokurorit tjetër.
63. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë dhe zëvendësimin nga hetimi i kallëzimit penal me shkakun *“njohje me bashkëshorten e të kallëzuarit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë dhe kalimin për ndjekje të mëtejshme prokurorit tjetër pa short, me arsyetimin se mbështetur në parashtrimet e prokurorit kërkesa gjen mbështetje në përcaktimet ligjore të nenit 17/1, germa “c” të K. Pr. Penal.
64. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i materialit referues pasuror me shkakun *“me personin ndaj të cilit zhvillohen hetime ka lidhje farefisnore”*, përveç fakti që mban të njëjtin mbiemër nuk jepet e dhënë tjetër. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës së heqjes dorë të prokurorit dhe me short elektronik materiali referues pasuror i është caktuar një prokurori tjetër.
65. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal bazuar në nenin 17, germa “c” të K. Pr. Penale me shkakun *“prej shumë kohësh kam mosmarrëveshje personale dhe profesionale më të kallëzuarin, prandaj hetimi të bëhet nga një prokuror tjetër”*. Kjo kërkesë është pranuar nga drejtuesi i prokurorisë dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.

66. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë dhe zëvendësimin nga hetimi i kallëzimit penal në bazë të nenit 17, germa “ë” të K. Pr. Penale me shkakun *“ka njohje me prokurorin e kallëzuar pasi gjatë periudhës tetor 2022-qershor 2023 ka kryer praktikën profesionale në prokurorinë Tiranë”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e deklaramit të heqjes dorë, me arsyetimin se kërkesa e prokurorit nuk gjen mbështetje në nenin 17/c të K. Pr. Penale.
67. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga kallëzimi penal bazuar në nenin 17/1, germa “a” të K. Pr. Penale me shkakun *“prokurori është në marrëdhënie kontraktuale me palët në proces, pasi i kallëzuar i ka dhënë sipërfaqen e truallit me sipërmarrje shoqërisë në të cilën prokurori ka blerë banesën”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe me short elektronik kallëzimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
68. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mospranimin e kërkesës për heqje dorë të prokurorit, me arsyetimin se kërkesa e prokurorit nuk gjen mbështetje në përcaktimet ligjore të K. Pr. Penale, materiali është shortuar nga zyra e Cams në seksionin për të mitur ku është caktuar prokurori, i cili kërkon heqjen dorë sepse nuk ka asnjë person të dëmtuar apo në konflikt me ligjin që është i mitur dhe materiali është hedhur gabimisht në këtë seksion.
69. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal me shkakun *“Gjykata e Apelit ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim dhe duke qenë se çështja është hetuar dhe dërguar për gjykim nga një prokuror tjetër, i cili është kthyer në detyrë nga leja e lindjes, kërkoj të zëvendësohem në përfaqësimin në rigjykim të këtij procedimi penal”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e deklaramit të heqjes dorë nga përfaqësimi në rigjykim dhe procedimi ti kalojë prokurorit që e ka pasur.
70. Në dy (2) praktika prokurorët kanë kërkuar heqjen dorë dhe zëvendësimin nga kallëzimi penal me shkakun *“në gjykatën administrative është duke u shqyrtuar padia e prokurorëve me objekt kthimin e pagave të prapambetura dhe në këtë proces është caktuar nga gjykata si eksperte motra e ish prokurorit të kallëzuar”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës së heqjes dorë dhe me short elektronik kallëzimet penale i janë caktuar prokurorëve të tjerë.
71. Prokurori ka kërkuar zëvendësimin e tij nga hetimi i procedimit penal me shkakun *“për shkak të ngarkesës së madhe në punë, faktit që çështja ndodhet në të njëjtën fazë dhe për shkak të faktit se prokurori që e ka hetuar ka dhënë pëlqimin e tij për marrjen në ndjekje të kësaj çështje, kërkoj zëvendësimin në bazë të nenit 27/1 të K. Pr. Penale me prokurorin që e ka dërguar për gjykim”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale zëvendësimin e prokurorit në hetimin e procedimit penal me prokurorin që ka pasur procedimin.
72. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i materialit kallëzues me shkakun *“vajza e prokurorit është regjistruar pranë shkollës që ofron subjekti i kallëzuar dhe ndodhur në këto*



rrethana pavarësisht marrëdhënies indiferente me administratorin e këtij subjekti dhe çdo arsye njëanësie të parashikuara nga nenet 15, 16,17, të K. Pr. Penale heq dorë me pëlqim për shkak të shmangies së çdo lloj paragjykimi nga subjektet dhe kushdo". Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës të heqjes dorë të prokurorit, me arsyetimin se mungojnë arsye njëanësie të parashikuara në nenet 15,16,17 të K. Pr. Penale.

73. Praktika me nr. 473 prot., datë 11.04.2023 ka të bëjë me kërkesën e drejtuesit të prokurorisë për heqjen dorë nga procedimi penal dërguar me shkresë drejtuesit të prokurorisë së Apelit, bazuar në nenin 17/1 germa ë) të K. Pr. Penale me shkakun se "*personi i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale është bashkëshorti i shtetases, e cila është lidhje gjinie e prokurorit (kushëri e dytë)*". Drejtuesi i prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur pranimin e kërkesës së drejtuesit të prokurorisë Tiranë për heqjen dorë, me arsyetimin se në rastin konkret ekzistojnë arsye njëanshmërie, me qëllim për të shmangur çdo lloj paragjykimi, dërguar për njoftim drejtuesit të prokurorisë Tiranë me shkresën nr. 473/1 prot. datë 25.04.2023.
74. Në katërmbëdhjetë (14) praktika prokurori ka paraqitur informacion për zëvendësimin nga hetimi i procedimi penal me shkakun e kalimit të procedimit tek seksioni përkatës. Për seksionin e trafikeve (bazuar në urdhrin nr.80, të vitit 2023 të drejtuesit të prokurorisë) nga tetë (8) raste gjithsej, në gjashtë (6) prej tyre drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës për heqjen dorë, me arsyetimin se kërkesa e prokurorit pavarësisht gabimit të kryer nga zyra e Cams në shortim nuk gjen mbështetje në nenin 17/1, germa "c" të K. Pr. Penale, po ashtu kjo praktikë është tashmë e njohur dhe nuk do të procedohet më tej me rishortimin e materialit në seksionet përkatëse, ndërsa në një (1) rast drejtuesi i prokurorisë ka pranuar kërkesën dhe zëvendësimin e prokurorit, ku me short elektronik kallëzmi penal i ka kaluar një prokurori tjetër. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe caktim e prokurorit tjetër pa short, në një rast tjetër me arsyetimin se nga studimi i rrethanave të paraqitura nga prokurori si shkak për të hequr dorë nga hetimi, ato janë në pajtim me kërkesat e nenit 16 të K. Pr. Penale dh 26/1 të K. Pr. Penale, si dhe Urdhrit nr. 11, datë 09.02.2017 "*Për miratimin e rregullores se organizimit të prokurorisë*". Në tre (3) raste të tjera drejtuesi i prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit për shkak të kalimit të kallëzimit penal në seksionin kompetent, duke ju caktuar pa short (pasi nuk rezulton procedurë shorti) të njëjtit prokuror, me arsyetimin bazuar në dispozitat e kodit të drejtësisë penale për të mitur përse kohë në materialin kallëzues nuk janë identifikuar të mitur në konflikt me ligjin, materiali nuk është kompetencë e seksionit për të mitur. Në tre (3) raste prokurori ka kërkuar zëvendësimin e tij nga hetimi i procedimit penal për shkak të kalimit të procedimit tek Seksioni i Posaçëm. Drejtuesi i prokurorisë për këto praktika ka vendosur pranimin e deklarimit të heqjes dorë dhe në një prej tyre është vendosur që procedimi të vihet në dispozicion të prokurores që është drejtuese e këtij seksioni, në një tjetër kalim dosje prokurorit të gatshëm në seksionin e posaçëm, me arsyetimin se në mbështetje të nenit 27 të K. Pr. Penale, si dhe në rastet e parashikuar nga nenet 16 dhe 17 paragrafi parë, gjerat "a", "b", "ç", "d", "dh", dhe "e" të K. Pr. Penale prokurori e ka marrë materialin për vleftësim si



prokuror i gatshëm dhe duke qenë se ndodhet në limitet kohore ku ende nuk është vlerësuar caktimi i masës së sigurimit për personin e arrestuar, dhe në rastin e tretë hedhjen sërish në short elektronik në seksionin e posaçëm, ku me short elektronik procedimin penal i është caktuar prokurorit tjetër.

75. Në praktikën me nr. 1412, datë 10.03.2023 drejtuesi i prokurorisë ka vendosur *refuzimin e kërkesës me nr. 1412, datë 10.03.2023* (kërkesë e cila mungon, po ashtu dhe informacioni i prokurorit mbi këtë kërkesë), për përjashtimin e prokurorit nga hetimet e procedimit penal me pretendimin se *“pasi i është komunikuar akuza dhe përfundimi i hetimeve, e pandehura ka bërë kërkesë për zëvendësimin e prokurorit se ka arsye për njëanshmëri, pasi e pandehura është anëtare e këshillit kombëtar të subjekti politik Partia Demokratike dhe sekretare për çështjet e pronave pranë këtij subjekti, ku kunati i prokurorit dhe çështja e icineratorëve është denoncuar nga partia demokratike, po ashtu dhe bashkëshorti i prokurorit ka patur funksione drejtuese gjatë qeverisjes së subjektit partia socialiste, dhe së fundi edhe si drejtor i landfilleve”*.
76. Në praktikën me Nr. 1412, datë 07.03.2023, kallëzuesi ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga hetimet e kallëzimit penal me shkakun *“prokurori ka shfaqur mendim pasi fillimisht ka vendosur mosfillimin dhe ka krijuar dyshime dhe mosbesim për hetimin si duhet të çështjes. Pas këtij vendimi ai është në konflikt me kallëzuesin pasi ky i fundit ka bërë kallëzim ndaj prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur *refuzimin e kërkesës*, pasi nuk ka argument ligjor të mbështetur nenin 17 të K. Pr. Penale.
77. Në praktikën me nr. 6024, datë 26.04.2023 drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenet 17/1, germa “c”, 18 pika 1, germa “a” dhe 27, pika 1 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e kërkesës së personit nën hetim për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal të prokurorit me pretendimin se *“në lidhje me hetimin duhen pyetur të afërm të prokurorit”*. Mungon kërkesa e palës që ka kërkuar zëvendësimin dhe procedura e caktimit të prokurorit tjetër me short ose jo.
78. Në praktikën nr. 2445- E, datë 02.05.2023, drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit nga hetimet e procedimit penal me pretendimin *“njëanshmëri të prokurorit të cilën e bazon në faktin se gjykata ka kthyer dy herë për plotësim hetimesh për përsëritjen e aktit të ekspertimit dhe në rastin e dytë ka njoftuar viktimën, por nuk ka njoftuar palën që ka shkaktuar aksidentin. Gjithashtu prokurori nuk është shprehur për memon e palës që ka shkaktuar aksidentin, duke i lidhur këto veprime të prokurorit me njëanshmëri dhe favorizim kundrejt palës që ka shkaktuar aksidentin”*, me arsyetimin se nuk rezulton asnjë argument ligjor që të përbëjë rast njëanshmërie të prokurorit.
79. Në praktikën me nr. 3239- E, datë 08.06.2023 prokurori ka paraqitur dhënie mendimi mbi kërkesën e viktimës së veprës penale për përjashtimin e prokurorit nga gjykimi i procedimit penal, me pretendimin se *“prokurori nuk ka pranuar një provë të re të viktimës së veprës*



penale të paraqitur gjatë gjykimit të çështjes penale duke mbajtur një qëndrim të njëanshëm në favor të të pandehurit”, ku prokurori ka arsyetuar për mospranimin e kërkesës për shkaqe procedurale. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës.

80. Në praktikën me nr. 3586, datë 26.06.2023 drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mos pranimin e kërkesës së kallëzuesit (*kërkesë e cila mungon*) për përjashtimin nga kallëzimet e tij të prokurorit me pretendimin “*pakënaqësi lidhur me kohën e shqyrtimit të kallëzimeve të tij nga prokurori*”.
81. Në praktikën me nr.3442, datë 19.6.2023 drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mospranimin e kërkesës së të pandehurit me objekt përjashtimi nga hetimet e procedimit penal të prokurorit me pretendimin se “*prokurori ka hetuar një kallëzim të babait të të pandehurit kohë më parë nga i cili ka dhënë dorëheqje, pasi ka njohje me babanë e tij sepse jetojnë në një lagje banimi*”. Sipas vendimit prokurori ka parashtruar se pretendimi nuk përbën shkak për heqjen dorë të tij nga procedimi, pasi njohja me babanë e të pandehurit është e përcipte dhe ai nuk banon me në të njëjtin objekt.
82. Në praktikën me nr. 5291- SH, datë 19.07.2023 është paraqitur informacion i prokurorit mbi kërkesën e kallëzuesit për përjashtimin e prokurorit nga kallëzimi penal, duke parashtruar se “*nuk ndodhet në asnjë prej situatave ligjore të neneve 15,16,17 të K. Pr. Penale, por duke dhënë pëlqimin për zëvendësim për të mos dyshuar mbi objektivitetin e tij në këtë çështje, duke e lënë në vlerësim të drejtuesit për të vlerësuar kërkesën e kërkuarit*”. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale, ka vendosur refuzimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit nga kallëzimi penal, me arsyetimin se prokurori ka hetuar më parë çështjen penale regjistruar për të njëjtin fakt, për të cilën ka kërkuar pushimin dhe gjykata i ka kthyer aktet. Ndaj këtij vendimi prokurori ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit. Kërkuari pretendon se duke qenë se kallëzimi aktual dhe kallëzimi i mëparshëm kanë të njëjtin objekt, prokurori është shprehur dhe ka një qëndrim lidhur me çështjen. Nga kërkesa e drejtuar nuk rezulton asnjë argument ligjor që të përbëjë rast njëanshmërie të prokurorit.
83. Në praktikën me nr. 4261- D, datë 26.07.2023 është paraqitur informacion i prokurorit në lidhje me kërkesën e të pandehurit për zëvendësim të prokurorit nga procedimi penal, ku ka parashtruar “*pasi i është komunikuar akuza dhe është njohur me përfundimin e hetimeve, i pandehuri ka depozituar kërkesën për përjashtim, me pretendimin se nga prokurori është hetuar dhe një çështje tjetër në ngarkim të tij, e cila ka përfunduar me kërkesë për pushim. Nga kërkesa e ankuesit nuk rezulton asnjë argument ligjor që të përbëjë rast njëanshmërie të prokurorit. Në kuptim të neneve 16 dhe 17 rastet e mosmarrëveshjeve që përbëjnë shkak për zëvendësimin e prokurorit nuk janë mosmarrëveshjet që lidhen me funksionin e tij në një procedim penal, pra nuk lidhen me cilësinë që personi ka si prokuror në një procedim të caktuar. Në kuptim të këtyre dispozitave, shkaqet e parashtruara nga kërkuari për zëvendësimin e prokurorit duhet të jenë të tilla që të kenë lidhje me mosmarrëveshjet e tij si individ me prokurorin dhe jashtë procedimit penal dhe që prezumohet që mund të ndikojnë*



në cilësinë e prokurorit gjatë procedimit penal në fjalë. Shfaqja apo dukja e njëanshmërisë së prokurorit duhet të lidhet detyrimisht me njohjet apo lidhjet që prokurori ka me personat e akuzuar dhe të gjitha këto shkaqe duhet të jenë të provuara. Nuk ka asnjë shkak ligjor për detyrimin për të hequr dorë”. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës së kërkuarit për zëvendësimin e prokurorit”.

84. Në praktikën me nr. 3410, datë 15.06.2023 personat nën hetim dhe të interesuar kanë kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga hetimet e procedimit penal bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale, me shkakun se *“akuzat janë ngritur nga pozita të njëanshme të prokurorit i cili ka ndër marrë veprime të paligjshme. Pretendohet për qëndrime që cenojnë paanshmërinë e prokurorit, pasi ka sekuestruar pasuri origjina e të cilave është e ligjshme. Pretendohet se një nga të pandehurit është anëtar i partisë demokratike i njohur publikisht dhe prokurori është bashkëshorti i një deputete të njohur të partisë socialiste dhe qëndrimet e prokurorit kanë lidhje dhe me këtë fakt.”* Në lidhje me këtë kërkesë prokurori ka paraqitur informacionin se ka ushtruar me paanshmëri detyrën dhe nuk është ndodhur në kushtet papajtueshmërisë apo konfliktit të parashikuara nga K. Pr. Penale për të deklaruar heqjen dorë nga hetimi apo përfaqësimi në gjykim i çështjes. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës, pasi nuk rezulton asnjë argument ligjor që të përbëjë rast njëanshmërie.
85. Në praktikën me nr. 5046-I, datë 22.09.2023 personat nën hetim kanë kërkuar zëvendësimin/përrjashtimin e prokurorit nga hetimet e procedimit penal. Prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i mëtejshëm i procedimit penal me shkakun se *“disa herë nga ana e të pandehurve, por edhe e personave të tjerë të lidhur është paragjykuar në lidhje me hetimin e kësaj çështje. Është etiketuar si i njëanshëm politikisht, tendencioz apo aludime të tjera që i kalojnë kufijtë e etikës. I ndodhur para fakti që në adresë të prokurorit është hedhur çfarëdo paragjykimi, ankimi apo kallëzimi, dezinformimi dhe pse jo të vërteta, vendimmarrja do të jetë e paragjykuar në çdo rast”.* Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit dhe me short elektronik procedimi penal i është caktuar një prokurori tjetër.
86. Në praktikën nr. 5087- S, datë 25.09.2023, është paraqitur informacioni i prokurorit në lidhje me kërkesën e personit nën hetim për përrjashtimin nga procedimi penal me arsyetimin se *“ky procedim penal është ndjekur nga disa prokurorë, dhe janë kryer veprime hetimore të plota. Kërkuar pretendon se prokurori i çështjes ka treguar hapur njëanshmëri. Shkaqet e pretenduara për njëanshmëri lidhen me faktin pse po procedohet personi nën hetim. Mbetet në vlerësimin të drejtuesit pranimi ose jo i kërkesës dhe nuk ka asnjë kundërshtim në rast zëvendësimi, nisur nga ngarkesa e lartë në punë”.* Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës.
87. Në praktikën me nr. 5521- A, datë 10.10.2023 është paraqitur informacioni i prokurorit mbi kërkesën e mbrojtjes së të pandehurit për përrjashtim nga procedimi penal me duke parashtruar se *“gjatë gjykimit nga prokurori është bërë ndryshimi i akuzës për të pandehurin,*

e cila është vlerësuar e drejtë nga ana e gjykatës, dhe nuk është në kushtet e heqjes dorë dhe nëse plotësohen apo jo kushte për përjashtim nga përfaqësimi i këtij gjykimi të vlerësohen nga drejtuesi”. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës, pasi mbështetur në nenin 17 të K. Pr. Penale nuk rezulton asnjë argument ligjor që të përbejë shkak për përjashtimin e prokurorit.

88. Në praktikën me nr. 5478- M, datë 09.10.2023 është paraqitur deklarimi i prokurorit mbi kërkesën e personit të kallëzuar (kërkesë e cila mungon) për zëvendësimin e prokurorit nga hetimi i procedimit penal me arsyetimin se *“personi nën hetim pretendon se është parashkruar ndjekja penale dhe prokurori në vend që të kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal, vijon me veprime hetimore. Kërkuësja kërkon zëvendësimin për shkak të aludimeve se prokurori ka njohje dhe është ndikuar nga kallëzuesi, sepse banesat e tyre janë përballë me njëra tjetrën dhe se familja e prokurorit frekuenton të njëjtin lokal me kallëzuesin dhe se ky i fundit frekuenton edhe ambientet e brendshme të shtëpisë së familjes së prokurorit, pasi ka kryer disa punime për rikonstruktimin e banesës së tij, ku kërkuësja ka dërguar edhe foto si provë”*. Drejtuesi i prokurorisë me vendimin bazuar në nenin 17 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit dhe me short elektronik është caktuar prokurori tjetër.
89. Në praktikën me nr. 5738, datë 19.10.2023 është paraqitur informacion i prokurorit në lidhje me kërkesën e personin nën hetim (kërkesë e cila mungon) për përjashtimin nga procedimi penal me arsyetimin se *“në kërkesë është parashtruar për një konflikt të sajuar me qëllim zëvendësimin e prokurorit. Gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka pasur asnjë rast konflikti me avokatin, i cili është përfaqësues i personit nën hetim dhe njeri i afërt i tij”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se nuk përbëjnë shkaqe njëanshmërie, pretendimet e kërkuësit se prokurori kur ka dhënë provimin e avokatisë sipas tij ka pasur konflikt midis tyre për shkak të pikëve të marra në provim dhe ky shkak ka krijuar pakënaqësi tek prokurori, i cili për këtë arsye nuk po kryen hetime të paanshme, duke u pozicionuar kundër personit nën hetim që njëkohësisht edhe dhe familjare e afërt e avokatit.
90. Praktika me nr. 5784- F, datë 23.10.2023 ka të bëjë me kërkesën e shtetasës R. H., për zëvendësimin e prokurorit nga procedimi penal. Drejtuesi i prokurorisë pas shqyrtimit të kërkesës ka sigluar kërkesën *“të arkivohet pasi vendimi është dhënë”*, duke qenë dosje në gjykim.
91. Në praktikën me nr. 6344, datë 14.11.2023 prokurori ka dhënë mendim për heqjen dorë nga kallëzimi penal duke parashtruar se *“edhe pse pretendimet e kallëzuesit në kërkesën për zëvendësim të prokurorit nuk qëndrojnë heq dorë bazuar në nenin 17/1, germa “c” të K. Pr. Penale”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës nr. 6344, datë 14.11.2023 për zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se kërkuësi pretendon se kjo çështje është e paragjykuar, duke përmendura se një kopje e kallëzimit i ka shkuar subjektit të

kallëzuar, por nga kërkesa e ankuesit nuk rezulton asnjë argument ligjor që të përbëjë rast njëanshmërie të prokurorit.

92. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga procedimi penal me një prokuror tjetër, me arsyetimin se *“ky procedim penal është me veprime proaktive dhe prokurori është me raport mjekësor”*. Meqenëse veprimet janë të ngutshme dhe nuk mund të presin kthimin e prokurorit në punë del i nevojshëm zëvendësimi i tij.
93. Drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenin 49/2 të ligjit nr. 97/2016 dhe nenet 26, 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga hetimi i procedimit penal, pasi për shkak të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, prokurori nuk mund të vazhdojë hetimet dhe duhet të ngarkohet një nga prokurorët e seksionit të narkotikëve që është caktuar sipas shortit manual.
94. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit nga hetimet e procedimit penal, për shkak të shkarkimit nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit dhe në bazë të urdhrit për shpërndarjen e dosjeve hetimore të prokurorit të shkarkuar është caktuar prokurori tjetër.
95. Përveç praktikave të mësipërme nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë paraqitur dhe 15 urdhra për hedhje në short të çështjeve në hetim dhe gjykim, për katër (4) magjistratë të transferuar në institucione të tjera të sistemit të drejtësisë, për shtatë (7) magjistratëve të shkarkuar dhe për një (1) magjistrat për pamundësi të përkohshme në detyrë.

14. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Në përgjigje të shkresës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 1328/5, datë 17.05.2024 Prokuroria e Posaçme ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7743/1, datë 24.06.2024 protokolluar në ILD me nr. 1328/33, datë 25.06.2024, ku informohet se në lidhje me procedurën që ndiqet për zëvendësimin e prokurorëve rezulton se në rastet dhe kushtet në ligj prokurori depoziton pranë zyrës së drejtuesit të prokurorisë *kërkesën për heqje dorë nga ushtrimi i ndjekjes penale në lidhje me procedimin penal në hetim. Pas shqyrtimit nga ana e drejtuesit të kërkesës për heqjen dorë, drejtuesi i prokurorisë merr vendim lidhur me zëvendësimin e prokurorit, i cili i dorëzohet prokurorit përkatës që ka depozituar kërkesën. Gjithashtu pas depozitimit të kërkesave të palëve ose subjekteve të procedimit penal këto kërkesa përcillen tek drejtuesi i prokurorisë nga ana e kryesekretarisë. Pas shqyrtimit nga ana e drejtuesit merret vendim lidhur me pranimin ose refuzimin e miratimit të kërkesës për zëvendësimin e prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankim ndaj vendimit për zëvendësimin e prokurorit të drejtuesit të prokurorisë në KLP.*

Nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë paraqitur 4 raste të zëvendësimit të prokurorit gjatë vitit 2023.

1. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë të prokurorit dhe për ushtrimin e ndjekjes penale është caktuar një prokuror tjetër, me arsyetimin se sipas kërkesës së prokurorit është bërë publik kallëzimi i shtetasit A. D., i cili ka pretenduar se prokurori i çështjes ka fshehur provat, kallëzim i cili është shoqëruar me një sërë shkrimesh në media dhe rubrika televizive, duke akuzuar prokurorin në lidhje me veprimet hetimore. Për shkak të kallëzimit penal, shkrimeve dhe rubrikave televizive prokurori është i paragjykuar në çdo vendimmarrje të mëtejshme lidhur me këtë procedim penal. Paragjykimi i tij do të sillte paragjykim në punën e prokurorisë së posaçme. Nga ana tjetër ngarkesa me ndjekjen e çështjeve penale të tjera, të cilat janë komplekse. Për këtë shkak është në pamundësi objektive për të qenë i angazhuar plotësisht dhe në të njëjtën kohë me gjitha këto procedime penale. Zëvendësimi i prokurorit në këtë rast shmang çdo lloj paragjykimi në kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, njëkohësisht lehtëson ngarkesën e prokurorit në këtë periudhë kohore, i cili është i ngarkuar edhe me çështje të tjera të natyrës voluminoze dhe komplekse.
2. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale, ligjin nr. 95/2016, ligjin nr. 97/2016 dhe Urdhrin nr. 08, datë 07.01.2022 "*Për caktimin e prokurorëve në seksione në Prokurorinë e Posaçme*" ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e seksionit kundër krimit të organizuar, duke arsyetuar se prokurori i çështjes për shkak të ngarkesës në punë si me çështjet penale, ashtu edhe me detyrat administrative si drejtues i prokurorisë, lind e nevojshme zëvendësimi i prokurorit për përfaqësimin në gjykim të akuzës në lidhje me këtë çështje penale. Duke pasur parasysh ngarkesën e konsiderueshme të prokurorëve të seksionit kundër korrupsionit, prokurori zëvendësues duhet të jetë një prokuror i seksionit kundër krimit të organizuar, duke u vlerësuar dhe ngarkesa e prokurorëve të këtij seksioni.
3. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale, ligjin nr. 95/2016, ligjin nr.97/2016 dhe urdhrin nr.08, datë 7.1.2022 "*Për caktimin e prokurorëve në seksione në Prokurorinë e Posaçme*" ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e seksionit kundër krimit të organizuar, duke arsyetuar se prokurori i çështjes, për shkak të ngarkesës në punë si me çështjet penale, ashtu edhe me detyrat administrative si drejtues i prokurorisë, lind e nevojshme zëvendësimi i prokurorit për përfaqësimin në gjykim të akuzës në lidhje me këtë çështje penale, duke u caktuar një prokuror tjetër i seksionit kundër krimit të organizuar, duke u vlerësuar dhe ngarkesa e prokurorëve të këtij seksioni.
4. Drejtuesi i prokurorisë bazuar në nenet 15, 16, 17, 26 dhe 27/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë të prokurorit dhe zëvendësimin me dy prokurorë për përfaqësimin në gjykimin e çështjes penale, me arsyetimin se prokurori ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga përfaqësimi në gjykim pasi pas bërjes pjesë e këtij procedimi ka qenë pjesë e sulmeve mediatiqe, madje dhe kallëzime. Këto sulme i lidh me faktin se i pandehuri



e konsideron si të njëanshëm, pasi ndaj tij ka kryer hetime dhe me parë, duke aluduar që prej shume vitesh qëllimi i prokurorit është dënimi i këtij shtetasi. Prandaj konsideron se është i paragjykuar për njëanshmëri lidhur me këtë procedim penal. Gjithashtu duke qenë i ngarkuar dhe me ndjekjen e shumë çështjeve penale në fazën e gjyqimit dhe hetimit, të cilat janë komplekse është në pamundësi objektive për të qenë i angazhuar plotësisht dhe në të njëjtën kohe me të gjitha këto procedime penale. Zëvendësimi i prokurorit shmang çdo lloj paragjykimi në qëndrimin prokurorisë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, njëkohësisht zëvendësimi i prokurorit lehtëson ngarkesën e prokurorit në këtë periudhe kohore, i cili është i ngarkuar dhe me çështje të tjera të natyrës voluminoze dhe komplekse.

15. Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

1. Në dy (2) praktika me nr. 42 prot., datë 30.05.2023 dhe nr. 65 prot., datë 04.10.2023, prokurori ka paraqitur deklaratë për heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykim të procedimit penal bazuar në nenin 17, germa “e” se ekzistojnë arsye njëanësie me shkakun *“lidhje krushqie me gjyqtarin e Gjykatës së shkallës parë të juridiksionit të përgjithshëm që ka dhënë vendimin, i cili është djali i tezes i bashkëshortes së prokurorit”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit, me arsyetimin se bazuar në nenin 17, germa “e” të K. Pr. Penale në rastin konkret ekzistojnë shkaqe rëndësishme të cilat mund të krijojnë dyshime për njëanshmëri dhe njëkohësisht problematikë në përfaqësimin e kësaj çështje, duke krijuar tek palët në proces ideja se nuk garantohet parimi i përfaqësimit të paanshëm. Me anë të shortit manual procedimet penale i janë caktuar një prokurori tjetër.
2. Në dy (2) praktika nr. 54 prot., datë 54.06.2023 dhe nr. 67 prot., datë 25.10.2023, prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykim të procedimit penal bazuar në nenet 16, 17, germa “e” të K. Pr. Penale me shkakun *“lidhje gjinie me prokuroren e Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës parë të juridiksionit të përgjithshëm që ka hetuar procedimin penal e cila është vajza e tezes”*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykim të çështjes, me arsyetimin se në rastin konkret, prokurori pasi ka ardhur në dijeni të faktit se prokurorja e ngarkuar si me hetimin ashtu dhe me gjykimin e kësaj çështje është vajza e tezes së saj, ka depozituar kërkesën për të hequr dorë nga hetimi i procedimit. Duke u nisur nga sa më sipër, bazuar në nenin 17, pg. 1, pika “e” të Kodit të Procedurës Penale, në rastin konkret ekzistojnë shkaqe të rëndësishme, të cilat mund të krijojnë dyshime për njëanshmëri dhe njëkohësisht problematikë në përfaqësimin e kësaj çështje, duke krijuar tek palët e përfshira në proces ideja se nuk garantohet parimi i përfaqësimit të paanshëm.
3. Në praktikën me nr. 68 prot., datë 08.11.2023 prokurori ka paraqitur deklaratë për heqjen dorë nga përfaqësimi i çështjes në gjykatë bazuar në nenin 17, germa “e” të K. Pr. Penale, me shkakun *“lidhje shoqërore me av. mbrojtës të të pandehurit në gjykimin në shkallë të parë me të cilin ka papajtueshmëri për shkak të njohjes dhe lidhjeve të vjetra miqësore e*



familjare, ndërkohë që me këtë shtetas ka hyrë dhe në marrëdhënie juridike civile për faktin se prej tij ka blerë apartamentin ku jeton në pallatin në të cilin jeton dhe vetë avokati". Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur refuzimin e kërkesës së prokurorit për heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykimin e çështjes penale, me arsyetimin se nuk jemi në plotësim të kushteve ligjore të nenit 17, germa "ë", pasi marrëdhëniet e hershme të blerjes së apartamentit, por edhe ato miqësore nuk është e mjaftueshme për të ngritur dyshime mbi paanshmërinë e prokurorit.

4. Në praktikën me nr. 106 prot., datë 06.02.2023 i pandehuri ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga përfaqësimi në gjykimin e procedimit penal me shkakun "*pretendime për njëanësi nga prokurori çështjes lidhur me qëndrimet dhe konkluzionet e prokurorit të cilat avokati i konsideron të padrejta*". Lidhur me këtë kërkesë, prokurori ka paraqitur mendimin e tij se *nuk ekziston asnjë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17*. Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit dhe me shkresën nr. 106/3 date 21.2.2023 vendimi i drejtuesit i është njoftuar të pandehurit.

16. Prokuroria e Përgjithshme

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1328/2 prot., datë 17.05.2024, ka kërkuar informacion në Prokurorinë e Përgjithshme për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në lidhje me raste të zëvendësimit të prokurorëve të kësaj prokurorie.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 671/1 prot., datë 05.06.2024, regjistruar pranë ILD me nr. 1328/22 prot., datë 05.06.2024, ka dërguar informacion se bazuar në nenin 12 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme", miratuar me Urdhrin nr.136, datë 28.10.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, përfaqësimi i çështjeve të rekursuara në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm përpara Kolegjit Penal dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ushtrohet nga prokurorët e Drejtorisë Gjyqësore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Në lidhje me çështjet e përfaqësuara nga prokurorët e Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste të zëvendësimit të prokurorëve, as si pasojë e deklaramit të heqjes dorë nga ana e tyre në përfaqësimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë dhe as si pasojë e kërkesave të palëve/subjekteve që lidhen me këto çështje".

II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Inspektimi tematik filloi me fazën e parë, hartimin e kërkesave për informacion dhe akte drejtuar Prokurorive pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna ku është mundësuar marrja e informacionit dhe dokumentacionit shkresor për periudhën objekt inspektimi 01.01.2023-31.12.2023, nga prokuroritë e mësipërme.

Të dhënat e marra nga prokuroritë lidhen me informacionin dhe dokumentacionin gjatë periudhës kohore objekt të inspektimit 01.01.2023-31.12.2023 si më poshtë:

- a) procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorëve për periudhën 1.1.2023-31.12.2023, që përfshin të dhënat që nga momenti i deklarimit të prokurorit për heqje dorë ose kërkesës së palëve/subjekteve të tjera për zëvendësim, kalimin e tyre tek drejtuesi për shqyrtim, marrjen e vendimi përkatës nga drejtuesi dhe komunikimin e tij.
- b) çdo praktikë për vendimet e marra “kryesisht” nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorit (zëvendësim pa pëlqim).
- c) procedurën e shortit të ndjekur në rastin e zëvendësimit të prokurorit për caktimin e prokurorit tjetër.
- ç) rastet e ankimeve ndaj vendimit të drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e prokurorive, është përqendruar në drejtim të (i) shkaqeve të kërkesave të palëve ose subjekteve të tjera të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit të çështjes; ii) deklarimeve të prokurorëve për heqjen dorë nga ushtrimi i funksioneve të prokurorit në çështjen konkrete dhe arsytet e tyre, (iii) vendime të drejtuesit për zëvendësim dhe procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin e prokurorit tjetër (iv) rastet e zëvendësimit të prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë pa pëlqim.

Trajtimi i këtyre të dhënave është bazuar në analizën e dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁸ të neneve 42 shkronja “a dhe c”, neni 43, pika “d”⁹, nenit 45, pika 1-2¹⁰, nenit 49¹¹ të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 15, 16, 17, 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, vendime të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në një rast shqyrtimi të ankimit të prokurorit ndaj vendimit të zëvendësimit, si dhe referime tek jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

⁸ Neni 148 i Kushtetutës përcakton se: “1. “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarevajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.”

⁹ “Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj;”

¹⁰ “1. Prokurorët ushtrijn funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, gjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim. 2. Zëvendësimi i prokurorit të çështjes lejohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.”

¹¹ “1. Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal. 2. Prokurori mund të zëvendësohet edhe kur, për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrijë funksionet apo të respektojë afatet ligjore.”

Në janar të vitit 2023 është implementuar harta e re gjyqësore, në nivel të prokurorive të apelit, nëpërmjet së cilës është bërë ristrukturimi i këtyre prokurorive, duke i grupuar prokuroritë e apelit në një të vetme atë të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë. Ndërsa nëpërmjet ristrukturimit të prokurorive të shkallës së parë janë shkruar prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë, duke i grupuar ato në 13 prokurori dhe përkatësisht në prokuroritë Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë, Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë. Në fund të vitit 2023, sistemi i prokurorisë ka qenë i organizuar në:

- a. 13 zyra prokurorie pranë Gjykatave të Shkallëve të Para;
- b. 1 zyrë prokurorie pranë Gjykatave të Apelit;
- c. Prokuroria e Posaçme SPAK;
- d. Prokuroria e Përgjithshme.

Në raportin vjetor të KLP-së miratuar me vendimin nr.60, datë 25.4.2024 është paraqitur organika e prokurorive objekt inspektimi për vitin 2023, si më poshtë:

| Shkalla e Parë | Organika | Në detyrë |
|----------------|----------|-----------|
| Elbasan | 20 | 14 |
| Tirana | 90 | 53 |
| Vlora | 20 | 14 |
| Shkodra | 20 | 13 |
| Berat | 7 | 6 |
| Dibër | 8 | 6 |
| Durrës | 34 | 22 |
| Fier | 22 | 13 |
| Gjirokastrë | 9 | 7 |
| Korçë | 19 | 11 |
| Kukës | 8 | 4 |
| Lezhë | 14 | 8 |
| Sarandë | 7 | 5 |

Në prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm organika përbëhet nga 26 prokurorë, ndërsa efektivisht në detyrë për vitin 2023 kanë qenë 10 prokurorë, ndërsa në Prokurorinë e Përgjithshme organika përbëhet nga 17 prokurorë dhe në detyrë kanë qenë 10 prokurorë.

Në vijim është pasqyruar analiza e të dhënave përkatëse që janë përpunuar mbi secilin subjekt të inspektuar, pas trajtimit të informacioneve të dërguara nga prokuroritë. Pjesë e analizës ligjore për secilën prokurori është situata që rezulton në lidhje me praktikën që ndiqet për zëvendësimin e prokurorit dhe shkaqet e deklarimeve për heqje dorë ose vendimet e drejtuesit të prokurorisë për zëvendësim të prokurorit, sipas rasteve dhe kushteve të parashikuara në ligj. Gjithashtu është vlerësuar edhe numri efektiv i prokurorëve në çdo prokurori, duke pasur

parasysh ngarkesën e prokurorive, si dhe rastet e zëvendësimit të prokurorëve për shkak të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Njëkohësisht, përveç sistemit të rivlerësimit kalimtar, në zyrat e prokurorive gjatë vitit 2023 ka pasur edhe transferime të prokurorëve, kërkesa për dorëheqje, largime të prokurorëve që mbushin moshën e pensionit etj.

1. Prokuroria e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm

- ✓ Në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm gjatë vitit 2023 kanë ndodhur 6 raste të zëvendësimit të prokurorëve nga gjykimi i çështjeve në këtë shkallë, praktika e të cilave janë sjellë të plota nga kjo prokurori.
- ✓ Mënyra e të proceduarit nga prokurorët e apelit është në bazë të aktit “Deklaratë për heqjen dorë” ose “Kërkesë për heqjen dorë”, nga përfaqësimi në gjykim. Nga këto akte si deklarata e prokurorit për heqje dorë dhe vendimi i drejtuesit janë të regjistruara në regjistrin e kryesekretarisë së prokurorisë së apelit. Me vendimin e drejtuesit njoftohet dhe prokurori i zëvendësuar.
- ✓ Praktika që ndiqet është ajo e deklaratës ose kërkesës së prokurorit për heqje dorë nga përfaqësimi në gjykim i çështjes ose e kërkesës së palës, të paraqitur drejtuesit të prokurorisë, vendimit të drejtuesit për shqyrtimin e saj dhe procesverbalin e hedhjes në short manual nga i cili rezulton prokurori zëvendësues.
- ✓ Nga të 6 praktikatat e depozituara, vetëm 1 prej tyre është praktikë e iniciuar me kërkesë të palës (të pandehurit) për zëvendësimin e prokurorit, ndërsa të tjerat vijnë nga deklaratimet e prokurorit për heqje dorë. Në rast se procedura fillon nga kërkesa e palës kërkohet dhe mendimi i prokurorit, siç ka rezultuar në një rast me kërkesë të të pandehurit, ku prokurori ka paraqitur mendimin e tij dhe drejtuesi ka vendosur mospranimin e kërkesës. Në këto raste vendimi i drejtuesit të prokurorisë i njoftohet kërkuesit me shkresë.
- ✓ Nga 6 praktikatat e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në 4 prej tyre është pranuar deklarimi i heqjes dorë dhe zëvendësimi i prokurorit, në 2 raste nuk është pranuar, tek kjo e fundit përfshihet dhe ai me kërkesë e të pandehurit.
- ✓ Në të gjitha praktikatat ku është pranuar zëvendësimi i prokurorit, prokurori tjetër është caktuar me short manual.
- ✓ Shkaqet për të cilat është deklaruar ose kërkuar dhe vendosur zëvendësimi i prokurorit në këto praktika të prokurorisë së apelit të juridiksionit të përgjithshëm janë:

a) **arsye njëanësie**, të bazuara në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, parashikuar në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, ku është pranuar si i tillë rasti kur:

➤ “Gjyqtari i gjykatës së shkallës parë të juridiksionit të përgjithshëm që ka dhënë vendimin është djali i tezes së bashkëshortes së prokurorit” e përsëritur në dy praktika nga i njëjti prokuror. Në këtë rast lidhja e krushqisë që nuk hyn në kushtet e nenit 16 të K. Pr. Penale vlerësohet si arsyë njëanësie për prokurorin e prokurorisë së apelit, që të

deklarojë heqjen dorë nga përfaqësimi në gjykim i çështjes penale.

✓ Ndërsa, nuk janë pranuar si shkaqe të rëndësishme njëanshmërie deklarimi për heqjen dorë e prokurorit me arsyetimin se marrëdhëniet e hershme të blerjes së apartamentit, por edhe ato miqësore nuk janë të mjaftueshme për të ngritur dyshime mbi paanshmërinë e prokurorit dhe kërkesa e të pandehurit në rastet kur:

➤ “*prokurori ka njohje miqësore e familjare me avokatin që i pandehuri ka pasur në gjykimin në shkallë të parë dhe ka blerë një apartament prej tij në pallatin në të cilin jeton dhe vetë avokati*”.

➤ “*pretendimet e të pandehurit për njëanësi nga prokurori çështjes, për shkak të qëndrimeve dhe konkluzioneve të prokurorit të paraqitura në gjykim, të cilat i pandehuri i konsideron të padrejta*”.

b) **papajtueshmëri për shkak lidhje gjinie** në bazë të nenit 16 të K. Pr. Penale, në dy praktika nga i njëjti prokuror tjetër i kësaj prokurorie rasti kur:

➤ “*prokurori ka vajzë teze prokuroren e prokurorisë pranë gjykatës së shkallës parë të juridiksionit të përgjithshëm që ka hetuar procedimin penal*”, pranuar në fakt nga drejtuesi për arsye serioze njëanshmërie.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

✓ Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë përcjellë 30 praktika të zëvendësimit të prokurorëve për vitin 2023, të cilat janë të plota dhe përfshijnë kërkesën/informacionin/dhënie e pëlqimit të prokurorit për heqje dorë ose kërkesën e palës/subjekteve të tjera të procedimit penal për zëvendësim, informacionin/mendimin e prokurorit në rast se ka kërkesë për zëvendësim nga palët/subjektet, vendimin e drejtuesit të prokurorisë për shqyrtimin e kërkesave për çdo rast pranimi ose mospranimi, procesverbalin/fletën e shortit për caktimin e prokurorit zëvendësues, në disa raste edhe njoftimin zyrtar me e-mail për datën e hedhjes së shortit, vendimin e drejtuesit për zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin e prokurorit të zgjedhur nga shorti, marrja dijani e prokurorit të zëvendësuar, si dhe shkresat për njoftimin e shtetasit në rastet kur ka qenë subjekt kërkues.

✓ Siç u përmend më sipër nga prokurorët procedohet secili në mënyrën e vet kur i drejtohen drejtuesit për heqjen dorë me “*Kërkesë për heqje dorë*” ose “*Informacion*” ose “*Dhënie pëlqimi për zëvendësim*” dhe me “*Informacion*” ose “*Kërkesë*” në rastin e kalimit të materialeve/procedimeve penale në seksionet kompetente.

✓ Në rastin e paraqitjes së kërkesave të palëve/subjekteve të tjera për zëvendësim, kërkesa shoqërohet me kartelën e praktikës në të cilën vihet shënimi i drejtuesit të prokurorisë për prokurorin që të jap mendimin e tij për këtë kërkesë. Pas marrjes së informacionit nga prokurori, drejtuesi merr vendimin për pranim ose jo të kërkesës, i

cili i komunikohet kërkuesve me shkresë përcjellëse. Janë disa raste të tilla, me informacion dhe dhënie të mendimit që ka bërë prokurori kur *“personi nën hetim ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga hetimi i procedimit penal me pretendimin se ka shpërdoruar detyrën dhe ka zvarritje të hetimit”* ose *“kallëzuesi ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit me pretendimin se është i njëanshëm me moskryerjen e hetimeve të kërkua nga kallëzuesi”*.

- ✓ Bashkëlidhur nga kjo prokurori janë dërguar fletët e regjistrimit të korrespondencës së brendshme procedurale, që vërteton se të gjitha kërkesat/informacionet/dhënie të pëlqimit për heqje dorë të prokurorit dhe vendimet përkatëse të drejtuesit janë regjistruar në këtë regjistër, ndërsa kërkesat e palëve si rregullisht janë protokolluar nga sekretaria.
- ✓ Prokurori zëvendësues është caktuar me short të rregullt në çdo praktikë, me përjashtim të një rasti kur procedimi penal i ka kaluar drejtpërdrejt prokurorit të seksionit të posaçëm, të justifikuar nga fakti se nga ky prokuror po kryeshin hetime ndaj të njëjtit person.
- ✓ Rezulton se në 30 praktikat e zëvendësimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, 27 prej tyre janë kërkesa të prokurorëve për heqje dorë nga verifikimi i kallëzimit ose hetimi i procedimit penal, të cilat me përjashtim të një rasti, të tjerat janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë, ndërsa 2 praktika që janë iniciuar njëra me kërkesë të kallëzuesit dhe tjetra me kërkesë të personit nën hetim nuk është pranuar zëvendësimi i prokurorit. Një praktikë ka të bëjë me zëvendësimin e prokurorit për arsye transferimi.
- ✓ Nga praktikat e sjella 2 prej tyre i përkasin rasteve të zëvendësimit të prokurorit në fazë gjykimi, si dhe zëvendësimet e tjera të çështjeve në gjykim të prokurorit të transferuar dhe të prokurorit të larguar për arsye shëndetësore apo zëvendësimit përsëri pas kthimit të tij në punë.
- ✓ Një prej praktikave është rasti i heqjes dorë nga drejtuesi i prokurorisë Elbasan, pranuar nga drejtuesi i prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- ✓ Në dy praktika ndeshet fakti se kërkesës së prokurorit për heqje dorë i bashkëlidhen dhe provat për të provuar shkakun që përbën njëanshmëri, duke bashkëlidhur vendimin e dënimit pasi pretendimi ishte *“prokurorja ka kërkuar dënim më parë për një nga personat në hetim”* dhe paraqitja e raporteve mjekësore për shkakun *“probleme shëndetësore”*.
- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve rezultojnë:
 - a) **arsye njëanshësie**, të bazuara në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, të parashikuara në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, ku janë pranuar si të tilla, rastet kur:
 - *“familjarët e njërit nga prej të dyshuarve si autor i veprës penale janë në lidhje krushqie me rrethin familjar të prokurorit”*.
 - *“prokurori ka kërkuar dënim më parë për një nga personat në hetim”*.
 - *“për të respektuar procesin e rregullt ligjor, duke qenë se i pandehuri ka pretendime*

ndaj prokurorit për shpërdorim detyre dhe zvarritje të hetimeve.

- “prokurori ka ardhur në dijeni se babai i tij ka njohje me babanë e të arrestuarit dhe nga ky i fundit i është bërë prezent fakti që i arrestuari ishte djali i tij, shkaqe të cilat mund të krijojnë dyshime për njëanshmëri”; rasti i heqjes dorë të drejtuesit të prokurorisë.
- “kallëzuesi nuk ka besim te prokurori dhe ka kërkuar përjashtim publikisht në emisionin investigativ “STOP””.
- “prokurori ka marrë vendim për refuzim të dhuratës në lidhje me çështjen nga personi nën hetim, për shmangien e konfliktit të interesit dhe çdo lloj paragjykimi”.
- djali i prokurorit ka qenë i punësuar në institucionin ku drejtor ishte personi i dyshuar”.

b) kalim i materialeve kallëzuese/procedimeve penale seksionit kompetent, në 8 raste.

c) shkaqe të kombinuara si ngarkesa në punë; probleme shëndetësore; procesin kalimtar të rivlerësimit në shkallën e dytë në KPA dhe dosje voluminoze” në 2 praktika zëvendësimi.

d) paaftësisë së përkohshme fizike në punë, në një rast.

f) kthimin në punë të prokurorit për shkak të mungesës për shkaqe shëndetësore i përsëritur nga 9 prokurore.

g) për shkak të transferimit të prokurorit, ku në këtë rast procedura e zëvendësimit fillon me urdhrin drejtuesit të prokurorisë për hedhjen në short të çështjeve në hetim, mbajtjen e procesverbalit të shortit manual dhe me vendim zëvendësimi i kanë kaluar prokurorëve që ju janë caktuar me short.

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është përgjigjur se “*procedura për zëvendësimin e prokurorit që nga momenti i bërjes së kërkesës të prokurorit të çështjes i dorëzohet drejtuesit të prokurorisë, i cili merr në shqyrtim kërkesën për heqjen dorë të prokurorit. Në rastin e pranimit të kërkesës drejtuesi i prokurorisë zëvendëson prokurorin duke caktuar nga vetë ai një prokuror të ri për vazhdimin e çështjes.*

Në rastet e kërkesës së palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit që dorëzohen në prokurori mbasi protokollohen në sekretari i kalojnë drejtuesit i cili vë në dijeni prokurorin e çështjes.

Nga praktika rezulton se ka edhe raste kur prokurori i çështjes gjatë hetimit konstaton se në procedimin penal janë përfshirë persona të mitur, dhe i drejtohet me kërkesë drejtuesit për heqjen dorë nga procedimi penal dhe zëvendësimin e tij me prokurorin e seksionit për të mitur.

Gjithashtu rezulton se për periudhën kohore që kërkohet, ka pasur raste të transferimit të prokurorëve në një prokurori tjetër. Në këto raste dosjet hetimore që ka lënë ky prokuror janë shortuar manualisht në prani të drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve që kanë marrë pjesë në këtë short manual. Më pas është bërë zëvendësimi i prokurorit sipas shortit manual.

Për periudhën e kërkuar nuk rezulton të ketë pasur ankim ndaj vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

- ✓ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për vitin 2023 ka vënë në dispozicion 8 (tetë) praktika të zëvendësimeve të prokurorit nga verifikimi i kallëzimeve penale ose hetimet e procedimeve penale, ku një rast i përket zëvendësimit të prokurorit në gjykim.
- ✓ Deklarimet për heqje dorë të prokurorëve në këtë prokurori janë të paraqitura në formën e “Kërkesës për heqje dorë”.
- ✓ Sipas dokumentacionit të rasteve të paraqitura praktika që ndiqet për zëvendësimin e prokurorit vijon në varësi të subjektit që e inicion këtë procedurë. Rezulton se kërkesa e prokurorit për heqje dorë i kalon drejtuesit të prokurorisë (pa specifikuar në informacionin e prokurorisë dhe nuk rezulton as nëpër kërkesat për heqje dorë, nëse regjistrohet apo protokollohet kjo kërkesë) sepse nga dokumentacioni përveç një kërkesë që mban nr. prot., në rastet e tjera të përcjella nuk konstatohet një fakt i tillë.
- ✓ Në dy prej këtyre praktikave aktet nuk janë të plota, pasi mungojnë kërkesa e prokurorit për heqje dorë dhe në praktikën tjetër mungon vendimi i drejtuesit të prokurorisë që ka shqyrtuar kërkesën, nëse është zëvendësuar ose jo prokurori, pavarësisht se rasti është për kalimin e procedimit penal tek seksioni i posaçëm.
- ✓ Është informuar se në rastin e pranimit të kërkesës, prokurori zëvendësues nuk zgjidhet me short, por caktohet nga drejtuesi në vendimin për zëvendësim, gjë që ka ndodhur dhe në praktikat e përcjella. Në praktikat e paraqitura nuk ka asnjë prej tyre ku prokurori zëvendësues është caktuar me short, pasi ato i përkasin kalimit të procedimit penal ose materialit kallëzues tek prokurori për çështjet me të mitur ose prokurorit të caktuar për hetimin e grup veprave penale të pastrimit të parave, korrupsionit etj. Në këto raste caktohet drejtpërdrejtë prokurori për çështjet me të mitur ose prokurori i hetimit të grup veprave, si prokurorë të vetëm që mbulojnë këto çështje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Në dy praktika që nuk i përkasin kësaj kategorie, prokurori zëvendësues është caktuar pa short në vendimin për pranimin e kërkesës për heqje dorë, me arsyetimin se *në kushtet e ngarkesës së prokurorëve të prokurorisë Berat, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë brenda një afati sa më të shpejtë dhe për të mos u bërë shkak për zvarritjen e hetimeve, procedimi i caktohet për hetim drejtuesit të prokurorisë,* ndërsa në vendimin tjetër nuk del ndonjë arsye përse kjo mënyrë caktimi.
- ✓ Vetëm në një rast nga drejtuesi është vendosur mospranimi i kërkesës së prokurorit për heqjen dorë.

- ✓ Sipas informacionit të drejtuesit të prokurorisë në rast të një kërkesë nga palët ato protokollohen dhe i kalojnë drejtuesit të prokurorisë, nga i cili vihet në dijeni prokurori i çështjes (me tej nuk specifikohet procedura si vijon) dhe nga kjo prokurori nuk ka pasur asnjë rast për të studiuar këtë lloj praktike. Gjithashtu, në rastin e transferimit të prokurorëve në prokurori të tjera, pasi dosjet janë shortuar manualisht është bërë zëvendësimi i prokurorit me vendim, por edhe për këtë lloj praktike nuk është paraqitur asnjë rast.
- ✓ Në bazë të praktikave të dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat rezulton se shkaqet e zëvendësimit të prokurorit të çështjes në hetimin e kallëzimeve/procedimeve penale, rezultojnë të jenë:
 - a) **arsye njëanësie**, të bazuara në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, në 3 raste, sipas nenit 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, nisur nga pretendimet e personit nën hetim, ku janë pranuar si të tilla në rastet kur:
 - *“personi nën hetim ka kërkuar në mënyrë të përsëritur zëvendësimin e prokurorit me pretendimin se prej tij nuk janë kryer veprimet hetimore të kërkuara dhe është paragjykuar hetimi”.*
 - *“kallëzuesja ka bërë kallëzim ndaj prokurorit me pretendimin se prokurori i ka thënë “do të fus në burg” në një çështje tjetër penale ku është e pandehur dhe dërguar në gjyq”.*
- ✓ Ndërkohë nuk është pranuar si shkak i rëndësishëm njëanshmërie, rasti kur *“kallëzuesi ka hedhur akuza të padrejta në drejtim të prokurores, si dhe prokurorja ka hetuar dhe më parë pretendimet e kallëzuesit për falsifikim të dokumenteve dhe ka marrë vendim mosfillimi”*, sipas arsyetimit se pretendimet e prokurorit për heqje dorë nuk përbëjnë shkak të rëndësishëm njëanshmërie siç kërkon neni 17, germa “ë” i K. Pr. Penale.
- b) **kalimi i procedimit tek seksioni kompetent** në 5 raste, i cili arsyetohet në zbatim të urdhrave të drejtuesit për caktimin e prokurorëve të ngarkuar me të miturit ose grup veprat penale.

4. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

Kjo prokurori është përgjigjur ndaj kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se *“.....procedura që ndiqet për zëvendësimin e prokurorëve, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, pas momentit të bërjes së deklaramentit të prokurorit për heqje dorë ose të kërkesës së palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësim të prokurorit dhe pas hyrjes/protokollimit të tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ato janë kaluar tek Drejtuesi i Prokurorisë.* Në rastet e kërkesës së palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësim të prokurorit, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është kërkuar mendim/informacion nga prokurori përkatës.

Pas marrjes së vendimit përkatës nga Drejtuesi i Prokurorisë për heqjet dorë apo kërkesat e palëve ose subjekteve të procedimit penal, vendimi i Drejtuesit të Prokurorisë i është komunikuar prokurorit përkatës ose/edhe subjekteve të tjera.

*Në lidhje me procedurën e zhvilluar për caktimin e prokurorit tjetër, nga ana e ish-Drejtuesve të Prokurorisë **nuk është zhvilluar ndonjë procedurë për caktimin e prokurorit tjetër**, përveç caktimit në vendim të prokurorit tjetër për vijimin e hetimit të procedimit penal.*

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nuk ka pasur raste të ankimit ndaj vendimit mbi zëvendësimin e prokurorit të ish-Drejtuesve të Prokurorisë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.”

- ✓ Sipas informacionit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, praktika e zëvendësimit që ndiqet në këtë prokurori, është se pas kërkesës së prokurorit për heqje dorë ose të një kërkesë të palëve për zëvendësim të prokurorit, të cilat protokollohen, ato i kalojnë drejtuesit të prokurorisë. Në rastin e fillimit të kësaj procedure me kërkesë të palëve, nga ana e drejtuesit të prokurorisë është kërkuar informacion nga prokurori përkatës.
- ✓ Megjithatë nuk ka asnjë praktikë të përcjellë nga kjo prokurori që të vërtetojë sa më sipër.
- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka ndodhur praktika e zëvendësimit të prokurorëve me anë të urdhrave të drejtuesit të prokurorisë për balancimin e ngarkesës, duke i rishpërndarë dosjet e një prokurori me ngarkesë ose të larguar për paafësi të përkohshme në punë, mbaruar statusi për shkak të daljes në pension, transferimit në një prokurori tjetër, prokurorëve të rinj të emëruar në këtë prokurori. Një kategori tjetër e ri-shortuar këtyre prokurorëve janë edhe dosjet e kthyera nga gjykata, të dërguara për gjykim, si dhe me kërkesa të tjera, nga prokurorët e larguar nga kjo prokurori.
- ✓ Megjithatë në aktet e dërguara nga Prokuroria Dibër që demonstrojnë këtë rishpërndaje të çështjeve nuk rezulton asnjë vendim i drejtuesit të prokurorisë për zëvendësim prokurori për secilën nga shkaqet e përmendura më sipër. Në kushtet e kësaj mangësie ligjore, vendimi i zëvendësimit është një aspekt i ushtrimit të autoritetit të drejtuesit të prokurorisë¹² në kryerjen e procedurës së zëvendësimit të prokurorit dhe gjithashtu një aspekt procedural i ligjshmërisë së ushtrimit të funksioneve të prokurorit të caktuar bazuar në Kodin e Procedurës Penale.
- ✓ Gjatë vitit 2023 nuk është zhvilluar asnjë procedurë shorti për caktimin e prokurorit zëvendësues, përveç caktimit të tij në vendimin e drejtuesit për vijimin e hetimeve të kallëzimit ose procedimit penal.

¹² Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.

- ✓ Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë nuk është dërguar asnjë rast për të evidentuar praktikën (procedurën) e kësaj prokurorie në zëvendësimin e prokurorit, që nga momenti i deklarimit të prokurorit apo kërkesave të palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit, informacionin/mendimin e prokurorit në rast të paraqitjes së kërkesës së palëve për zëvendësim të prokurorit, vendimin e drejtuesit dhe komunikimin e tij, shortin për caktimin e prokurorit zëvendësues kur nuk duhet të caktohet drejtpërdrejt.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është përgjigjur lidhur me praktikën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorëve se **"kërkesa e prokurorit për zëvendësim regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave. Për çdo vendimmarrje të Drejtuesit, njoftohet Prokurori i cili ka paraqitur kërkesën. Në rastet kur pranohet kërkesa për heqje dorë/zëvendësim, çështja penale shortohet në mënyrë manuale.**


Në të njëjtën mënyrë veprohet dhe në rastet e paraqitjes së kërkesave për zëvendësim nga palët. **Kërkesa e tyre paraqitet në zyrën e protokoll/arkivës dhe më pas kalon në zyrën e Drejtuesit. Në çdo rast palët njoftohen me vendim për pranimin/mospranimin e kërkesës për zëvendësim nga Drejtuesi i Prokurorisë.**

Nga ana e prokurorëve për periudhën e inspektimit 01.01.2023-31.12.2023 nuk ka pasur asnjë rast ankimimi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë".

- ✓ Nga 32 praktika e shqyrtuara të kësaj prokurorie, nga të cilat 5 prej tyre kanë të bëjnë me zëvendësimin e prokurorit në fazë gjykimi, rezulton se për zëvendësimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga prokurorët procedohet me **"kërkesë për heqjen dorë", "dhënie pëlqimi për zëvendësim dhe heqje dorë"** ose për rastet e kalimit të materialit kallëzues/procedimit seksionit kompetent me **"Informacion"** apo **"Kërkesë"** sipas prokurorit. Më tej siç dhe është informuar nga kjo prokurori vijohet me shqyrtimin e tyre nga drejtuesi i prokurorisë dhe nëse ka pranim të kërkesës, caktimin e prokurorit zëvendësues me short.
- ✓ Sipas informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës praktika që ndiqet për zëvendësimin e prokurorit mund të iniciohet nga vetë prokurori ose me kërkesë të një pale të procedimit penal. Kërkesa e prokurorit regjistrohet në regjistrin e kërkesave, ndërsa kërkesat e palëve në zyrën e protokollit, të cilat më pas të dyja llojet i përcillen drejtuesit të prokurorisë. Pas vendimmarrjes së drejtuesit, njoftohet prokurori që ka paraqitur kërkesën ose subjekti që ka paraqitur kërkesë.
- ✓ Sipas informacionit të prokurorisë kërkesat për heqje dorë regjistrohen, por në praktikat e paraqitura nuk identifikohet një fakt i tillë apo të jetë vendosur në

dispozicion libri/regjistri ku janë të regjistruara apo të kërkesave të palëve në protokoll, megjithëse kjo prokurori ka informuar se të parat regjistrohen në regjistrin e kërkesave dhe të dytat në protokoll.

- ✓ Përveç 20 praktikave të zëvendësimit me kërkesë nga vetë prokurorët në prokurorinë Durrës janë trajtuar dhe kërkesat e 12 palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit. Nga këto 20 kërkesa/deklarata për heqje dorë të prokurorëve vetëm në një rast nuk është pranuar zëvendësimi i prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë, ndërsa nga 12 kërkesa të palëve/subjekteve të procedimit penal është pranuar zëvendësimi i prokurorit vetëm në një prej tyre. Vendimet e drejtuesit në lidhje me këto kërkesa i njoftohen palës me anë të shkresës përcjellëse. Në kërkesat e palëve ka siglim të drejtuesit të prokurorisë për informacion nga prokurori, por nuk kemi ndonjë akte të tillë në ndonjë prej këtyre praktikave.
- ✓ Praktikrat e përcjella nga prokuroria Durrës janë me mangësi, pasi mungojnë në disa raste kërkesat e palëve për zëvendësim ose dhe vendimi i drejtuesit që i ka shqyrtuar. Në 20 praktika të shqyrtuara (19 me kërkesë të prokurorëve dhe 1 me kërkesë të personit nën hetim) për të cilat është pranuar kërkesa për heqje dorë dhe zëvendësimi i prokurorit, nuk identifikohet procedura e shortit për caktimin e prokurorit zëvendësues me procesverbal manual ose elektronik, të cilat nuk janë përcjellë nga prokuroria për tu provuar ky fakt edhe pse në kërkesa/informacione të prokurorëve për heqje dorë ka siglim të drejtuesit të prokurorisë për short, ndërsa në një praktikë prokurori është caktuar drejtpërdrejt pa short. Ky i fundit është rasti kur për shkak gatishmërie prokurori i mëparshëm ka kryer veprimet e ngutshme dhe me kalimin e procedimit tek seksioni kompetent, i është caktuar prokurorit që ka qenë i gatshëm kur ka ndodhur fakti.
- ✓ Sipas praktikave në këtë prokurori shkaqet për të cilat nga prokurorët është kërkuar heqja dorë dhe/ose është vendosur zëvendësimi i tyre paraqiten:
 - a) **arsye njëanësie**, për shkaqe të rëndësishme njëanshmërie të bazuara në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, në 10 praktika, ku janë pranuar si të tilla rastet kur:
 - *“prokurori dhe noterja që ka hartuar disa akte noteriale, të cilat janë të administruara në procedimin penal mbi bazën e të cilave janë regjistruar pronat për të cilat palët janë në konflikt janë kushërinj”, me arsyetimin se marrëdhëniet gjinore me një nga personat e përfshirë në konflikt, përbën arsye njëanësie.*
 - *“prokurori është hetuar në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me shtetasin e kallëzuar gjatë hetimit administrativ “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.*
 - *“në procedime penale të mëparshme të hetuara nga prokurori personi nën hetim aktual ka qenë kallëzues dhe prej tij është kërkuar në mënyrë të përsëritur zëvendësimi i tij si prokuror, duke u aluduar nga ana e këtij shtetasi për njëanshmëri në kryerjen e hetimeve.*
 - *“pretendimi i personit nën hetim se prokurori është në konflikt për ushtrimin e funksionit pasi ekzistojnë shkaqet e parashikuara nga neni 16 dhe 26 i K. Pr. Penale*



me njërin nga viktimat, ndërsa nga prokurori deklarohet se me viktimën nuk ka asnjë lidhje sipas parashikimeve të nenit 16 të K. Pr. Penale”.

- “njohjet shoqërore dhe familjare me prokurorin që i atribuohet vepra penale, me kallëzuesin”, në katër (4) praktika, me arsyetimin se njohja që prokurori ka me palët, përbën arsye njëanësie (neni 17/1 i K. Pr. Penale), të cilat do të ndikonin në zgjidhjen me objektivitet të çështjes.
- “bashkëshorti i prokurores ka gjykuar një çështje civile ku personi i akuzuar ka qenë paditës dhe në aktet e fashikullit të gjykimit penal është administruar si provë vendimi gjyqësor civil” rast në gjykim.
- “kallëzuesi ka depozituar dokumente të përpiluara nga noterja, e cila është bashkëshortja e prokurorit”.

- **Nuk është pranuar si shkak njëanësie**, bazuar në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, rasti i “trajtimit të çështjes në emisionin stop në mënyrë paragjyqëse ndaj prokurorit”, rast në gjykim, mospranuar me arsyetimin se argumentet për heqjen dorë të paraqitura nga prokurorja mbështeten vetëm në pakënaqësitë e palëve në proces.

- ✓ **Në një praktikë për zëvendësim të prokurorit me kërkesë së të pandehurës, pretendimet e saj për arsye njëanësie të prokurorit janë pranuar në rastin kur:**
 - “bashkëshorti i prokurorit është me detyrë gazetar dhe pedagog dhe procedimi penal ndaj personit nën hetim ka nisur për shkak të një video të transmetuar nga emision investigativ”, me arsyetimin se fakti që bashkëshorti i prokurorit është pedagog në Departamentin e Gazetarisë, mund të krijojë mundësi për të pasur lidhje me gazetarët e këtij emisioni dhe mund të krijojë arsye për njëanshmëri në hetimin e kësaj çështjeje penale.

- ✓ **Pretendimet e palëve/subjekteve të tjera të procedimit penal për arsye njëanësie të prokurorit, nuk janë pranuar në rastet kur:**
 - “kallëzuesit pretendojnë se nuk ka pasur dijeni për kallëzimin derisa i ka ardhur vendimi i mosfillimit dhe se prokurori ka shfaqur mendim me vendimin e mosfillimit”, me arsyetimin se shkak i paraqitur se prokurori ka shfaqur mendim se ka marrë vendim mosfillimi i parashikuar nga neni 17/1, shkronja “c” nuk përfshihet në rastet e zëvendësimit të prokurorit dhe nuk futet në shkaqet që parashikon neni 27 pika 1, të K. Pr. Penale.
 - “zvarritjes së procesit gjyqësor për shkak të shtyrjes së seancave për mungesë të prokurorit duke cenuar zhvillimin e gjykimit sipas një afati të arsyeshëm”, me arsyetimin se pretendimet e paraqitura prej ankuesit nuk janë të bazuara në ligj, dhe gjithashtu lidhen me kompetencat e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale me pavarësi dhe paanësi.
 - “prokurori ka regjistruar procedim penal në shkelje të ligjit në ngarkim të shtetasit, i cili për këtë shkak nuk pajisjet dot me vërtetim që nuk ka ndjekje penale”, me

arsyetimin se pretendimet e ngritura nga kërkuesi nuk parashikohen në nenin 27 të K. Pr. Penale. Pretendimet e paraqitura prej kërkuesit nuk janë të bazuara në ligj, dhe gjithashtu lidhen me kompetencat e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale me pavarësi dhe paanësi.

- *“prokurori ka publikuar akte sekrete të cilat cenojnë hetimin, me pretendimin se ja ka vënë në dispozicion mbrojtësit të një shtetasi pa qenë palë dhe subjekt në çështjen në fjalë”*, me arsyetimin se personi ka qenë person i kallëzuar dhe në zbatim të nenit 105/1 të K. Pr. Penale është person që ka interes për ecurinë e procedimit dhe si i tillë duhej të njihet dhe merrte kopje të akteve të këtij procedimi penal.
- *“nga ana e prokurorit ka vonesa në hetim, në kryerjen e veprimeve hetimore në kohë dhe në afat ose kallëzuesi nuk ka informacion për procedimin”*, në pesë praktika, me arsyetimin se të gjitha vendimmarrjet e prokurorit verifikohen para gjykatës.

b) papajtueshmëri për shkak lidhje gjinie, në bazë të nenit 16 të K. Pr. Penale, rasti kur:

- *“prokurori është në lidhje gjinie të afërt me avokatin e të pandehurës”*.

c) kalimi i kallëzimi penal/procedimit tek seksioni kompetent, në 56 raste.

d) paaftësisë së përkohshme fizike në punë, për rastin e një prokurori.

e) transferimit në prokurori tjetër, për rastet e tre prokurorëve.

f) shkarkimit nga detyra në rastet e tre prokurorëve.

6. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka dërguar informacion se *“në lidhje me deklarimin e prokurorit për heqje dorë ose të kërkesës së palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit, procedura e ndjekur është, protokollimi i kërkesës së prokurorit ose palëve/subjekteve, kalimi i praktikës Drejtuesit të Prokurorisë, i cili shprehet me vendim mbi pranimin ose mospranimin të kërkesës së prokurorit ose palëve/subjekteve, hapi fundit njoftimi i prokurorit ose palëve/subjekteve.*

Në rast të pranimit të kërkesës për heqje dorë ose zëvendësimin të prokurorit, çështja në hetim shorthet ndërmjet prokurorëve të tjerë të cilët ushtrijnë funksionin.

Gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, nuk ka pasur ankime ndaj vendimeve të Drejtuesit për zëvendësimin e prokurorit”.

- ✓ Në funksion të kësaj procedure në këtë prokurori për vitin 2023 ka pasur një rast të zëvendësimit të prokurorit në gjykim, me shkakun e papajtueshmërisë për shkak lidhje gjinore, bazuar në nenin 16 të K. Pr. Penale, e cila është shqyrtuar nga drejtuesi i prokurorisë mbi bazën e kërkesës së prokurorit dhe është pranuar prej tij.
- ✓ Nga ky rast i vetëm përveç kërkesës për heqje dorë dhe vendimit të drejtuesit për pranimin e saj, nuk identifikuaam në praktikë nëse kërkesa dhe vendimi marrin një numër regjistrimi, si dhe nuk paraqitej procedurë shorti për caktimin e prokurorit tjetër, referuar vendimit se prokurori zëvendësues u caktua me short.

7. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në përgjigjen e saj ka shpjeguar se “në lidhje me procedurën e ndjekur dhe mënyrën se si procedohet nga data 09.06.2023 është proceduar me mbajtjen e praktikave të kërkesave dhe vendimeve për pranimin apo mospranimin e heqjes dorë. Kërkesat e prokurorëve për heqje dorë paraqiten nga prokurorët pranë sekretares së drejtuesit e cila i protokollon në protokoll të brendshëm dhe më pas ja kalon Drejtuesit të Prokurorisë që merr vendimin për pranimin ose jo të kërkesës së prokurorit. Një kopje e vendimit për mospranimin e kërkesës mbahet nga sekretarja e drejtuesit, e cila kryen shënimet dhe administron praktikën si dhe një kopje i kalon prokurorit të çështjes.

Në rast se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë merret vendim për pranimin e kërkesës, një kopje e vendimit i vihet në dispozicion prokurorit, një kopje në praktikën e mbajtur nga sekretarja e drejtuesit, kurse një kopje i bashkëlidhet dosjes që i kalon personave të caktuar për të kryer procedurat e hedhjes në short.

Përsa i përket periudhës para datës 09.06.2023 nuk mund të evidentohen të dhënat, për shkak se nuk janë mbajtur praktika nga protokollin dhe sekretarja e drejtuesit. Për shkak të lëvizjeve të shumta të prokurorëve si pasojë e transferimeve apo shkarkimeve nga KPK-ja gjatë vitit 2023 nuk mundësohet marrja e informacioneve nga vetë prokurorët e çështjeve.

Në lidhje me procedurën e zhvilluar kur drejtuesi pranon kërkesën e heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit procedura që ndiqet për caktimin e prokurorit është nëpërmjet shortit.

Ndaj vendimit për zëvendësimin apo mospranimin e kërkesës për zëvendësim nuk rezulton të ketë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

- ✓ Në 8 praktika të administruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, nga të cilat dy i përkasin zëvendësimit të prokurorit në gjykim, mënyra e të proceduarit nga prokurorët

është me “Kërkesë për heqje dorë” ose “Deklaratë për heqje dorë”, të paraqitura nga vetë prokurorët, ndërsa nuk rezulton ndonjë iniciativë e palëve ose subjekteve të tjera të procedimit penal.

- ✓ Praktika e zëvendësimit të prokurorit që ndiqet në këtë prokurori përbëhet nga kërkesa/deklarata për heqjen dorë, vendimi i drejtuesit për pranimin ose jo dhe procesverbali i shortit manual për caktimin e prokurorit zëvendësues.
- ✓ Praktikrat kanë ardhur të plota dhe në çdo rast kërkesat/deklaratat për heqje dorë, si dhe vendimet e drejtuesit të prokurorisë figurojnë të regjistruara në regjistrin e brendshëm, çfarë bën të mundur identifikimin e momentit të paraqitjes së kërkesës, si dhe procedurën për përcjelljen e materialit në zyrën e drejtuesit të prokurorisë, marrjen e vendimit, realizimin e shortit dhe njoftimet përkatëse.
- ✓ Nga kërkesat e paraqitura në 4 raste nga drejtuesi është vendosur mospranimi i kërkesës/deklaratës së prokurorit për heqje dorë dhe konkretisht për një kërkesë ku është pretenduar si shkak njëanshmërie konfliktet me të pandehurën gjatë hetimit dhe gjykimin, për një kërkesë ku është kërkuar heqja dorë për shkak ngarkese të prokurorit dhe të dosjes komplekse dhe në dy raste ku është paraqitur si shkak kalimi i procedimit në seksionin kompetent. Në rastet e mospranimit të kërkesës për heqje dorë vendimi i drejtuesit i njoftohet prokurorit që ka paraqitur kërkesën dhe në vendim herë sanksionohet e drejta e ankimit dhe herë jo ndaj vendimit të drejtuesit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
- ✓ Shkaqet e parashtuara nga prokurorët për njëanësi bazuar në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie janë vetëm deklarative edhe në ato raste ku mundet të provohen, e kërkuar kjo edhe në vendimet e drejtuesit, ku në një rast mbështeten me prova si ai për zëvendësimin e prokurorit që ka pasur kontradikta me personat nën hetim të dënuar më parë prej tij, duke paraqitur për këtë qëllim vendimin gjyqësor të dënimit.
- ✓ Nga praktikrat e zëvendësimit në Prokurorinë Fier, rezultojnë se shkaqet për të cilat është kërkuar/deklaruar heqja dorë për zëvendësimin e prokurorit janë:
 - a) **arsye njëanësie**, të bazuara në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, referuar nenit 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, në 3 raste, ku janë pranuar si të tilla rastet kur:
 - “*prokurori ka njohje me vajzën e personit nën hetim*” rast në gjykim, me arsyetimin se njohja personale me vajzën e të pandehurit është një rrethanë/shkak i rëndësishëm që do të vinte në dyshim paanësinë e prokurorit në çështjen konkrete.
 - “*prokurori ka hetuar më parë subjektet e kallëzuar dhe ka pasur kontradikta gjatë procesit, të cilët edhe janë dënuar*”, me arsyetimin se për shkak të kontradiktave në çështjen që ka ndjekur më parë kundër personit nën hetim dhe tre familjarëve të tij, të cilët janë dënuar prej tij, do vihej në dyshim paanësia e tij në çështjen konkrete.
- ✓ **Ndërsa nuk është pranuar si shkak njëanësie rasti kur:**

- *“prokurori është konfliktuar me të pandehurën gjatë hetimeve të procedimit penal dhe gjykimin duke u pretenduar se ajo ka bërë edhe kallëzim ndaj prokurorit”*, rast në gjykim, me arsyetimin se nuk është paraqitur asnjë dokument që njofton kallëzimin penal të të pandehurve apo regjistrimin e ndonjë kallëzimi/procedimi dhe është në kompetencë të gjykatës të vlerësojë veprimet e prokurorit dhe bazueshmërinë në ligj dhe prova të akuzës së ngritur prej tij, si dhe fakti që nga ana e të pandehurës ngrihen pretendime ndaj prokurorëve apo mund të avancohet në kallëzime penale ndaj tyre, nuk përbën në vetvete shkak për heqje dorë apo përjashtimin e tyre.
- b) **kalimi i procedimeve në seksionin kompetent**, në 4 raste, të cilat nuk bazohen realisht në shkaqe procedurale, por mbështeten në urdhrat e brendshëm të drejtuesit për ndarjen në seksione. Në dy nga këto praktika nuk është pranuar zëvendësimi i prokurorit, në bazë të udhëzimit nr. 03, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm *“Për shpërndarjen e çështjeve ne prokurori”*, i ndryshuar, kreu V, pika 1, ku ndër të tjera parashikohet se, nëse ushtrimi i ndjekjes penale bëhet kryesisht nga prokurori, çështja i caktohet atij prokurori pa u hedhur në short”.
- c) **ngarkesa e prokurorit dhe dosje e vjetër dhe komplekse**, në 1 rast, mos pranuar me arsyetimin se dosja është komplekse dhe duhet përfunduar sa më shpejt nga prokurorët e grupit hetimor dhe që kanë hetuar më parë këtë dosje ose pjesë të saj.

8. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në përgjigje të kërkesës për praktikant dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve ka informuar se *“zëvendësimi i Prokurorit nga hetimi i çështjes shqyrtohet nga Drejtuesi i Prokurorisë në rastet kur është bërë nga palët ose kur kërkesa paraqitet nga Prokurori për dorëheqje nga çështja. Në të dy rastet në kërkesë parashtrihen arsyet e përjashtimit apo dorëheqjes nga hetimi. Çdo kërkesë e paraqitur vlerësohet nga Drejtuesi i Prokurorisë duke u shprehur me vendim pranimi ose mospranimi.*

Nuk rezulton të ketë vendim të marrë kryesisht nga Drejtuesi i Prokurorisë për zëvendësimin e Prokurorit nga çështje.

Në lidhje me procedurën e ndjekur për zëvendësimin e Prokurorit kur kërkesa paraqitet nga palët ajo depozitohet në zyrën e protokollit e cila merr numër dhe datën e dorëzimit, ku në vijim kërkesa përcillet te Drejtuesi i prokurorisë, i cili pasi e shqyrton del me vendim pranimi apo mos pranimi.

Kur kërkesa paraqitet nga Prokurori me Memo apo dorëheqje dosja së bashku me kërkesën dorëzohet direkt tek Drejtuesi i Prokurorisë, i cili përsëri pas shqyrtimit të saj del me vendim pranimi apo mos pranimi. Në të gjitha rastet vendimi ju komunikohet palëve dhe Prokurorit”.

- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë një nga format e të proceduarit të prokurorit është me “Memo”, kur kallëzimi ose procedimi penal duhet të kalojë seksionit kompetent, si dhe me “Kërkesë për heqje dorë” dhe “Deklarim për heqje dorë” nga hetimi i kallëzimit/procedimit penal. Këto kërkesa/memo shqyrtohen nga drejtuesi i prokurorisë, vendimi i të cilit i njoftohet prokurorit dhe nëse ka edhe palës. Në rast pranimi me anë të shortit caktohet prokurori tjetër. Procesverbali i shortit manual në ato raste që është bërë i mundur mbahet midis drejtuesit të prokurorisë dhe punonjësës së zyrës së regjistrimit, ndërsa për shortin elektronik dokumentohet nga sistemi Cams.
- ✓ Të gjitha rastet e paraqitura nga Prokuroria Vlorë në 37 praktika zëvendësimi, ku një i përket zëvendësimit të prokurorit në gjykim, janë kërkesa/deklarime të prokurorëve për heqje dorë, të cilat janë pranuar të gjitha nga drejtuesi i prokurorisë, ndërsa nuk ka pasur asnjë praktikë të iniciuar me kërkesë të palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit.
- ✓ Sipas informacionit memot/kërkesat e prokurorit apo të palëve i dorëzohen drejtuesit të prokurorisë, megjithatë në asnjë prej praktikave nuk mund të identifikojmë numër dhe datë regjistrimi të tyre për momentin e kalimit të tyre tek drejtuesi.
- ✓ Në disa praktika zëvendësimi mungojnë vendimet e drejtuesit të prokurorisë për shqyrtimin e kërkesave/memove (8 prej praktikave), si dhe në pjesën më të madhe të tyre (21 prej praktikave, 5 prej të cilave edhe vendimet edhe shorti) mungon dokumentimi i shortit manual apo elektronik për caktimin e prokurorit zëvendësues, pasi dhe në ato pak raste identifikohet caktimi me short i prokurori zëvendësues nëpërmjet shortit elektronik nga sistemi Cams vënë në dispozicion nga kjo prokurori.
- ✓ Në disa raste caktimi i prokurorit tjetër është bërë drejtpërdrejt, pa short. Caktimi i prokurorit është bërë pa short për disa procedime njëherësh me arsyetimin se për shkak të ngarkesës së madhe, faktit se prokurorja është drejtuese seksioni, si dhe për faktin se seksionit për të mitur i është shtuar një prokuror tjetër, këto procedime penale i kanë kaluar për hetim këtij prokurori. Rasti tjetër i caktimit pa short përsëri i përket caktimit të prokurorit të seksionit të të miturve, për shkak se pas pezullimit nga detyra të prokurores nga KPK, si dhe për faktin se seksionit për të miturit dhe ekzekutimeve i është shtuar një prokuror tjetër, këto procedime penale i kanë kaluar për hetim këtij prokurori. Rasti tjetër i caktimit të prokurorit pa short ka ndodhur në rastin kur prokurori i gatshëm ka kryer regjistrimin e materialit kallëzues për të kryer veprimet e ngutshme për vleftësim dhe caktim mase sigurimi, duke kërkuar zëvendësimin me prokurorin të cilit i është shortuar materiali kallëzues fillimisht me short elektronik. Sipas një praktike tjetër është bërë caktimi drejtpërdrejt i prokurorit zëvendësues, duke u caktuar prokurori që ka qenë i gatshëm ditën e ngjarjes, pasi ky prokuror ka bërë dhe vleftësimin e sekuestrimit të provave materiale në vendngjarje apo veprimeve të tjera me natyrë urgjente.
- ✓ Nga praktikat e Prokurorisë Vlorë rezulton se në një rast janë paraqitur prova, kur shkaku ishte se prokurori ka qenë avokat i një prej viktimave në kohën para se të

merrte detyrën e prokurorit, duke u paraqitur vendimi i gjykatës, ku prokurori rezulton përfaqësues i viktimës së veprës penale.

✓ Në këtë prokurori zëvendësimi i prokurorëve është kërkuar dhe ka ndodhur për këto shkaqe:

a) **arsye njëanësie, referuar nenit 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale**, në 2 raste, ku janë pranuar rastet kur:

➤ *“prokurori me kallëzuesen apo bashkëshortin e saj ka pasur materiale të mëparshme në hetim apo verifikim nga të cilat ka hequr dorë për shkak se ata në vazhdimësi kanë kërkuar zëvendësimin e tij si prokuror në kallëzimet e tyre duke e lidhur këtë fakt me shkaqe njëanshmërie në trajtimin e kallëzimeve të tyre. Kallëzuesit kanë depozituar edhe kallëzim penal ndaj prokurorit në lidhje me vendimmarrjet e mëparshme të tij, ku palë kallëzuese kanë qenë po këta shtetas”.*

➤ *“prokurori ka qenë avokat i një prej viktimave në kohën para se të merrte detyrën e prokurorit”, pranuar me qëllim për të shmangur çdo lloj pretendimi njëanshmërie.*

b) **papajtueshmëri për shkak lidhje gjinie**, në bazë të nenit 16 të K. Pr. Penale, rasti kur:

➤ *“prokurori me të pandehurin ka lidhje të afërta gjinie dhe konkretisht ai është djali i xhaxhait të prokurorit”, ndërsa në fakt ky rast është pranuar si nga prokurori dhe drejtuesi i prokurorisë për shkaqe serioze njëanshmërie referuar nenit 17/1 germa “ë”, të K. Pr. Penale.*

c) **për shkak të ngarkesës duke qenë se prokurori është dhe drejtues seksioni**, në 1 rast.

d) **kalimi i kallëzimit/procedimit penal tek seksioni kompetent**, në 29 raste.

e) **për shkak të gatishmërisë, në rastet kur:**

➤ *“Kalimin e procedimit prokurorit që është caktuar fillimisht sipas shortit elektronik, pas kryerjes si prokuror i gatshëm të veprimeve hetimore të ngutshme të vleftësimit të ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit personal ndaj personit nën hetim”*

➤ *“Kalimin e procedimit prokurorit që ka qenë i gatshëm ditën e ngjarjes, si prokurori që ka bërë dhe vleftësimin e sekuestrimit të provave materiale në vendin e ngjarjes apo veprimeve të tjera me natyrë urgjente”.*

f) **transferimi i prokurorit**, në 1 praktikë.

g) **pezullimit të prokurorit nga detyra**, në 1 praktikë.

9. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në përgjigje të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka informuar se “në rastin kur kërkesa për zëvendësim vjen prej personit ndaj të cilit zhvillohen hetime apo prej një pale të dëmtuar, kërkesa për zëvendësim e ardhur me postë regjistrohet në librin e kërkesë-ankesave dhe dorëzohet me firmë tek drejtuesi. Drejtuesi konsultohet me prokurorin e çështjes dhe nëse e konsideron të nevojshme, kërkon sqarime nga kërkuesi. Drejtuesi shprehet me vendim pranimi ose mospranimi dhe vendimi i komunikohet kërkuetit. Në rastin kur kërkesa për zëvendësim pranohet, çështja rihidhet në short për të përcaktuar prokurorin e ri. Kërkesa dhe vendimi administrohen në dosjen penale.

Në rastin kur kërkesa për heqje dorë vjen nga prokurori i çështjes, kërkesa dorëzohet nga prokurori tek drejtuesi. Drejtuesi konsultohet me prokurorin e çështjes dhe shprehet me vendim pranimi ose mospranimi. Kërkesa e prokurorit dhe vendimi i drejtuesit administrohen në dosjen penale. Në rastin kur kërkesa për heqje dorë pranohet, çështja rihidhet në short për të përcaktuar prokurorin e ri.

Në rastin kur drejtuesi konstaton se i akuzuari apo viktima janë të mitur dhe gjatë hedhjes të shortit ky fakt nuk është konstatuar, vendos zëvendësimin e prokurorit dhe zbaton rregullat e caktimit të prokurorit për të mitur.

Nuk ka pasur ankesa ndaj vendimit për zëvendësim”.

- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2023, rezulton se praktika që ndiqet në zëvendësimin e prokurorit përbëhet nga kërkesa për heqje dorë, vendimi i drejtuesit për shqyrtimin e saj, por mungon dokumentimi i shortit për caktimin e prokurorit zëvendësues, i cili sanksionohet në vendimet për pranimin e heqjes dorë. Vetëm në një rast të zëvendësimit të prokurorit për shkak të kalimit të çështjes tek seksioni për të miturit, prokurori është caktuar drejtpërdrejt ai i ngarkuar me çështjet për të mitur.
- ✓ Megjithëse në informacionin e prokurorisë thuhet se kërkesa e palëve regjistrohet në libër apo kërkesa e prokurorit i dorëzohet drejtuesit, në aktet e paraqitura nuk janë të pasqyruara këto fakte. Ndërkohë që pasqyrohet njoftimi i vendimit të drejtuesit të prokurorisë prokurorit që zëvendësohet.
- ✓ Në praktikën e zëvendësimit në prokurorinë Korçë nga prokurorët procedohet me “Kërkesë për heqje dorë”, por edhe në një rast kur ka pasur memorie për zëvendësimin e prokurorit, kjo memorie nuk i është bashkëlidhur praktikës, duke mos e bërë praktikën e plotë për të kuptuar qartë shkakun e krijimit ndaj palës të perceptimit për njëanshmëri të prokurorit.

- ✓ Të tria praktikat e sjella janë me kërkesë të prokurorëve për heqjen dorë, për të cilat është vendosur pranimi i kërkesave për heqje dorë dhe zëvendësimi i prokurorit për të tria rastet.
- ✓ Shkaqet për të cilat është kërkuar dhe kryer zëvendësimi i prokurorëve në këtë prokurori rezultojnë:
 - a) **arsye njëanësie**, referuar nenit 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, në 2 raste, ku janë pranuar si të tilla rastet kur:
 - *“kallëzuesi ka pasur pretendime për zvarritje të hetimeve”*, me arsyetimin se prokurori i çështjes prej momentit të regjistrimit të çështjes penale nuk rezulton të ketë kryer veprime hetimore.
 - *“prokurori ka njohje me viktimën dhe personin nën hetim dhe njëkohësisht është dhe komshi i tyre, si dhe ka lidhje familjare me familjarët e viktimës së veprës penale”*, me arsyetimin për të garantuar paanshmërinë e hetimit jo vetëm objektivisht, por edhe në kuptim të perceptimit të këtij objektiviteti nga palët.
 - b) **kalimi i procedimit tek seksioni kompetent**, në 1 rast.

10. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

Në lidhje me procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorëve për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës ka informuar se *“zëvendësimi i prokurorit për një çështje të caktuar është bërë në ato raste kur prokurori ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga kallëzimi/procedimi penal të ngarkuar atij, tek Drejtuesi i Prokurorisë. Kjo ka ndodhur për arsye të ndryshme si p.sh kur ka konflikt interesi me personat e përfshirë në fashikullin hetimor, ose kur rezulton se nga studimi i kallëzimit/procedimit penal materiali i përket seksionit tjetër, etj.*

Drejtuesi i Prokurorisë pasi njihet me kërkesën për heqje dorë del me vendim për pranim ose jo të kërkesës, dhe në vendim shprehet në lidhje me zëvendësimin e prokurorit. Në përgjithësi materiali shortohet sërish me short manual në prezencë të prokurorëve, kryesekretarit dhe specialistit të IT-së. Shorti manual shoqërohet gjithmonë me proces-verbalin përkatës”.

- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës një praktikë zëvendësimi e prokurorit përbëhet nga kërkesa për heqje dorë, vendimi i drejtuesit dhe procesverbali i hedhjes në short manual për caktimin e prokurorit zëvendësues në prani të prokurorëve, kryesekretarit të prokurorisë dhe specialistit IT). Kjo lloj praktike është paraqitur në ILD për çdo rast, me përjashtim të mungesës së kërkesave për

heqje dorë të dy prokurorëve.

- ✓ Konstatohet se të gjitha rastet janë iniciuar me kërkesë të prokurorit, pra, nuk ka asnjë rast të pretenduar nga palët/subjektet e procedimit penal ose nga vetë drejtuesi i prokurorisë.
- ✓ Gjithashtu, forma e aktit me të cilin procedojnë zakonisht prokurorët sipas këtyre praktikave është “Kërkesë për heqje dorë”, edhe në rastin kur materiali kallëzues duhet të kalojë në seksionin kompetent sipas veprave penale ose të miturit.
- ✓ Në kërkesat e prokurorëve për heqje dorë nuk identifikohet nëse janë të regjistruara, po ashtu edhe vendimet e drejtuesit.
- ✓ Me përjashtim të një rasti, ku materiali i referuar nga vetë prokurori i është caktuar një prokurori tjetër, në 10 praktikat e tjera janë pranuar kërkesat për heqje dorë të prokurorit dhe zëvendësimi nga drejtuesi i prokurorisë. Në këto vendime ndiqet procedura e njoftimit të vendimit prokurorit që zëvendësohet, e cila sanksionet në vendim, si dhe të pandehurit për rastin kur zëvendësimi është bërë në gjykim, zëvendësim me të cilin ka të bëjë një praktikë.
- ✓ Në Prokurorinë Kukës konstatohen dy raste të kalimit të procedimit penal/materialit kallëzues pa short, direkt prokurorit zëvendësues, për arsye se ndër tre prokurore që ka pasur kjo prokurori njëri prej tyre ishte i përjashtuar nga shorti me urdhër të drejtuesit të prokurorisë dhe në rastin tjetër për arsye se prokurori i caktuar ka qenë prokuror i vetëm në seksionin kompetent.
- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës zëvendësimi i prokurorëve është kryer për këto shkaqe:

a) **arsye njëanësie**, referuar nenit 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, në 6 raste, ku janë pranuar se përbëjnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie rastet e deklaruara nga prokurorët bazuar në pretendimet ose ankesat e të pandehurve për njëanshmëri dhe deklaramet e njëanshmërisë nga vetë prokurori kur:

- “kallëzuesja është dhe person nën hetim në një procedim tjetër penal të prokurorit, ku ajo ka pretendime për hetimin ndaj saj dhe është ankuar vazhdimisht në media si dhe deklarata publike dhe po ashtu ka paraqitur edhe kallëzime penale”, në dy praktika.
- “i pandehuri ka paraqitur disa herë ankesa dhe pakënaqësi lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke pretenduar për njëanshmëri gjatë hetimit”, rast zëvendësimi i prokurorit në gjykim.
- “për të njëjtin kallëzues prokurorja ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për një kallëzim të mëparshëm, i cili pas këtij vendimi mosfillimi ka bërë kallëzim ndaj prokurores”.
- “prokurorja është në një lidhje faktike me personin, i cili të dëmtuarin e ka lidhje gjaku të shkallës së tretë dhe kanë ruajtur marrëdhënie familjare të ngushta me njeri-tjetrin, si dhe ka njohje edhe me djalin e të dëmtuarit”.

- “prokurori ka referuar vetë materialin kallëzues”, me arsyetimin për të mos pasur konflikt interesi të prokurores me akuzën.
- b) **kalimi për kompetencë lëndore në seksionin përkatës**, në 5 raste, sipas Urdhrit të ndarjes në seksione, konkretisht materialeve kallëzuese.

11. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

- ✓ Në praktikat e zëvendësimit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë procedohet me “Kërkesë për heqjen dorë” nga hetimet e procedimit penal, përveç një praktike ku nga prokurori paraqitet “Informacion”.
 - ✓ Në kërkesat dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohet fakti që procedohet me regjistrimin e tyre, në ndryshim nga kërkesat e palës, të cilat ndjekin rrugën e rregullt të protokollit në sekretari, e më pas i përcillen drejtuesit të prokurorisë dhe i njoftohen prokurorit për të dhënë mendim me anë të informacionit përkatës.
 - ✓ Në rast se procedohet me kërkesë të palëve ose subjekteve të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit, sipas siglimit të drejtuesit mbi kërkesën e palëve nga prokurori i cili pasi njihet me këtë kërkesë përgatitet informacion, ku ai vlerëson nëse ka shkaqe për heqjen dorë. Në këto raste vendimi i drejtuesit të prokurorisë i njoftohet kërkuarit me shkresë përcjellëse.
 - ✓ Nga Prokuroria Lezhë rezulton një paraqitje e plotë e dokumentacionit, ku praktika e zëvendësimit të prokurorit përbëhet nga kërkesa e prokurorit ose nëse ka kërkesa e palës, vendimi i drejtuesit dhe procesverbali i shortit manual për caktimin e prokurorit tjetër (i cili mbahet midis të gjithë prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë).
 - ✓ Nga 4 praktikat e marra nga kjo prokurori konstatohet se rastet e zëvendësimit vijnë 2 me kërkesë të vetë prokurorit, të cilat janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë dhe 2 praktika të tjera me pikënisje nga kërkesa e përsëritur e kallëzuesit/viktimës së veprës penale për zëvendësim, ku për kërkesën e parë nuk është pranuar zëvendësimi dhe është pranuar pas kërkesës së dytë nga viktimja e veprës penale.
 - ✓ Në përgjithësi shkaqet e njëanshmërisë paraqiten nga prokurorët në mënyrë deklarative, dhe vetëm në një rast si prova nga prokurori janë paraqitur vendimet e mosfillimeve të mëparshme ndaj të njëjtit kallëzues.
 - ✓ Ndër katër rastet e paraqitura zëvendësimi i prokurorit ka ndodhur për këto shkaqe:
- a) **arsye njëanësie**, referuar në nenin 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, dy raste të deklaruara nga vetë prokurorët, të cilat vijnë për shkak të pretendimeve të kallëzuesit ndaj hetimeve të prokurorit ose për shkak të kallëzimeve të mëparshme të trajtuara për të njëjtin kallëzues, si dhe 2 raste të pretendimeve të viktimës ndaj punës hetimore të prokurorit:

- *“kallëzuesja ka bërë disa herë kallëzime ndaj prokurorit dhe ka shfaqur në mënyrë të vazhdueshme pretendime lidhur me rastet e trajtuara më parë nga prokurori duke parashtruar kërkesa për zëvendësim dhe ankesa në institucione të ndryshme”.*
- *“babai i viktimës së veprës penale ka pretendimeve ndaj veprimeve hetimore të prokurorit për moszbulimin e autorëve”.*
- *Në dy rastet me kërkesë të viktimës së veprës penale, i cili është i njëjti person në të njëjtin procedim penal, fillimisht nuk është pranuar kërkesa kur shkak i pretenduar ishte “për arsye se prokurori ka njohje me bashkëshorten e të akuzuarit, me dëshmitarët e ngjarjes dhe prokurori ka shfaqur mendime në lidhje me rastin objekt hetimi” dhe informacioni i prokurorit ishte se nuk kishte shkaqe për të hequr dorë.*
- *Më pas është pranuar zëvendësimi i prokurorit, bazuar në arsyetimin për të hequr çdo mëdyshje lidhur me objektivitetin në qëndrimin e prokurorit në hetimin e çështjes penale, ku shkak i pretenduar ishte “nuk janë kryer hetime paraprake të shpejta e të thelluara; nuk janë pranuar kërkesat e viktimës për zgjerimin e hetimeve me marrje të provave; nuk është informuar për gjendjen e procedimit, apo për masat e sigurimit të marra ndaj autorit të dyshuar, prokurori në kohë të ndryshme dhe në momente të ndryshme ka qëndruar edhe në dreka/darka, kafe me bashkëshorten e personit që ka nën hetim, sipas fotografive të paraqitura nga viktimat” dhe informacioni i prokurorit kësaj here ishte se nuk ka shkaqe procedurale për heqje dorë, por referuar shfaqjes së hapur të humbjes së besimit të kërkuesit në zgjidhjen e çështjes dhe për të shmangur çdo lloj interpretimi dhe paragjykim të mëvonshëm në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale.*

12. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka informuar se *“Drejtuesi i Prokurorisë në rastet kur vlerëson se kanë lindur arsye serioze që lidhen me ushtrimin e detyrës për të pranuar deklaratën e heqjes dorë të prokurorit të çështjes në funksion të parimit që magjistrati (gjyqtari dhe prokurori) jo vetëm duhet të jetë dhe të tregohet në veprimtarinë e tij i paanshëm dhe objektiv, por paanësia dhe ndershmëria duhet edhe të duken ndaj subjekteve të procedimit penal apo dhe më gjerë bazuar në nenet 43, germa “d” dhe 49.1 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 26.2 dhe 26.3 të K. Pr. Penale, ka proceduar me pranimin e deklaratave të heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit nga drejtimi i hetimeve në çështje të caktuara penale.*


Zëvendësimi i prokurorit kryhet edhe kur materiali i shortuar apo trajtuar për shkak të gatishmërisë rezulton se është në kompetencën e seksionit të posaçëm (prokurori i caktuar për trajtimin e çështjeve me të mitur, dhunën në familje apo hetimin pasuror), kur sipas Urdhrit nr. 51, datë 06.09.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka rezultuar e nevojshme që të disponohet me

vendim për pranimin e deklaratës për heqje dorë duke ngarkuar prokuroren e caktuar për trajtimin e çështjeve me të miturit ose dhunën në familje apo në zbatim të Urdhrit nr. 53, datë 06.09.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë për të zëvendësuar prokurorin e çështjes me prokurorin që ka në kompetencë lëndore hetimin pasuror.

Në çdo vendim zëvendësimi, në dispozitiv përcaktohet edhe metodologjia përkatëse e trajtimit të materialit kallëzues procedimit penal sipas kryerjes së procedurave të shortit elektronik/manual për përzgjedhjen e prokurorit apo caktimin e prokurorit përkatës sipas kompetencës lëndore (sipas Urdhrit nr. 51/2023 "Për caktimin e prokurorit përgjegjës për ndjekjen e çështjeve me të mitur, për ekzekutimin e vendimeve penale, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, etj.", apo nr. 53/2023 "Për caktimin e prokurorit përgjegjës, për ndjekjen e hetimeve kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore" të Drejtuesit të Prokurorisë për prokurorin përgjegjës për trajtimin e materialeve).

Në këtë prokurori ka pasur një rast ankimi të prokurorit ndaj vendimit për zëvendësim të drejtuesit të Prokurorisë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

- ✓ Praktikant e paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë janë të plota përsa i përket procedurës për zëvendësimin e prokurorit me deklaratën për heqje dorë/informacionin, vendimin e drejtuesit të prokurorisë, procesverbalin e caktimit me short të prokurorit tjetër dhe njoftimeve përkatëse.
- ✓ Në gjashtë praktikant e zëvendësimit të Prokurorisë Sarandë të iniciuara nga vetë prokurorët, mënyra e procedimit të prokurorit është me "Deklaratë për heqjen dorë" apo edhe "Informacion" në rastet kur materiali duhet ti kalojë seksionit kompetent.
- ✓ Kërkesat apo informacioni i prokurorit nuk identifikohet me ndonjë mënyrë regjistrimi për ti kaluar drejtuesit të prokurorisë, ndërsa vendimet e drejtuesit janë rregullisht me numër protokolli.
- ✓ Nga rastet e paraqitura konstatohet se prokurori zëvendësues me përjashtim të rasteve të kalimit të materialeve kallëzuese prokurorit kompetent është caktuar me short elektronik, provuar nga paraqitja e fletës së sistemit Cams.
- ✓ Në 5 praktika të shqyrtuara të prokurorisë Sarandë deklaratat apo informacionet për heqje dorë të prokurorit në fazë verifikimi ose hetimi janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit dhe në një praktikë zëvendësimi i prokurorit është bërë nga drejtuesi i prokurorisë pa pëlqimin e prokurorit, bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale në lidhje me nenin 16 të këtij kodi. Vendimi i drejtuesit të prokurorisë është ankimuar nga prokurori dhe është lënë në fuqi nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Në lidhje me pretendimin se vendimi i drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit vjen në kundërshtim me nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale, si dhe



nenin 49 të ligjit nr.97/2016, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka arsyetuar se përsa i përket bazueshmërisë së vendimit të zëvendësimit të prokurorit në nenin 17, pika 1, germa "e" dhe "ë" të K. Pr. Penale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se kjo referencë ligjore është përtej rasteve të parashikuara në nenin 27, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale. Për rrjedhojë, në mungesë të pëlqimit paraprak të prokurorit të zëvendësuar, drejtuesi i prokurorisë ka ushtruar diskrecionin në mënyrë jo të ligjshme duke passjell paligjshmërinë e aktit për këtë pjesë. Për sa i përket bazueshmërisë së arsyetimit të vendimit të zëvendësimit të prokurorit në nenin 27, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, fjalia "*kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit*", Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se arsyetimi i aktit administrativ për këtë pjesë është jo i plotë duke mos dhënë një shpjegim ligjor për zbatimin e tij në këtë rast. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vlerëson se kompetenca ligjore e drejtuesit të prokurorisë kufizohet vetëm në aspektin procedural të hetimit lidhur me aftësinë e prokurorit të çështjes për ushtrimin e funksionit në raport me respektimin e afateve ligjore. Çdo vlerësim tjetër në lidhje me bindjen e brendshme të prokurorit të çështjes për ngritjen e akuzës apo për zhvillimin e hetimeve paraprake, përtej mekanizmit të udhëzimit jo detyrues, përbën potencialisht një ndërhyrje të paligjshme në ushtrimin e detyrës së prokurorit të çështjes. Për rrjedhojë, në mungesë të arsyetimit të vendimit në lidhje me "*arsyet serioze që lidhen me detyrën*", drejtuesi i prokurorisë ka ushtruar diskrecionin në mënyrë jo të ligjshme duke passjell paligjshmërinë e aktit për këtë pjesë. Për sa i përket bazueshmërisë së arsyetimit të vendimit të zëvendësimit të prokurorit në nenin 16 të Kodit të Procedurës Penale, drejtuesi i prokurorisë ka arsyetuar se në procedim një nga pjesëmarrësit në hetim ka lidhje gjinie që e pamundëson vazhdimin e hetimeve. Shtetasi M. Sh., është kushëri i parë (djali i xhaxhait) i prokurorit, i cili është subjekt i përfshirë në hetim si një person që ka dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale. Sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se ndërmjet prokurorit të çështjes dhe personit që ka dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale ekziston një lidhje gjinie e afërt, referuar ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" i ndryshuar, që passjell papajtueshmërinë e prokurorit për këtë procedim penal.

✓ Nga 6 raste të paraqitura nga kjo prokurori, shkaqet e zëvendësimit të prokurorit rezultojnë:

a) **arsye njëanësie**, bazuar në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, sipas nenit 17/1, germa "ë" të K. Pr. Penale, ku është pranuar si tillë rasti kur:

➤ "*kallëzuesi i cili ka cilësinë e të pandehurit në një tjetër procedim penal në gjykim nga prokurorja ka paraqitur kallëzim penal ndaj akteve procedurale të prokurores*".

b) papajtueshmëri për shkak lidhje gjinie, në bazë të nenit 16 të K. Pr. Penale, në dy raste, nga të cilët në njërin prej tyre prokurori është zëvendësuar “kryesisht” nga drejtuesi i prokurorisë, për shkakun:

- *“njeri nga deklaruesit në procedimin penal është djali i xhaxhait të prokurorit”*. Pasi vendimi i drejtuesit të prokurorisë në këtë rast është lënë në fuqi nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, rasti i dytë që ka të bëjë me të njëjtin prokuror dhe për të njëjtin subjekt ku deklarimi i heqjes dorë është bërë nga vetë prokurori. Deklarimi për heqje dorë është pranuar nga drejtuesi i prokurorisë me arsyetimin se një lidhje gjinie e afërt midis prokurorit dhe deklaruesit/dëshmitarit e vendos prokurorin në pozita papajtueshmërie në ushtrimin e detyrës në kuptim të nenit 16 të K. Pr. Penale e për rrjedhojë kanë lindur arsye serioze që lidhen me ushtrimin e detyrës, të cilat mund të kenë në dukje lidhje me shkaqe të tjera njëanshmërie për të zëvendësuar prokurorin e çështjes.

c) kalimi i materialeve kallëzuese tek seksioni ose prokurori i caktuar, në 3 praktika, sipas urdhrave të brendshëm për seksionet në prokurori.

13. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Në lidhje me praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka informuar se *“të gjitha kërkesat për heqje dorë të palëve, pasi protokollohen në Zyrën e Koordinatorit, kalojnë fillimisht për shqyrtim tek Drejtuesi i Prokurorisë. Në lidhje me procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit, kërkesa për heqje dorë bashkë me dosjen penale dorëzohet nga prokurori tek Zyra e Sekretares së Drejtuesit ose në Kryesekretari, dhe kjo e fundit e kalon tek Zyra e Sekretares së Drejtuesit. Sekretarja e Drejtuesit të Prokurorisë, e protokollon kërkesën në “Regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale me Drejtuesin e Prokurorisë”, dhe e kalon kërkesën së bashku me dosjen tek Drejtuesi i Prokurorisë.*

Drejtuesi i Prokurorisë merr vendim me shkrim mbi deklarimin e prokurorëve për heqje dorë kryesisht apo të iniciuar nga kërkesa e palëve të interesuara, në zbatim të nenit 43 pika d) të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Çdo vendim i Drejtuesit të Prokurorisë për pranimin ose mospranimin e heqjes dorë regjistrohet me numër protokoll në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale me Drejtuesin e Prokurorisë dhe i njoftohet prokurorit”.

- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për vitin 2023, paraqiten 20 praktika të zëvendësimit të prokurorëve, si dhe zëvendësimi i dosjeve në gjykim dhe hetim të dy prokurorëve, njeri i transferuar dhe tjetri për shkak të shkarkimit nga detyra.



Bazuar në praktikat e administruara, të gjitha rastet e iniciuara për zëvendësim janë me “Kërkesë për heqje dorë” ose edhe “Deklaratë për heqje dorë” të prokurorit, ose “Informacion” për rastet e kalimit të materialeve kallëzuese nëpër seksionet kompetente sipas ndarjes në prokurori ose procedimit pasuror tek prokurori që heton veprën penale kryesore dhe nuk u ndesh asnjë praktikë ku iniciatorë të jenë palët ose ndonjë subjekt i procedimit penal.

- ✓ Në lidhje me procedurën e ndjekur në këtë prokurori, nga shqyrtimi i kërkesave për heqje dorë nga prokurorët, kërkesa pasi protokollohet në *regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale* kalon tek drejtuesi i prokurorisë, i cili merr vendimin mbi kërkesën/deklaratën e prokurorëve për heqje dorë. Me vendimin që pranon deklarimin e heqjes dorë, prokurori që ka hequr dorë zëvendësohet me një prokuror tjetër, duke e kaluar dosjen me vendim në Kryesekretari për t’u hedhur në short ndërmjet prokurorëve të tjerë të atij seksioni. Një kopje e vendimit që pranon heqjen dorë i dorëzohet edhe prokurorit të dorëhequr. Çdo praktikë zëvendësimi përbëhet nga kërkesa/deklarata për heqje dorë ose informacioni i prokurorit, vendimi i drejtuesit dhe procesverbali i shortit.
- ✓ Nga të gjitha praktikat e konstatuara nuk ka raste të mospranimi të kërkesës/deklaratës për heqje, pasi të gjitha janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë.
- ✓ Caktimi i prokurorit zëvendësues është bërë me short, me përjashtim të dy rasteve të hetimeve pasurore që i kanë kaluar prokurorit që ka në hetim veprën penale kryesore, kalimit të procedime penale për të njëjtin subjekt dhe të lidhura tek prokurori i seksionit të posaçëm, te cilat i janë kaluar pa short prokurorit përkatës. Në vetëm një praktikë nuk është paraqitur shorti për caktimin e prokurorit zëvendësues.
- ✓ Si kërkesat/deklaratat dhe vendimet e drejtuesit në këto praktika paraqiten të regjistruara në regjistrin e korrespondencës me drejtuesin.
- ✓ Bazuar në praktikat e shqyrtuara në këtë prokurori shkaqet që rezultojnë të pranuar për zëvendësimin e prokurorit janë:

a) **arsye njëanësie**, të bazuara në shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, të parashikuara nga neni 17/1, germa “ë” e K. Pr. Penale, të cilat janë pranuar në 11 praktika zëvendësimi, rastet kur:

➤ “*prokurori ka trajtuar disa herë çështje penale të të njëjtit kallëzues ose të kallëzuar në kuadër të të cilave ndaj prokurorit janë bërë kallëzime*”, në 2 praktika, me arsyetimin se prokurori ka hetuar kallëzime dhe procedime penale të mëparshme, ka një komunikim dhe raport problematik me palët dhe për këto shkaqe e ka të pamundur vijimin e hetimeve për shkak të paragjykitimit dhe mundësisë së konfliktit të interesit.

➤ “*bashkëshortja e prokurorit është drejtuese në institucionin që ka bërë kallëzimin penal*”, në 3 praktika, të cilat i përkasin të njëjtit prokuror. Në këto raste pranimi i kërkesës për heqje dorë është me arsyetimin për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes.

- *“të dëmtuarit nga vepra penale janë familjarë të kunatës së prokurorit”*, pranuar sipas arsytimit me qëllim për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes.
- *“njohje me kallëzuesin pasi ka punuar me këtë shtetas, i cili ka bërë dhe kërkesë për zëvendësimin e prokurorit”*, pranuar sipas arsytimit se trashëgimtari i viktimës, ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit për shkak të zvarritjes së procedimit, për shkak të mosmarrëveshjeve personale mes kërkuesit dhe prokurorit dhe me qëllim për të shmangur çdo lloj vonese, apo pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes.
- *“personat e kallëzuar dhe prokurori janë kushërinj dhe për të shmangur çdo konflikt interesi goftë edhe ne dukje”*.
- *“prokurori ka hetuar dhe dërguar për gjykim edhe djalin e personit nën hetim dhe për të shmangur çdo lloj paragjykimi”*, pranuar bazuar në pretendimet e personave nën hetim dhe për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri, subjektivizëm apo paragjykim të çështjes.
- *“kallëzuesin/i dëmtuari nga vepra penale është babai i kunatës së prokurorit”*, i cili është pranuar sipas arsytimit për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes.
- *“ka lidhje krushqie me dy nga të dyshuarit, ku vajza e hallës së prokurorit është e martuar me nipin e tyre”*, me arsytimin për të shmangur çdo lloj pretendimi për konflikt interesi dhe dyshimi për njëanshmëri apo paragjykim të çështjes.

b) zëvendësimi i prokurorit për shkak të procedimeve pasurore, në 2 raste, ku prokurori që ka procedimin pasuror heq dorë për ti kaluar prokurorit që heton veprën penale bazë.

c) zëvendësimi i çështjeve në hetim dhe në gjykim, në një numër i konsiderueshëm rastesh për shkak të largimit të dy prokurorëve. Lidhur me këtë arsye janë marrë 41 vendime zëvendësimi sa edhe janë çështjet e shpërndara nga prokurorët e larguar, konkretisht 41 vendime zëvendësimi për çështjet e prokurorit të zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe 65 vendime zëvendësimi për çështjet e prokurorit të pezulluar nga detyra.

d) kalimi i materialeve kallëzuese tek seksioni kompetent sipas veprave penale në 7 raste.

14. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i është përgjigjur Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me informacionin se, *“zëvendësimi i procedimeve*

penale bëhet në rastin e largimit të një prokurori me vendim të KPK ose KPA. Pasi është marrë vendimi për shkarkim me qëllim respektimin e afateve procedurale të çështjeve nxirret urdhër nga drejtuesi i prokurorisë "Për hedhjen në short të çështjeve" në varësi të seksionit nga ku prokurori i shkarkuar ushtronte detyrën.

Zëvendësimi i çështjeve penale bëhet dhe në rastin kur prokurori paraqet pranë Drejtuesit të prokurorisë kërkesën për heqje dorë nga hetimi. Pasi shqyrtohet kërkesa nga drejtuesi ky i fundit merr vendim dhe shprehet për pranimin dhe zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e caktuar me short elektronik. Të dhënat hidhen fillimisht në një regjistër elektronik dhe fizik i quajtur "regjistër i zëvendësimeve", ku pasqyrohen të dhënat në lidhje me rastet kur kemi kërkesë për heqje dorë. Më pas fashikulli penal kalon pranë zyrës së Cams, ku sipas vendimit të drejtuesit i caktohet një prokurori tjetër duke ju nënshkruar shortit elektronik. Pasi janë pasqyruar të gjitha ndryshimet në indeksat e kallëzimeve dhe në statistikat e procedimeve penale, nga sekretaria i bëhet njoftimi prokurorit të ri për të tërhequr materialin kundrejt nënshkrimit në regjistrin fizik pranë zyrës së regjistrit.

Zëvendësimet bëhen edhe në rastet kur njeri nga palët paraqet kërkesë apo pretendimet e tij në lidhje me prokurorin që po heton çështjen, edhe në këto raste bëhet shqyrtimi i kërkesës nga drejtuesi i cili shprehet me vendim për zëvendësimin e prokurorit. Pasi çështja i është nënshtruar shortit elektronik bëhet edhe pasqyrimi i ndryshimeve në regjistrat elektronik dhe fizik. Në këto raste njoftimi i prokurorit bëhet nga sekretaria e regjistrit, ndërsa për palën e interesuar bëhet njoftimi me shkrim në bazë të kërkesës që është depozituar në sekretarinë e prokurorisë.

Ka dhe raste kur zëvendësimi i prokurorit pas kërkesës për heqje dorë merret në shqyrtim nga drejtuesi dhe bazuar në nenin 49/1 të ligjit nr. 97.2016 dhe nenet 26 e 27 ky i fundit vendos të bëjë zëvendësimin direk me një prokuror të caktuar. Kur bëhet kërkesa për zëvendësim nga vetë prokurori ose një prej palëve në proces, kërkesa merret përsëri në shqyrtim nga drejtuesi i cili del me vendim për refuzimin e kërkesës. Në rastet kur kërkesa është bërë nga qytetari ose përfaqësuesi i tij ligjor njoftimi i tij bëhet me shkresë zyrtare, në rastet kur kërkesa është bërë nga prokurori njoftimi për refuzim bëhet nga zyra e regjistrit.

- ✓ Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në një procedurë zëvendësimi nga prokurorët e kësaj prokurorie procedohet në disa lloj formash me "Kërkesë për heqje dorë" ose "Deklarim për heqje dorë" ose "Informacion për heqjen dorë", si dhe "Informacion" në rastin e kalimit të materialeve seksionit kompetent.
- ✓ Praktika e zëvendësimit që ndiqet në këtë prokurori përbëhet nga kërkesa/deklarimi për heqje dorë, vendimi i drejtuesit për shqyrtimin e kërkesës/deklarimit dhe caktimi i prokurorit zëvendësues me short, i cili rezulton nga paraqitja e fletës së sistemit Cams dhe sipas pasqyrimin në regjistrin e zëvendësimeve (historikun e kallëzimit penal). Prandaj, në këto praktika në kërkesat apo deklaratimet për heqje dorë të

prokurorëve dhe vendimet e drejtuesit nuk identifikohen me numër dhe datë regjistrimi i tyre.

- ✓ Referuar 109 praktikave të përcjella nga kjo prokurori, në disa raste praktikat nuk janë të plota, pasi mungojnë p.sh., kërkesat për heqje dorë, procesverbalet e shortit manual apo shorti elektronik për caktimin e prokurorit zëvendësues, si dhe me parregullsi të tjera minimale (p.sh., nuk janë të gjitha faqet e kërkesës apo të vendimit). Në disa praktika të iniciuara me kërkesën e palëve për zëvendësim, të dhënat janë marrë vetëm nga vendimi i drejtuesit të prokurorisë, pasi mungojnë si kërkesa, ashtu edhe informacioni i prokurorit mbi këtë kërkesë, i cili përmendet në vendimin e drejtuesit.
- ✓ Zëvendësimi i prokurorëve në praktikat e paraqitura ka ardhur me iniciativë të prokurorit që ka paraqitur kërkesën apo deklarimin e heqjes dorë, ndërsa me kërkesë të palëve/subjekteve të procedimit penal rezulton në 17 raste, nga të cilat nuk është pranuar zëvendësimi për 12 prej tyre. Rezulton se caktimi i prokurorit të ri është bërë rregullisht me short dhe vetëm në 6 praktika prokurori zëvendësues është caktuar drejtpërdrejt pa short.
- ✓ Në disa raste nga prokurori që ka bërë deklarimin e heqjes dorë janë paraqitur edhe provat deklarimi i shtetasit dhe ekstrakt i shoqërisë ku është administrator, kur pretendimi ishte *“personi i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale është bashkëshorti i kushërirës së dytë të prokurorit”*, si dhe në një praktikë tjetër janë paraqitur kërkesa për gjykim dhe vendimet e mosfillimit kur pretendimi ishte *“prokurorja ka hetuar dhe më parë kallëzime/procedime ku kallëzuesi është dënuar dhe kallëzuesi ka ngritur pretendime për njëanshmërinë e prokurores duke qenë se e ka hetuar disa herë atë”*.
- ✓ Në bazë të rasteve të zëvendësimit në këtë prokurori rezulton se shkaqet për të cilat është vendosur zëvendësimi i prokurorit janë:

a) arsye njëanësie, referuar kryesisht nenit 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, pranuar si të tilla në rastet kur:

- *“prokurori është palë si viktimë akuzuese në një proces që gjykohet nga i njëjti gjyqtar ndaj të cilit është bërë dhe kallëzimi përkatës”*, të cilat janë 2 raste të të njëjtit prokuror.
- *“prokurori është subjekt rivlerësimi dhe nga KPK është pyetur për konfliktin e interesit me kallëzuesin”*.
- *“të afërm të prokurorit kanë kryer funksionin e nënkryetarit, por edhe funksione të tjera në kohë të ndryshme pranë institucionit ku punon pala kallëzuese”*.
- *“prokurori ka bërë kallëzim penal në SPAK ndaj personit të kallëzuar”*.
- *“prokurori ka njohje personale, familjare ose raporte fqinjësie, me palën e kallëzuar, palën kallëzuese ose pjesëmarrës të tjerë në procedim”* në 7 raste.
- *“prokurori ka proceduar me parë kallëzuesin ose bashkëshorten e kallëzuesit”* në 2 raste.
- *“prokurori është kallëzuar me parë nga kallëzuesi ose familjarë të tij”* në 3 raste.

- “çështja ka përfshirje politike dhe bashkëshorti i prokurorit është deputet i subjektit politik kundërshtar ose në pushtet” në 5 raste.
- “prokurori është kushëri i afërt me prokurorin që ka hetuar dhe sjellë dosjen e ardhur për kompetencë”.
- “prokurori ka shprehur mendim për faktet e pretenduara në një procedim tjetër penal ose pasi ka vendosur mosfillimin e procedimit penal”, në 3 raste.
- “personi i kallëzuar është palë kundërshtare në një proces civil me të emën e prokurorit.”
- “prokurori është kushëri i dytë me njërin prej të kallëzuarve, pasi është nipi i mamasë së prokurorit”, 4 raste.
- “viktima e veprës penale është nga fisi i prokurorit”.
- “kallëzuesi ka bërë kallëzim penal ndaj prokurorit ose ndaj një të afërmi të prokurorit” në 3 raste.
- “pala në proces, me profesion gazetar ka bërë shkrime në median online kundër prokurorit se ka shfaqur mendime në lidhje me çështjen objekt gjykimi, duke paragjykuar çështjen dhe duke u bërë i njëanshëm”. Në këtë rast prokurori ka bashkëlidhur dhe provat siç është shkrimi kundër tij.
- “kërkesa e viktimës së veprës penale për zëvendësim me shkakun “njëanshmëri të prokurorit të cilat i bazon në faktin se gjykata ka kthyer dy herë për plotësim hetimesh për përsëritjen e aktit të ekspertimit. Gjithashtu prokurori nuk është shprehur për memon e palës që ka shkaktuar aksidentin, duke i lidhur këto veprime të prokurorit me njëanshmëri dhe favorizim kundrejt palës që ka shkaktuar aksidentin”.
- “kërkesa e kallëzuesit me pretendimin për pakënaqësi lidhur me vonesën e shqyrtimit të kallëzimeve të tij nga prokurori”.
- “personi nën hetim është vëllai i noteres së dërguar në gjyq nga prokurori dhe ndaj tij janë bërë kallëzime nga këto palë, ku në procedimet e mëparshme me këto palë ai ka hequr dorë dhe kërkesat për dorëheqje janë pranuar”, pranuar me arsyetimin se sipas nenit 27 të K. Pr. Penale, duke qenë se ndodhemi në limitet kohore ku ende nuk është vlerësuar caktimi i masës së sigurimit për personin e arrestuar, si dhe në mbështetje të nenit 27 të K. Pr. Penale, si dhe në raste e parashikuar nga nenet 16 dhe 17 paragrafi parë, germat “a”, “b”, “ç”, “d”, “dh”, dhe “e” të K. Pr. Penale, sesa për njëanshmëri.
- “bashkëshorti prokurorit ka lidhur kontrate shitblerje aksionesh tek noterja e kallëzuar për të cilën i janë kërkuar shpjegime gjatë procesit të rivlerësimit” në 2 raste nga e njëjti prokuror.

▪ **Si arsye njëanësie nuk janë pranuar rastet kur:**

- ✓ “prokurori ka marrëdhënie shoqërore prej disa vitesh me personat e dyshuar të cilët janë punonjës policie”, mos pranuar duke e futur në grup hetimor.
- ✓ “nga prokurori është vendosur më parë mosfillimi i procedimit penal të kallëzimit të kallëzuesit”, për dy raste, mospranuar me arsyetimin se për të qenë para kushteve të papajteshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në procedim sipas nenit 15 duhet që

procedimi ku është marrë pjesë dhe procedimi në zhvillim e sipër të jetë i njëjti. Shkaqet e ngritura si arsye njëanshmërie për të rënë në efektin e nenit 17 vlerësohen si jo të rëndësishme.

- ✓ “prokurori në vendimin për shpalljen e moskompetencës është shprehur në një farë mënyre edhe për mënyrën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes dhe prandaj nuk është dakord me vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës”.
- ✓ “prokurori ka hetuar dhe më parë kallëzime/procedime ku kallëzuesi ka qenë palë me shtetas të afërm të tij dhe është dënuar, dhe kallëzuesi ka ngritur pretendime për njëanshmërinë e prokurorit duke qenë se e ka hetuar disa herë atë”, mos pranuar me arsyetimin se në asnjë rast nuk janë konstatuar veprime të njëanshme nga ana e prokurorit. Në këtë rast nga prokurori janë paraqitur edhe prova si kërkesa për gjykim ndaj kallëzuesit dhe vendimet e mosfillimit për të provuar çështjet mëparshme që janë trajtuar me këto palë.
- ✓ “kërkesa e viktimës së veprës penale me pretendimet se “prokurori nuk ka pranuar një prove të re të viktimës se veprës penale të paraqitur gjatë gjykimit të çështjes penale duke mbajtur një qëndrim të njëanshëm në favor të të pandehurit”, mospranuar me arsyetimin e prokurorit.
- ✓ “kërkesa e të pandehurit me pretendimin “prokurori ka njohje me babanë e të pandehurit sepse jetojnë në një lagje banimi”.
- ✓ “kërkesa e të pandehurve me pretendimet se “akuzat janë ngritur nga pozita të njëanshme të prokurorit i cili ka ndërmarrë veprime të paligjshme. Pretendohet për qëndrime që cenojnë paanshmërinë e prokurorit, pasi ka sekuestruar pasuri origjina e të cilave është e ligjshme. Pretendohet se një nga të pandehurit është anëtar i njohur publikisht i subjektit politik kundërshtar me subjektin politik ku është deputet i njohur bashkëshorti i prokurorit dhe qëndrimet prokurorit kanë lidhje dhe me këtë fakt”.

- b) **për shkak ngarkese procedimi penal ti kalojë prokurorit që e ka hetuar dhe dërguar në gjykim**, në 3 raste, mospranuar me arsyetimin se nuk gjen mbështetje në nenin 17 të K. Pr. Penale.
- c) **procedimi penal është me veprime proaktive dhe prokurori është me raport mjekësor**, pranuar me arsyetimin se meqenëse veprimet janë të ngutshme dhe nuk mund të pritë kthimi i prokurorit në punë është vendosur zëvendësimi në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale.
- d) **ndarja e procedimit penal në lidhje me veprimet e punonjësve të policisë për veprime arbitrare, bazuar në rekomandimin e avokatit të popullit ku rekomandohet ndarja e procedimit penal në dy procedime të veçanta që të hetohen nga dy prokurore të ndryshëm**.
- e) **kalimi i procedimit tek seksioni kompetent**, në 14 raste.
- f) **gjykimin e çështjes së ardhur për kompetencë në Gjykatën Tiranë duhet ta vazhdojë**

prokurori që është transferuar nga prokuroria që e ka sjellë, nisur dhe nga ngarkesa e lartë.

- g) *zëvendësimet për (4) magjistratë të transferuar në institucione të tjera të sistemit të drejtësisë, për shtatë (7) magjistratë të shkarkuar nga detyra dhe për një (1) magjistrat për pamundësi të përkohshme në detyrë.*

15. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë paraqitur 4 vendime të drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorëve. Në këto praktika mungojnë kërkesat konkrete të prokurorëve dhe prokurori tjetër është caktuar drejtpërdrejt me vendim të drejtuesit të prokurorisë në varësi të ngarkesës, duke caktuar edhe një prokuror nga seksioni që nuk ka në kompetencë veprën penale konkrete.

Bazuar në rastet e sjella për vitin 2023, praktika është ajo e paraqitjes së kërkesës për heqje dorë, shqyrtimit nga drejtuesi i prokurorisë, caktimit të prokurorit zëvendësues me vendimin e drejtuesit dhe sanksionohet në vendim njoftimi i prokurorit që ka bërë kërkesën dhe prokurorit të caktuar.

Shkaqet që rezultojnë nga vendimet e vendosura në dispozicion për zëvendësimin e prokurorit janë:

a) arsye njëanësie, në referim të nenit 17/1, germa “ë” të K. Pr. Penale, për shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, në 2 praktika në rastet kur:

- *“kallëzuesi ka bërë kallëzim se prokurori në një çështje penale ka fshehur provat, kallëzim i cili është shoqëruar me shkrime në media dhe rubrika televizive, duke akuzuar prokurorin në lidhje me veprimet hetimore”,* pranuar me arsyetimin se për shkak të kallëzimit penal, shkrimeve dhe rubrikave televizive prokurori është i paragjykuar në çdo vendimmarrje të mëtejshme lidhur me këtë procedim penal. Paragjykimi i tij do të sillte paragjykim në punën e prokurorisë së posaçme. Nga ana tjetër është dhe ngarkesa e prokurorit me ndjekjen e çështjeve penale të tjera komplekse.
- *“prokurori ka qenë pjesë e sulmeve mediatike, madje dhe kallëzimeve, për faktin se i pandehuri e konsideron si të njëanshëm, pasi ndaj tij ka kryer hetime dhe më parë, duke aluduar që prej shumë vitesh qëllimi i prokurorit është dënimi i këtij shtetasi, si dhe ngarkesa me çështje të tjera komplekse”,* pranuar zëvendësimi i prokurorit në gjykim, me arsyetimin se shmang çdo lloj paragjykimi në qëndrimin e prokurorisë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe për shkak të ngarkesës.

b) zëvendësimi i drejtuesit të prokurorisë nga vetë drejtuesi, në dy rastet e tjera nga përfaqësimi në gjykim, bazuar nenin 27/1 të K. Pr. Penale, me arsyetimin për shkak të ngarkesës në punë si me çështjet penale, ashtu edhe me detyrat administrative si drejtues i



prokurorisë dhe prokurori i caktuar drejtpërdrejt për shkak ngarkese është ai i një seksioni që nuk ka në kompetencë veprën penale.

III. Gjetjet e inspektimit

Referuar qëllimit dhe objektivitetit të inspektimit, analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, dhe Vlorë, rezulton se:

- i. Sa i përket administrimit të dokumentacionit të nevojshëm sipas kërkesave drejtuar prokurorive për realizimin e qëllimeve të këtij inspektimi vërehet se:
 - Në praktika ka mungesa aktesh të procedurës së zëvendësimit të prokurorit (p.sh. deklarimit të prokurorit për heqje dorë/vendimeve të drejtuesit, shortit për caktimin e prokurorit tjetër, kërkesën e palëve, informacionin e prokurorit kur i kërkohet mendim).
 - Praktikrat nuk prezantohen në formën që të japin informacionin e duhur ose të identifikohet fakti përkatës (p.sh., paraqiten deklaratimet/kërkesat ose vendimet, të cilat sipas akteve të brendshme regjistrohen në librin e kërkesave ose regjistra, por nuk vërtetohet me regjistrin ose numra prot., në deklarime).
 - Me përjashtim të disa prokurorive me praktika të rregullta si në plotësinë e akteve dhe në formë si ato Elbasan, Shkodër (me një rast mungesë shorti), Fier, Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe atyre me mangësi të vogla si Kukës (mungojnë 2 kërkesa), Sarandë (fakti i regjistrimit), Lezhë (fakti i regjistrimit), mangësitë e mësipërme rezultojnë në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (shorti, kërkesa), Korçë (shorti, regjistrimi), Vlorë (regjistrimi, vendime, shorti), Gjirokastër (regjistrimi, shorti), Durrës (regjistrimi, shorti, kërkesa, vendime, informacione nga prokurori), Berat (regjistrimi, kërkesa, vendime).
 - Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër nuk u gjet asnjë praktikë, duke jua atribuar veprimtarisë së drejtuesve të mëparshëm, megjithëse kishin ndodhur raste të zëvendësimit të prokurorëve, për arsye të ndryshme nga ato procedurale, si për balancimin e ngarkesës, mbarimin e statusit të prokurorit, largimit të prokurorit për paaftësi të përkohshme në punë, transferimit të prokurorit në një prokurori tjetër dhe për dosjet e kthyera nga gjykata të dërguara në gjykatë nga prokurorët e larguar nga kjo prokurori.
 - Nga Prokuroria e Posaçme janë përcjellë vetëm vendimet e drejtuesit të prokurorisë, pa deklarimet e prokurorëve për heqjen dorë të paktën për dy praktika, pasi dy të tjera janë zëvendësime të vetë drejtuesit, ndërsa në Prokurorinë e Përgjithshme nuk ka pasur asnjë rast zëvendësimi të prokurorit në vitin 2023.
- ii. Sa më sipër, evidentohet fakti se dhe këtë vit të inspektimit të prokurorive mbi praktikën

dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, vërehet e njëjta parregullsi jo vetëm nga prokuroritë e inspektuara për herë të parë, por edhe të paktën dy nga prokuroritë që janë inspektuar në vitin 2022. Situatë pothuajse e ngjashme ka vijuar me prokurorinë Vlorë, e cila edhe pse referon se si deklaratimet për heqje dorë, kërkesat dhe vendimet e drejtuesit regjistrohen në regjistër ose sekretari, vendimet i njoftohen palës, edhe këtë vit nuk paraqiten si të tilla. Në lidhje me vazhdimin e procedurës për zëvendësimin e prokurorit me hedhjen e shortit edhe këtë vit nuk pasqyrohet pjesë e praktikës procesverbali apo dokumenti për të vërtetuar hedhjen shortit për caktimin e prokurorit tjetër. Nga kjo prokurori është përmendur vitin e kaluar se mospërcjellja e një numri të saktë të zëvendësimeve vinte nga fakti se ato duheshin verifikuar në çdo dosje për nxjerrjen e praktikave të zëvendësimeve për çdo rast, pasi nuk ishin ruajtur kopje të tyre, ndërkohë që për këtë vit janë përcjellë raste të zëvendësimit të prokurorëve.

- iii. Në krahasim me inspektimin e një viti më parë ka një përmirësim të theksuar në drejtim të dokumentacionit të plotë të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ku edhe nga prokuroritë që e patën të pamenduar të siguronin praktikën e zëvendësimit të vitit 2022 si prokuroria Tiranë, aktualisht e kanë përmbushur këtë kërkesë. Kjo mungesë siç shpjegohej nga Prokuroria Tiranë ndodhi për faktin se praktikën e zëvendësimit gjendeshin në fashikujt penale që administrohen nga prokurori ose zyra e arkivës, dhe nuk administrohej asnjë praktikë në rastet e deklaratimit për heqje dorë të prokurorit dhe vendimit të drejtuesit, duke qenë për këto arsye në pamundësi për të identifikuar rastet konkrete. Por siç ka informuar kjo prokurori gjatë inspektimit të vitit 2022, në lidhje me vendimmarrjen për zëvendësim ose kërkesën për heqje dorë, duke filluar nga viti 2023 është krijuar regjistri elektronik dhe ruhet një kopje e vendimit, gjë që si rrjedhim është reflektuar dhe në praktikën e shumta të zëvendësimit të prokurorëve të sjella nga kjo prokurori për vitin 2023.
- iv. Mosparaqitjen e informacionit dhe dokumentacionit me të dhënat e kërkuara në funksion të realizimit të këtij inspektimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për zëvendësimin e prokurorit për dy raste, me justifikimin se për kallëzimin penal është disponuar me vendimi pushimi në janar 2024 dhe nuk mund të bashkëlidhen materialet për shkak të pamundësisë së sekretarisë për ta vënë në dispozicion dhe për praktikën tjetër drejtuesi ka informuar se nga prokurori që ka çështjen nuk u pranua vendosja në dispozicion e akteve të kërkuara.
- v. Në lidhje me procedurën e zëvendësimit të prokurorit, Prokuroritë Elbasan, Shkodër, Fier, në rastin e deklaratimeve të prokurorit për heqje dorë kanë zgjedhur mënyrën e komunikimit të prokurorit me drejtuesin me regjistrimin e deklaratimeve për heqje dorë dhe vendimeve të drejtuesit në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me regjistrin e lartpërmendur, Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me regjistrimin e tyre në kryesekretarinë e prokurorisë, ndërsa për



prokuroritë e tjera nuk u bë i mundur identifikimi i faktit të regjistrimit të deklarimeve për heqje dorë të prokurorit dhe vendimeve të drejtuesit.

- vi. Duke qenë një procedurë e vet rregulluar brenda prokurorisë, në ato prokurori ku dallohet fakti i mbajtjes së një praktike të rregullt dhe të plotë të rasteve të zëvendësimit të prokurorit, duke iu referuar numrit dhe datës së regjistrimit të akteve të tyre, në aspektin praktik rezulton se deklaramet për heqje dorë janë trajtuar menjëherë me vendim nga drejtuesi i prokurorisë deri në caktimin e prokurorit me short, duke mos sjellë vonesa në procedurën e zëvendësimit të një prokurori, kryesisht brenda ditës ose deri në 15 ditë, ndërsa në ndonjë rast të rrallë deri në një muaj, ndërsa për kërkesat e palëve procedura zgjat deri në 15 ditë ose në disa raste më shumë se ky afat.
- vii. Në të gjitha praktikatat për zëvendësimin e prokurorit në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Shkodër, Fier, Kukës, Sarandë, Lezhë, Berat, Tiranë me disa mungesa dhe Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është hedhur short manual ose elektronik për caktimin e prokurorit të ri, ndërsa nga prokuroritë e tjera edhe pse prezumohet se ka ndodhur një gjë e tillë, praktika nuk është e shoqëruar me dokumentimin e shortit me procesverbal manual ose të shortuar elektronikisht në sistemin Cams, për të konkluduar lidhur me zgjedhjen e prokurorit të ri të çështjes si rregull me anë të shortit.
- viii. Caktimi i prokurorit zëvendësues është bërë drejtpërdrejt në ato raste kur materiali i ka kaluar seksionit kompetent me prokuror të vetëm në rastin e prokurorisë Berat apo prokurorit të gatishmërisë që ka kryer veprimet urgjente në 1 rast në prokurorinë e Durrësit, 2 raste në prokurorinë e Vlorës dhe 2 të tjera në Prokurorinë Tiranë, por ka edhe raste të tjera ku prokurori i ri është caktuar drejtpërdrejt nga vendimi i drejtuesit të prokurorisë duke u paraqitur si shkak ngarkesa e prokurorëve të tjerë, konkretisht në Prokurorinë e Posaçme në të katër praktikatat e saj, në një praktikë të Prokurorisë Berat procedimi i është caktuar për hetim drejtuesit të prokurorisë, ndërsa në rastin tjetër të vendimit të drejtuesit të Prokurorisë Berat nuk del ndonjë arsye përse prokurori tjetër është caktuar pa short. Caktime pa short të prokurorit tjetër rezultojnë edhe në Prokurorinë Tiranë në raste të ndryshme, si p.sh., disa raste caktuar prokurorit që ka hetuar dhe dërguar për gjykim dosjen, si dhe disa raste pa u dhënë asnjë shpjegim.

IV. Konkluzionet

1. Nga ky inspektim konkludohet se në themel të ushtrimit të funksionit të prokurorit janë parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë. Parashikimet ligjore bëjnë të mundur që prokurorët të ruajnë ato në përputhje me integritetin e tyre dhe mbi parimet e etikës së prokurorit, nga çdo ndikim i paligjshëm në hetimet dhe vendimmarrjet e tyre. Për këtë marrin rëndësi edhe marrëdhëniet prokuror - drejtues, për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërinë së prokurorëve, për të vendosur vetëm bazuar në parimet e ligjshmërisë,



objektivitetit dhe paanshmërisë. Garantimi i paanshmërisë së prokurorëve është një ndër rekomandimet prioritare për vitin 2023 për Prokurorin e Përgjithshëm në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 13.04.2023, rekomandimi nr. 2, për *“Marrjen e masave procedurale dhe administrative për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influencë ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve; si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit”*.

2. Garantimi i paanshmërisë së prokurorit si parim thelbësor i ushtrimit të detyrës mbrohet nga legjislati procedural penal që detyron prokurorin, të heqë dorë në rastet e parashikuara dhe drejtuesin e prokurorisë, të vendos mbi zëvendësimin e prokurorit në rastet dhe sipas procedurës së parashikuar në ligj. Gjithashtu, ligji ka sanksionuar shkeljen e parimit të paanshmërisë nëpërmjet përgjegjësisë disiplinore të parashikuar në nenin 102/1, shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, së pari nëse nga prokurori nuk paraqitet kërkesë për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, dhe së dyti nëse paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nuk bazohet në shkaqet e parashikuara në ligj ose bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër, si dhe kur heqja dorë nuk kryhet menjëherë pasi prokurori merr dijeni për shkakun. Paanshmëria i referohet mungesës së paragjyqimeve ose anësisë, prandaj nga prokurori duhet të hiqet dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, në çdo rast kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit dhe heqja dorë nga çështja konkrete duhet të bazohet vetëm në shkaqet e parashikuara në ligj. Nga praktika e këtij viti mbi zëvendësimin e prokurorëve nuk u raportua ndonjë rast që prokurori të mos ketë hequr dorë nga procedimi ose gjykimi, kur kjo është e detyrueshme sipas rasteve të përcaktuara në ligj.
3. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, treguan gatishmërinë e tyre në bashkëpunimin për realizimin e këtij inspektimi tematik, duke dërguar dokumentacionin mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve gjatë vitit 2023. Veçanërisht ato prokurori që me praktika të rregullta të mbajtjes dhe administrimit të akteve lehtësuan identifikimin e procedurës së ndjekur për zëvendësimin e prokurorit, e cila për shkak të ligjit është e njëjta në çdo prokurori, por nuk pasqyrohet nëse zbatohet si e tillë, për shkak të mungesave të ndryshme, të cilat duhet të mbikëqyren nën përgjegjësinë e drejtuesit të prokurorisë, që të mos vijnë nga pakujdesia në mbajtjen e materialit, në përgatitjen e tij për t’iu paraqitur Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mosgjatjen e akteve të plota që përmban një praktikë zëvendësimi, mungesës së kohës ose edhe për shkaqe teknike (për shkak të fotokopjimit ose skanimit), mos justifikimit të pamundësisë për ti siguruar këto akte, të cilat në tërësi ndikojnë në kuptimin, analizën dhe nxjerrjen e përfundimeve sa më të sakta të asaj që synohet nga ky inspektim.



4. Në planin e përgjithshëm paraqitja e rregullt e këtyre praktikave vlen për të evidentuar edhe vonesat që i shkaktohen kalimit dhe trajtimit të materialit kallëzues apo procedimit penal për shkak të zëvendësimit të prokurorëve, nëse do të përfshihej zgjerimi i informacionit edhe me faktin se kur e ka marrë materialin në dorëzim prokurori i ri. Nga ana tjetër mungesa e akteve të tyre në fashikullin penal mund të shkaktojë pretendime nga palët për ligjshmëri dhe kompetencë të veprimtarisë së prokurorit që zëvendëson prokurorin e mëparshëm. Në aspektin ligjor duhet thënë se në kodin e procedurës penale dhe në ligj nuk ka ndonjë afat për shqyrtimin e deklaramit të prokurorit për heqjen dorë ose të kërkesës së një pale për zëvendësimin e prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë (siç parashikohet për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit), përveç afatit të ankimit 5 ditor ndaj vendimit të drejtuesit. Në fakt nuk ka të parashikuar shprehimisht as që palët mund të kërkojnë zëvendësimin e prokurorit, siç është për analogji parashikimi i nenit 18 të K. Pr. Penale për përjashtimin e gjyqtarit, megjithëse kjo kuptohet se palët në çdo fazë mund të kërkojnë zëvendësimin e prokurorit porsa të mësojnë për ekzistencën e shkaqeve për zëvendësim si një kërkesë e zakonshme për drejtuesin e prokurorisë. Në këto kushte kërkesa e një pale ose subjekti të procedimit penal në varësi të shkaqeve të provuara do të vlerësohet nga drejtuesi në interpretim të nenit 27 të K. Pr. Penale për të zëvendësuar prokurorin pa pëlqimin e tij për rastet e parashikuara, ose mos zëvendësimin e tij nëse prokurori nuk jep pëlqimin.
5. Gjithsej për këtë inspektim tematik u shqyrtuan 281 praktika të zëvendësimit të prokurorëve (pranime dhe mospranime) me numrin më të madh të praktikave nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në numrin e përgjithshëm të zëvendësimeve 247 prej tyre rezultojnë mbi bazën e deklaramit të prokurorit, nga të cilat 38 nuk janë pranuar, ndërsa 34 kanë qenë kërkesa të palëve për zëvendësim, nga të cilat janë pranuar vetëm 7 kërkesa. Mospranimi i këtyre të fundit tyre në masën më të madhe nga drejtuesit e prokurorisë është bazuar në faktin se shkaqet nuk përbëjnë arsye serioze njëanshmërie për zëvendësimin e prokurorit pa pëlqimin e tij ose ato nuk janë të provuara.
6. Nga inspektimi i këtyre praktikave rezultoi se respektohet e drejta e prokurorit për të hequr dorë nga çështja konkrete dhe kryhet procedura e zëvendësimit të tij sipas ligjit, me deklaramin e heqjes dorë, vendimin e drejtuesit për pranimin dhe zëvendësimin e prokurorit dhe me caktimin e prokurorit tjetër me short. Për nga forma aktet me të cilat prokurorët nisin një procedurë zëvendësimi dhe vendimet të cilët marrin drejtuesit e prokurorisë ndryshojnë nga njëra prokurori në tjetrën, madje edhe brenda një prokurorie, duke pasur çdo prokuror dhe drejtues tipologjinë e vet bazuar në praktikën e tij ose të transmetuar nga njeri tek tjetri. Përkundrejt kësaj praktike që vazhdon edhe sot nga prokurorët dhe drejtuesit e prokurorisë, përveç rasteve të veçuara, neni 26 i Kodit të Procedurës Penale në çështje termash ka të përcaktuar *deklarimin për heqje dorë të prokurorit*, kur ekzistojnë arsye njëanësie, *mbi deklarimin e heqjes dorë* vendosin drejtuesit e prokurorisë dhe me vendimin



që pranon *deklarimin e heqjes dorë*, prokurori që ka hequr dorë zëvendësohet me një prokuror tjetër. I njëjti përcaktim jepet edhe në nenin 17, pika 2 dhe 3 mbi deklarimin e heqjes dorë të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes konkrete.

7. Zëvendësimi i prokurorëve në hetimin e çështjeve penale është praktikë e njohur, dhe ndodh për arsye të ndryshme që lidhen me rrethana objektive, por kjo nuk duhet konsideruar se sjell domosdoshmërisht abuzim ose dëmtim të hetimeve. Deklarimet e prokurorëve për heqje dorë janë bazuar në nenin 26 në lidhje me një nga rastet e parashikuara në nenin 17 të K. Pr. Penale dhe më tej arsyetohen edhe shkaqet konkrete, të cilat janë të një vlerësimi të natyrës objektive nga prokurori që heq dorë dhe nga drejtuesi i prokurorisë që vendos për deklarimin e heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit, si dhe vlerësim i natyrës subjektive. Ndonjëherë rezulton se përmbajtja dhe dispozitivi i vendimit nuk janë në harmoni për sa i përket bazës ligjore dhe identifikimit të shkaqeve për zëvendësimin e prokurorit.
8. Përsa i përket shkaqeve të bazuara në Kodin e Procedurës Penale në praktikën e zëvendësimit të prokurorëve për vitin 2023, në 137 raste zëvendësimi i tyre është bazuar në arsyet e njëanësisë, referuar nenit 17/1 i K. Pr. Penale, kryesisht germa ë) "*kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie*" dhe pastaj me raste të caktuara edhe sipas germave c) "*kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit*"; ç) "*kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërën prej palëve private*". Më të pakta janë rastet e zëvendësimit për kushte papajtueshmërie për shkak lidhje familjare, gjinie ose krushqie, të parashikuara nga neni 16 i K. Pr. Penale, konkretisht në 7 praktika dhe asnjë rast papajtueshmërie për shkak të pjesëmarrjes në procedim, të parashikuar nga neni 15 të K. Pr. Penale. Gjithashtu zëvendësimi i prokurorëve ka ndodhur për shkaqe të parashikuara në ligjin nr. 97/2016 siç janë shkaqet shëndetësore, por edhe për shkaqe (ngarkesa, dosje voluminoze, rikthimit në detyrë të prokurorit që ka pasur dosjen, procesi i rivlerësimit), që pavarësisht arsyetimit siç është vendosur në kërkesë dhe në vendim, nuk reflektohen në parashikimin e nenit 26/1 të K. Pr. Penale, të cilat herë janë vlerësuar të pranohen dhe disa herë jo, apo dhe raste kur zëvendësimi është i detyruar në rastin e transferimit ose largimit të prokurorit nga detyra.
9. Një numër i vogël i rasteve të zëvendësimit është ai i zëvendësimit të prokurorëve në fazë gjykimi, kjo për faktin se shkaqet e zëvendësimit në gjykim paraqiten më të kufizuara, nga të cilat në Prokurorinë e Posaçme nga 4 zëvendësime gjithsej, 3 janë zëvendësim i prokurorit në fazë gjykimi dhe rreth 28 praktika të tjera në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, pa përfshirë 5 rastet e zëvendësimit të prokurorëve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
10. Përgjithësisht shkaqet e heqjes dorë në deklarimet e prokurorëve janë vetëm deklarative. Paraqitja e provave është një element që merr rëndësi kur deklarimi për heqje dorë mund të shoqërohet me prova, pasi vetë prokurorët në informacionet/mendimet e tyre ndaj



pretendimeve të palëve dhe drejtuesit e prokurorisë në vendimet e tyre e mbështesin arsyetimin edhe në mungesën e provave për të provuar shkakun e njëanësisë.

11. Caktimi i prokurorit zëvendësues me short elektronik ose manual është detyrim i cili parashikohet edhe në udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, ku në kreun IV parashikohet ndër të tjera se: “Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do të caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë, mban parasysh një trajtim të njëjtë mes prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit në seksionin përkatës”. Duke pasur parasysh kompetencat e drejtuesit të prokurorisë të parashikuara në nenin 42 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera, në pikën 2, germa “c” është parashikuar se “organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente,” dhe udhëzimin nr. 03, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, ku në këtë udhëzim, në kreun III, janë parashikuar edhe rastet e përjashtimit të një prokurori nga shorti, në ato raste kur caktimi i prokurorit të ri është bërë drejtpërdrejt nga vendimi i drejtuesit të prokurorisë, duhet të jepen arsye të justifikuara për këtë mënyrë caktimi pa short, pasi në disa vendime të drejtuesve të prokurorisë nuk ka të parashtruar rrethana dhe arsye, nëse prokurorët e tjerë janë përjashtuar nga shorti, nëse është prokurori i vetëm i ngarkuar me atë grup veprash, apo për arsye të tjera se përse nga ana e tij është disponuar duke e përjashtuar çështjen nga shorti.
12. Për periudhën e vitit 2023, vetëm në një rast nga drejtuesi i prokurorisë Sarandë është vendosur zëvendësimi i prokurorit, në bazë të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, i ankimuar nga prokurori dhe përfunduar me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 291, datë 19.07.2023 me rrëzimin e ankimit të prokurorit. Megjithatë në praktikën e zëvendësimit ka pasur edhe raste të tjera për zbatimin e nenit 27 të K. Pr. Penale në kuptimin e arsyeve serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, kur shkaqet janë paraqitur në referim të nenit 49/2 të ligjit nr. 97/2016 për shkak të paafësisë së përkohshme fizike për punë; kur shkaqet janë paraqitur për arsye të shkarkimit nga procesi vetting i prokurorit; rasti i transferimit të prokurorit, dosjet e të cilit shortohen dhe më pas bëhet zëvendësimi i prokurorit në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale, si dhe në bazë ngarkese të prokurorit.
13. Nga praktika e këtij viti mbi zëvendësimin e prokurorëve nuk u raportua ndonjë rast që prokurori të mos ketë hequr dorë nga procedimi ose gjykimi, kur kjo është e detyrueshme sipas rasteve të përcaktuara në ligj. Praktika e ardhur nga prokuroria Sarandë, kur drejtuesi i prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit në bazë të nenit 27/1 të K. Pr. Penale, pasi ai më parë nuk kishte paraqitur dorëheqje nga çështja i është nënshtruar interpretimit nga vetë prokurori nëse përbënte një nga rastet e papajtueshmërisë së detyrueshme sipas nenit 16 të K. Pr. Penale nëse deklaruesi në një procedim penal konsiderohej pjesëmarrës në procedim dhe më tej edhe nga Këshilli i



Lartë i Prokurorisë. Gjithashtu, deklaramet për heqje dorë të prokurorëve rezultojnë se janë të bazuara në shkaqet ligjore që parashikon kodi i procedurës penale dhe ligji, dhe rrjedhimisht edhe vendimet e drejtuesit që i ka pranuar ato ose dhe kur nuk i kanë pranuar sipas vlerësimit të drejtuesit. Ka raste që heqjet dorë dhe pranimi i tyre është bërë për arsye të tjera të ndryshme që nuk reflektohen në ligj dhe si rrjedhim dhe arsyetimi i tyre nuk paraqet ndonjë bazë ligjore, por për arsye të një efëcence në punë dhe dhënie pëlqimi midis prokurorëve janë pranuar këto heqje dorë, ashtu si edhe ka pasur raste që është vendosur mospranimi i tyre. Ndërsa, rrethana të tjera të përgjegjësisë së prokurorit që paraqet heqjen dorë nga procedimi në hetim ose gjykim për qëllime të tjera, apo nuk e paraqet atë menjëherë sapo ka ardhur në dijeni të shkakut ligjor, nuk është e mundur të evidentohen për shkak të provueshmërisë që kërkohet në këto raste dhe informacionit të kufizuar që merret në kuadër të formatit të këtij inspektimi.

V. Rekomandimet

- Për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, dhe Vlorë, Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokuroria e Përgjithshme, subjekte të inspektimit:
 1. Raporti i inspektimit t'i njoftohet prokurorive të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, me qëllim njohjen me praktikën e ndryshme dhe problematikën e mundshme lidhur me praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve.
 2. Rekomandohet mbajtja e praktikave të plota të procedurës dhe shkaqeve të zëvendësimit për prokuroritë që rezultuan me mangësi të saj për realizimin e qëllimeve të inspektimit, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Berat, Dibër, Prokuroria e Posaçme dhe Prokuroria pranë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë sipas regjistrimit të zëvendësimeve.
 3. Rekomandohet që çdo praktikë që ndiqet në prokurori për zëvendësimin e një prokurori me aktet që ajo përmban apo duhet të përmbajë (deklarimin e heqjes dorë/kërkesë të palëve/subjekteve të tjera, informacion/mendim nga prokurori, shortin për caktimin e prokurorit tjetër, vendimet e drejtuesit për pranim/mospranim dhe/ose zëvendësimin e prokurorit), përveç kopjeve që njoftohen dhe atyre që qëndrojnë në fashikull, të trajtohet dhe të ruhet si akte të drejtuesit të prokurorisë, duke qenë se deklaramet e heqjes dorë ose me kërkesë të palës përmbillen me vendimmarrjen e tij ose nëse është e mundur mbajtjen prej tyre në një regjistër elektronik të zëvendësimeve. Në këtë mënyrë prokuroritë do t'i përgjigjen



drejtpërdrejt dhe menjëherë kërkesave të këtij inspektimi tematik dhe do të shmangë vonesat për kërkimin e këtyre akteve nga prokurorët ose nëpër procedimet penale.

4. Rekomandohet që të mbahet në vëmendje ana formale e akteve të procedurës së zëvendësimit të prokurorit dhe në funksion të një praktike të unifikuar për heqjet dorë që bazohen në kushtet dhe rastet e parashikuara në ligj, prokurorët të procedojnë konform dispozitave procedurale penale, nenit 26 të K. Pr. Penale mbi deklarimin e heqjes dorë, për rastet që prokurori ka për detyrë të heqë dorë sipas rasteve të parashikuara në nenin 17 të K. Pr. Penale.
5. Rekomandohet që të ndiqet standardi i arsytimit të deklarimeve për heqje dorë dhe vendimeve të drejtuesve, sidomos ato që ka në të bëjnë me zëvendësimin e prokurorit në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale, pa pëlqimin e prokurorit, si dhe rastet e caktimit pa short të prokurorit, ku aktet e shkruara përveç elementit formal duhet të jenë të qartë për faktin dhe bazën ligjore të aktit dhe pse kushtet dhe rastet plotësohen, pasi rezulton se përmbajtja dhe dispozitivi i vendimit të drejtuesit nuk janë në harmoni për sa i përket bazës ligjore dhe identifikimit të shkaqeve për zëvendësimin e prokurorit. Gjithashtu, deklaratimet për heqje dorë dhe pranimet ose mospranimet e tyre duhet të bazohen dhe arsyetohen me shkaqet e parashikuara në ligj dhe të bëhen menjëherë me ardhjen në dijeni të shkakut.

➤ **Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë**

- . Referuar gjetjeve në këtë raport vlerësohet verifikimi i të dhënave lidhur me fakte që nëse provohen mund të përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara nga ligji nr. 96/2016, i ndryshuar, për sa i përket:
 - i. Mosparaqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbi procedurën e zëvendësimit të prokurorit për dy raste nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
 - ii. Problematikës në vazhdimësi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në lidhje me mungesën e dokumentacionit të paraqitur në praktikat e zëvendësimit të prokurorëve.
- . Ndjekja në vijimësi e rekomandimeve të këtij inspektimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,



PROPOZOJ:

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 23, datë 15.05.2024, "Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt "Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023" të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".
2. Caktimin e periudhës nga data 15.03.2025 deri në datën 15.09.2025, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohen Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.

INSPEKTOR


Julian Zonja